



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
ZYRA E PROKURIMIT
PROCUREMENT OFFICE

PLANIFIKIMI PËRFUNDIMTAR I PROKURIMIT

Sipas Nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për vitin Fiskal

2020

[Planifikimi përfundimtar i Prokurimit duhet të plotësohet dhe të dërgohet në AQP **jo më vonë se 15 ditë** pas shpalljes së legjislacionit të përvetësimeve]

Data e dërgimit në
ZKA

30.11.2018

E rezervuar për AQP

Planifikimi paraparak

X

Data e pranimit:

NENI I. Identifikimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

Emri i AK	KOMUNA E RAHOVECIT	Personi kontaktues:	Astrit Mullabazi
		e-mail-i:	prokurimi.rahovec@gmail.com & prokurimi.rahovec@rks-gov.net
Adresa	Rr. "Xhelal Hajda - Toni" p.n.	Kodi Postar	21000
Qyteti	Rahovec	Regjioni	Prizren
Telefoni	038/200-45316	Faksi	N/A
email-i		URL:	N/A

NENI II. Përshkrimi përmbljedhës i kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal

II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
28000000-2	Furnizim me Gypa PVC	1		Komplet			46,755.00	05 Shkurt
28000000-2	Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit	1		Komplet			25,453.50	02 Mars
28000000-2	Furnizim me material higjienik	1		Komplet			15,000.00	05 Qershor
28000000-2	Furnizim me material teknik	1		Komplet			80,000.00	01 Gusht
28000000-2	Furnizim me materila ushqimor	1		Komplet			9,850.00	01 Gusht
Totali							177,058.50	

II.2) KONTRATAT PËR SHERBIME

Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
65000000-3	Hartimi i projekteve të ndryshme	30,000.00	10 Janar
65000000-3	Hartimi i projekteve për fermer në Komunën e Rahovecit	15,000.00	20 Janar
65000000-3	Investime dhe mirëmbajtja e hapsirave publike, varrezave etj ne Komunen e Rahovecit - Vazhdim	45,000.00	30 Janar
65000000-3	Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit - Shtretërit Shtëpiak	195,198.00	3 Shkurt
65000000-3	Dezinsektimi, Dezinfektim dhe Derratizim - Vazhdim	30,000.00	06 Prill
65000000-3	Sigurimi i Objekteve të Komunës nga fatkeqësit natyrore	10,000.00	14 Maj
65000000-3	Sigurimi i Automjeteve të Komunës së Rahovecit	11,000.00	9 Gusht
65000000-3	Kryerja e shërbimeve mediale për Komunën e Rahovecit.	9,000.00	01 Qershor
65000000-3	Servisimi i Aparateve Kunder Zjarrit	3,800.00	08 Qershor
65000000-3	Mbikëqyrja e Investimeve Kapitale	80,000.00	15 Gusht
Totali		428,998.00	

II.3) KONTRATAT PËR PUNË

Klasifikimi I produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
50000000-5	Intervenimet emergjente në Infrastrukturë - Vazhdim	15,000.00	16 Janar
45000000-7	Rrenimi i objekteve pa leje	20,000.00	01 Shkurt
45316212-4	Ndërtimi i semaforëve të rinjë - Vazhdim	20,000.00	21 Shkurt
45000000-7	Sinjalizimi vertical dhe horizontal i rrugeve	30,000.00	10 Shkurt
45000000-7	Ndërtimi i infrastruktures për aktivitete kulturore ne Dejn dhe sipas prioriteteve	20,000.00	01 Mars
45000000-7	Ndertimi ndaj situatave kritike ne Bujqesi	30,000.00	05 Mars
45000000-7	Vazhdimi I ndërtimit të shtëpisë muze Ukshin Hoti	30,000.00	06 Mars
45000000-7	Ndërtimi i serave me participim - vazhdim	190,000.00	02 Prill
45000000-7	Tregu i gjelbërt ditor	10,000.00	05 Prill
45000000-7	Përkrahja e bizneseve	20,000.00	08 Prill
45000000-7	Riparime në Shkolla	20,000.00	15 Prill
45000000-7	Ndërtimi I shtëpive dhe material ndërtimor për familje në nevojë	20,000.00	16 Prill
45000000-7	Ndertimi I QMF-se ne Apterushë	30,000.00	17 Prill
45000000-7	Kanali i kullimit të tokave bujqësore në komunën e Rahovecit -Vazhdim	80,000.00	05 Maj
45000000-7	Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve	40,000.00	05 Maj

45000000-7	Stalla dhe ferma te vogla për fermerë - Vazhdim	80,000.00	07 Maj
45000000-7	Përkrahje e Fermerëve në Komunën e Rahovecit (mekanizëm bujqësor)- Vazhdim	190,000.00	01 Qershor
45000000-7	Investime në infrastrukturën kulturore dhe ne kende te lojrave per femije	10,000.00	01 Qershor
45000000-7	Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi i shtratit te lumit Rimnik: Rahovec -Fortese - Celine	50,000.00	01 Qershor
45000000-7	Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec	20,000.00	15 Qershor
45000000-7	Vendosja e tabelave per emertime dhe informuese	15,000.00	20 Qershor
45000000-7	Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës ne stacion te autobuseve ne Rahovec	5,000.00	25 Qershor
45232410-9	Ndërtimi dhe trajtimi I ujerave atmosferik ne qytet	50,000.00	15 Korrik
45000000-7	Restaurimi i objektit për kujtimor për 64 të masakruarit në K. e Madhe	20,000.00	15 Korrik
45000000-7	Ndërtimi I qendres rinore dhe kulturore ne Rahovec	5,000.00	30 Korrik
45000000-7	Ndërtimi I sheshit qendror te qytetit	20,000.00	11 Shtator
Totali		1,040,000.00	

II.4) KONKURSET E PROJEKTIMIT

Klasifikimi I produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	

		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
Grand Totali		0.00	



Republika e Shqipërisë
Bashkia Vlorë



Republika e Kosovës
Komuna Rahovec

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Komunës së Rahovecit në Republikën e Kosovës

dhe

Bashkisë së Vlorës në Republikën e Shqipërisë

për bashkëpunim në fushën e

“Kompetencave vetanake”
(T I T U L L I)

DUKE KONSIDERUAR që bashkëpunimi në fushën e ofrimit të shërbimeve **në kulturë, arsim, sport, ekonomi, shëndetësi dhe turizëm.**

DUKE PRANUAR që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim dy palësh mbi baza të drejta .

DUKE JU REFERUAR nenit 17 pika (k) dhe nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ligji Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin.

Kanë rënë dakord mbi arritjen e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi të mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është: **Se ne duam ta thellojmë, zgjerojmë dhe forcojmë miqësinë, mirëkuptimin dhe të kuptuarit mes nesh, në bazë të një “Miqësie Evropiane”, baza e së cilës është një mirëkuptim i bazuar në paqe, unitet, barazi, tolerancë dhe demokraci.**
2. Do të punojmë për zhvillimin dhe përparimin e shtetit tonë, unitetin, demokracinë, barazinë dhe paqen në Evropë .
3. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm .

Neni 2

Format e bashkëpunimit (apo fushat e bashkëpunimit)

1. Shkëmbimi i përvojave duke marrë pjesë direkt, në festat kulturore, në panairët e ndryshme, në turne të ndryshme sportive dhe në turizëm.
2. Secila komunë merr për obligim akomodimin e mysafirëve kur do që ata vijnë me ftesë të Kryetarit të Komunës.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e secilës palë

1. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Rahovecit, Republika e Kosovës janë:

- 1.1.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë,
- 1.2.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
- 1.3.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turizmit.
- 1.4.** Shkëmbimi i përvojave në fushën e trashëgimisë kulturore, historike dhe të traditës
- 1.5.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e bujqësisë.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë së Vlorës, Republika e Shqipërisë janë:

- 2.1.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë,
- 2.2.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
- 2.3.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turizmit.
- 2.4.** Shkëmbimi i përvojave në fushën e trashëgimisë kulturore, historike dhe të traditës.
- 2.5.** Shkëmbimi i përvojave në sektorin e bujqësisë.

Neni 4

Koordinimi ndërmjet palëve

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes në fjalë.

Neni 5

Detyrime tjera

- 1.** Palët marrin masat e nevojshme për të realizuar veprimtaritë në të gjitha fazat e ndërtimit nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe nënshkrimit të akteve tjera të mëvonshme që dalin nga ky bashkëpunim reciprok e që kanë të bëjnë me kompetencat vetanake të komunave.
- 2.** Palët me akt te veçantë caktojnë një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit të përcaktuar me këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

- 1.** Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të vazhdojë në kohë të pacaktuar.
- 2.** Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me pajtim të palëve përmes komunikimit të shkruar. Amandamenti do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.
- 3.** Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshjeje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore, me mirëkuptim, me negociata dhe nëse është e nevojshme me anë të ndërmjetësimit ose arbitrazhit.
- 4.** Kjo marrëveshje është hartuar në 4 kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 2 kopje.
- 5.** Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët në marrëveshje.

**Bashkia Vlorë
Dr. Dritan Leli**

Kryetari i Bashkisë

**Komuna Rahovec
Smajl Latifi**

Kryetari i Komunës



Republika e Italisë
Komuna Civita



Republika e Kosovës
Komuna Rahovec

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Komunës së Rahovecit në Republikën e Kosovës

dhe

Komunës Civita në Republikën e Italisë

për bashkëpunim në fushën e

“Kompetencave vetanake”

DUKE KONSIDERUAR që bashkëpunimi në fushën e ofrimit të shërbimeve **në kulturë, arsim, sport, ekonomi dhe turizëm.**

DUKE PRANUAR që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim dy palësh mbi baza të drejta .

DUKE JU REFERUAR nenit 17 pika (k) dhe nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ligji Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin.

Kanë rënë dakord mbi arritjen e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është: **Se ne duam ta thellojmë, zgjerojmë dhe forcojmë miqësinë, mirëkuptimin dhe të kuptuarit mes nesh, në bazë të një “Miqësie Evropiane”, baza e së cilës është një mirëkuptim i bazuar në paqe, unitet, barazi, tolerancë dhe demokraci.**
2. Do të punojmë për zhvillimin dhe përparimin e shtetit tonë, unitetin, demokracinë, barazinë dhe paqen në Evropë .
3. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm.

Neni 2

Format e bashkëpunimit (apo fushat e bashkëpunimit)

1. Shkëmbimi i përvojave duke marrë pjesë direkt, në festat kulturore, në panairët e ndryshme, në turne të ndryshme sportive dhe në turizëm.
2. Secila komunë merr për obligim akomodimin e mysafirëve kur do që ata vijnë me ftesë të Kryetarit të Komunës.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e secilës palë

1. Të drejtat dhe detyrimet e Komunes së Rahovecit, Republika e Kosovës janë:

- 1.1. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit,
- 1.2. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
- 1.3. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turizmit,
- 1.4. Shkëmbimin e përvojave në fushën e trashëgimisë kulturore, historike dhe të traditës,
- 1.5. Shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Komunes Civita, Republika e Italisë janë:

- 2.1. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit,
- 2.2. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
- 2.3. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turizmit,
- 2.4. Shkëmbimin e përvojave në fushën e trashëgimisë kulturore, historike dhe të traditës,
- 2.5. Shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë.

Neni 4

Koordinimi ndërmjet palëve

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes në fjalë.

Neni 5

Detyrime tjera

1. Palët marrin masat e nevojshme për të realizuar veprimtaritë në të gjitha fazat e ndërtimit nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe nënshkrimit të akteve tjera të mëvonshme që dalin nga ky bashkëpunim reciprok e që kanë të bëjnë me kompetencat vetanake të komunave.
2. Palët me akt të veçantë caktojnë një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit të përcaktuar me këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të vazhdojë në kohë të pacaktuar.
2. Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me pajtim të palëve përmes komunikimit të shkruar. Amandamentimi do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.
3. Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshjeje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore, me mirëkuptim, me negociata dhe nëse është e nevojshme me anë të ndërmjetësimit ose arbitrazhit.
4. Kjo marrëveshje është hartuar në 4 kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 2 kopje.
5. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët në marrëveshje.

Komuna Civita
Alessandro Tocci

Kryetari i Komunes

Komuna Rahovec
Smajl Latifi

Kryetari i Komunes



Republika e Italisë
Komuna Frasinetto



Republika e Kosovës
Komuna Rahovec

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Komunës së Rahovecit në Republikën e Kosovës

dhe

Komunës Frasinetto në Republikën e Italisë

për bashkëpunim në fushën e

“Kompetencave vetanake”

DUKE KONSIDERUAR që bashkëpunimi në fushën e ofrimit të shërbimeve **në kulturë, arsim, sport, ekonomi dhe turizëm.**

DUKE PRANUAR që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshin bashkëpunim dy palësh mbi baza të drejta .

DUKE JU REFERUAR nenit 17 pika (k) dhe nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ligji Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin.

Kanë rënë dakord mbi arritjen e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi të mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është: **Se ne duam ta thellojmë, zgjerojmë dhe forcojmë miqësinë, mirëkuptimin dhe të kuptuarit mes nesh, në bazë të një “Miqësie Evropiane”, baza e së cilës është një mirëkuptim i bazuar në paqe, unitet, barazi, tolerancë dhe demokraci.**
2. Do të punojmë për zhvillimin dhe përparimin e shtetit tonë, unitetin, demokracinë, barazinë dhe paqen në Evropë .
3. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm .

Neni 2

Format e bashkëpunimit (apo fushat e bashkëpunimit)

1. Shkëmbimi i përvojave duke marrë pjesë direkt, në festat kulturore, në panairët e ndryshme, në turne të ndryshme sportive dhe në turizëm.
2. Secila komunë merr për obligim akomodimin e mysafirëve kur do që ata vijnë me ftesë të Kryetarit të Komunës.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e secilës palë

1. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Rahovecit, Republika e Kosovës janë:

- 1.1. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit,
- 1.2. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
- 1.3. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turizmit,
- 1.4. Shkëmbimin e përvojave në fushën e trashëgimisë kulturore, historike dhe të traditës,
- 1.5. Shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës Frascineto, Republika e Italisë janë:

- 2.1. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit,
- 2.2. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
- 2.3. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe turizmit,
- 2.4. Shkëmbimin e përvojave në fushën e trashëgimisë kulturore, historike dhe të traditës,
- 2.5. Shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë.

Neni 4

Koordinimi ndërmjet palëve

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes në fjalë.

Neni 5

Detyrime tjera

1. Palët marrin masat e nevojshme për të realizuar veprimtaritë në të gjitha fazat e ndërtimit nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe nënshkrimit të akteve tjera të mëvonshme që dalin nga ky bashkëpunim reciprok e që kanë të bëjnë me kompetencat vetanake të komunave.
2. Palët me akt të veçantë caktojnë një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit të përcaktuar me këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të vazhdojë në kohë të pacaktuar.
2. Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me pajtim të palëve përmes komunikimit të shkruar. Amandamenti do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.
3. Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshjeje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore, me mirëkuptim, me negociata dhe nëse është e nevojshme me anë të ndërmjetësimit ose arbitrazhit.
4. Kjo marrëveshje është hartuar në 4 kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 2 kopje.
5. Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët në marrëveshje.

Komuna Frascineto
Angelo Catapano

Kryetari i Komunës

Komuna Rahovec
Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

PËR

**MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË STREHIMORES
“SHTËPIA E SIGURT” NË PERIUDHËN PREJ 3 (TRE) VITESH 2020-2022**

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1 shkronja k) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, si dhe nevojën e strehimores për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore dhe të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me seli në Gjakovë, e cila i shërben edhe viktimave të komunës së Rahovecit, palët kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1
Palët

- 1. Komuna e Rahovecit** Rr. “Sheh Myhedini” P.n. Rahovec, të cilën e përfaqëson z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejshëm Komuna), dhe
- 2. Organizata Jo Qeveritare që udhëheq me “Shtëpia e Sigurt”**, të cilën e përfaqëson znj. Erblina Dinarama, drejtoreshë e strehimores “Shtëpia e Sigurt”, (në tekstin e mëtejshëm Strehimorja).

Neni 2
Qëllimi i Memorandumit

- 1.** Ky memorandum do të sigurojë mbështetje financiare të pjesshme, e caktuar në bazë të këtij dokumenti për nevojat e strehimores për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës mbi bazën gjinore si dhe viktimat e përkohshme të trafikimit të qenieve njerëzore, për periudhën trevjeçare 2020 - 2022.
- 2.** Strehimorja gjendet në komunën e Gjakovës dhe u shërben viktimave të dhunës në familje, si dhe viktimave të përkohshme të trafikimit të qenieve njerëzore, nga komuna e Rahovecit e cila është palë nënshkruese e këtij memorandumit. Për më tepër, strehimorja po pret gjithashtu viktima nga komunat e Gjakovës dhe Malishevës.

3. Në rast se ndonjëra nga palët nënshkruese nuk dorëzon një njoftim tjetër deri në datën e përfundimit të këtij memorandum. Ky memorandum do të ripërtërihet automatikisht për të njëjtën kohëzgjatje dhe me të njëjtat kritere, duke filluar nga data 1 janar 2023.

Neni 3

Obligimet e Komunës

1. Komuna do të kontribuoj për nevojat financiare të strehimores siç është shprehur në përmbajtjen dhe frymën e këtij dokumenti.
2. Niveli i kontributit vjetor që duhet të paguajë komuna për strehimoren llogaritet në përpjesëtim të drejtë me popullsinë që banojnë në komunë. Gjatë periudhës tre-vjeçare 2020-2022, Komuna mund të rris vullnetarisht kontributin e saj financiar, mirëpo jo edhe ta zvogëloj shumën për të cilën është pajtuar. (shih nenin 4.1).

Neni 4

Detyrimet financiare

1. Shuma vjetore e kontributit të komunës drejt financimit të përgjithshëm vjetor të strehimores për periudhën trevjeçare 2020-2022, në përputhje me numrin e popullsisë në komunës, është **2,500€ (dy mijë e pesëqind euro).**
2. Komuna do të sigurojë pjesën e caktuar të kontributit të vet financiar (shih 4.1) për secilin vit fiskal përkatës, përmes një kësti të vetëm që do të paguhet në xhirollogarinë e Strehimores, para datës 31 janar të secilit vit fiskal. Kjo formë e pagesës do të jetë e vlefshme për tërë kohëzgjatjen e këtij memorandum, përgjatë viteve 2020, 2021, 2022 si dhe më pas, në rast se ripërtërihet.
3. Format e pagesës mund të rishqyrtohen dhe të vendosen nga Komuna 3 (tre) muaj para përfundimit të këtij memorandum, përmes një marrëveshjeje të veçantë e cila do të bëhet pjesë përbërëse e këtij memorandum.

Neni 5

Obligimet e strehimores

1. Strehimorja merr përsipër përgjegjësinë t'ia sigurojë Komunës planin financiar të shpenzimeve para datës 20 janar të secilit vit fiskal. Strehimorja do t'ia dorëzojë komunës llogaritë dhe raportet financiare që përmbajnë hollësitë e shpenzimeve të tyre tremujore duke filluar nga data 1 janar 2020 të secilit vit fiskal. Para datës 31 dhjetor të secilit vit fiskal, Strehimorja do t'i paraqesë komunës raportin përfundimtar financiar, i cili konsiderohet si parakusht për shpërndarjen e kontributit financiar për vitin e ardhshëm. Format e lartpërmendura të raportimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e memorandumit, si dhe më pas, në rast se ripërtërihet.
2. Në rast se strehimorja nuk raporton për shpenzimet e veta siç kërkohet në nenin 5.1 të këtij memorandum, Komuna mund të ndalojë pagesën përkatëse deri në momentin kur informacioni i kërkuar të jetë siguruar plotësisht.

Neni 6
Dispozitat përfundimtare

1. Kryetari i komunës së Rahovecit dhe drejtori i strehimores kanë për detyrë të sigurojnë zbatimin e plotë të pjesëve përkatëse të dispozitave të dakorduara në bazë të këtij memorandum.
2. Ky memorandum është hartuar në 2 kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 1 kopje.
3. Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Neni 7
Mosmarrëveshjet

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve do të zgjidhen sipas vullnetit të mirë të palëve, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit ndërmjet palëve do të jetë Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec.

Nënshkruar më: _____ në _____

Palët nënshkruese:

Për Strehimoren “Shtëpia e Sigurt”
Erbolina Dinarama

Drejtoreshë

Për Komunën e Rahovecit
Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

Për:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Nga:	z. Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit – Komuna Rahovec
Lënda:	Planifikimi i Prokurimit për vitin 2020
Datë:	30/11/2019

I nderuar Kryetar,

Konform Nenit 8. të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të bashkangjitur keni Planifikimin e Prokurimit për vitin 2020. Planifikimi është përgatitur pas kërkesës që Zyra e Prokurimit i ka bërë njësive dhe të dhënave që ka pranuar nga njësitet.

Me respekt:

Zyra e Prokurimit

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit/Komuna Rahovec
Adresa: Rr."Xhelal Hajda - Toni" p.n. 21000 Rahovec
Tel: 038/200-45316 e-mail: prokurimi.rahovec@gmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Onština Skunština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.01.2020**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, media, dhe ju gjithë të pranishëm!

Të nderuar kuvendarë, me datën 28.01.2020 pra të këtij muaji, është vrarë polici i Republikës së Kosovës, në shenjë nderimi dhe respekti, ju ftoj të gjithëve për një minutë heshtje. Lavdi!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë :

REND DITE

- 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
- 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratim të buxhetit për vitin 2020,**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2019,**
- 5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për tejkallimin e të hyrave vetanake për vitin 2019,**
- 6. Shqyrtimi i implementimit të Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm sipas planit të veprimit për vitin 2019,**
- 7. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019,**
- 8. Shqyrtimi i Planit të punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020,**
- 9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private,**
- 10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e sheshit qendror të qytetit në Rahovec,**
- 11. Shqyrtimi i raportit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2019.**

Kryesuesi- Te nderuar kuvendarë, a jeni për këtë rendë dite. Po urdhëroni z. Hoxha!

Fehmi Hoxha – Përshëndetje kryesues,kryetar,nënkryetar,ekzekutiv,kolegë kuvendarë, përfaqësues të mediave, OSBE-së, KFOR-it dhe gjithë ju të pranishëm. Në kemi një vërejtje te pika e dhjetë e rendit të ditës:**Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e sheshit qendror të qytetit në Rahovec.** Unë mendoj që këtu duhet të formulohet ndryshe, pra duhet të jetë kështu: Marrja e vendimit të Kuvendit Komunal për iniciimin e procedurave për ndërtimin e sheshit qendror në Rahovec. Pra njëherë duhet të zhvillohen të gjitha paraprake të cilat janë pra duhet bërë debatet publike pastaj afatet e shqyrtimeve publike, duhet të merret mendim i qytetareve që unë besoj që të gjithë janë dhe do të jenë por pa i krye këto procedura ne nuk mund të marrim vendim për me shpallë me interes të përgjithshëm. Pra marrja e vendimit për iniciimin e procedurave duhet të jetë këtu dhe me pas gjitha këto kur përfundojnë, përsëri vjen edhe e shpallim me interes të përgjithshëm parcelën e cila është në fjalë. Faleminderit shumë

Propozimi im është se nëse nuk e miratoni, duhet të vëni në votë

Rexhep Oruqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje per ju, kryetarin, nënkryetarin, antarët e kuvendit dhe gjithë ju që jeni prezentë në këtë seancë. Unë po dua me iniciua një çështje që nuk ka të bëjë me propozimin e Fehmi Hoxhës, ky kuvendë e patë themeluar një komision për Stacionin e Autobusëve me datën 30.04.2018 që gati dy vite që po bëhen, komisioni është i përberë nga unë Rexhep Oruqi,Hanalora Hoti dhe Përparim Krasniqi. Ne jemi mundur të kryejmë disa punë shumë te rëndësishme, janë krye shumë procedura por na kanë mbetur edhe shume punë e propozoj që ky vendim të ndryshohet dhe plotësohet sepse për pikën 4 thotë që për punën që do ta kryen ky komision, paguhet nga 50 euro prej stacionit të autobusëve, ligjërisht kjo punë nuk mund të bëhet ashtu sepse ne komisioni po e formojmë një ndërmarrje të re, qe na ka formuar ky kuvendë, tjetër është kur një aksionar kur formohet bordi dhe është dinamike, kane mjete që paguhen por ne më të vërtet si komision nuk kemi mundur as edhe një cent me marrë as nga stacioni sepse ata janë me vështirësi janë duke mbijetuar dhe kanë nevojë për ndihmën e kuvendit për ti rregulluar disa gjëra. Propozoj qe pika e katërt të ndryshohet dhe të plotësohet që pagesa le ta bën komuna sepse ne ende jemi në aktivitetin e komunës, pasi ende nuk është themeluar dhe pasi që jemi komision i kuvendit dhe duhet kuvendi të na paguaj, kisha kërkuar mirëkuptim edhe prej kryetarit edhe prej gjithë anëtareve të Kuvendit që të votojmë këtë ndryshim dhe të shkojmë para pasi kemi edhe shumë punë të pakryera. Ju faleminderit

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë juve të pranishëm, unë e shoh këtë pikë të rendit të ditës sidomos pikën e tretë që nuk ka asnjë ndryshim, janë disa përmirësime të lehta por që për mua nuk kanë kurrfarë ndryshimi edhe këtë kryetari ka mundur me krye edhe para 4 muajve këtë pikën e tretë që mos me na ardh tani, që tash po besoj është shumë vonë, e di që nuk do ta ketë lehtë pasi edhe me herët i kam thënë se duhet ta shpërndajë buxhetin në mënyre të drejtë por ka prape e ka vazhdua kështu çdo herë si ne mandatin e parë, pastaj në zgjedhjen e kryesuesit ka vazhdua njëjte pastaj e tërhoqi vete nga pika e rendit të ditës e që tash e ka vënë prapë,kjo nuk është e drejtë dhe nuk është e mirë, unë nuk jam për me bllokua kurrgjë por nuk është mirë sepse e ke tërheq vetë dhe ndoshta atë dit që ne e kishim votuar dhe ky nuk e ka ditur këtë dhe tash e ka prue me pak përmirësime që për mua nuk ka kurrfarë ndryshimi, ajo që ishte me herët shihet që është prapë, tani është në dorën e kuvendareve por për mendimin tim po bën gabime shumë të mëdha që nuk duhet përsëritur. Faleminderit shume

Kryesuesi – Kuvendarë të nderuar, jemi tek aprovimi i rendit të ditës,asambleisti Fehmi Hoxha ka bërë një propozim rreth emërimit të emërtimit të pikës se rendit të ditës.Po urdhëroni drejtor, z.Zhuniqi

Rumir Zhuniqi – I nderuar kryesues,kryetar,nënkryetar,asambleistë dhe ju kolegë drejtorë. Drejtoria për Urbanizëm në konsultim bashkë qeverinë komunale ka marrë një vendim për ndërtimin e zonës qendrore apo sheshit qendror të qytetit në Rahovec. Fillimisht atë zonë e kemi destinua për qendër pra zonë qendrore mirëpo në parcelat të cilat janë në atë pjesë përveç sheshit do të ketë edhe ndërtime tjera që janë në kuadër të zonës se

sheshit qendrorë. Në këtë rast ne kemi kërkuar me u shpallë zonë me interes publik në mënyre që të lirohet ajo zonë dhe të ndërtohet sheshi.

Kryetari – Faleminderit kryesues, faleminderit kuvendarë për prezencën, përshëndetje për të gjithë, përfaqësuesit e mediave, KFOR-it, OSBE-së, nenkryetar, bashkëpunëtor drejtorë. Unë e kuptova drejtë shqetësimin që ngriti z. Fehmi Hoxha, në faktë ne kemi një marrëveshje pasi kemi nënshkrua një memorandum mirëkuptimi me UN-Habitati si një institucion apo mekanizëm i specializuar për planifikime, ne kuadër të të cilave aty do të ketë dëgjime publike të cilat ata vet kanë me i bo me të gjitha grupet e interesit, më gjithë qytetarët dhe me sa jam në dijeni bilum prita nga Drejtori i Urbanizmit të potencojë këtë, tash ata në fillim të shkurtit ata fillojnë me rekrutua edhe stafin e vet pra UN- Habitatit që është një organizatë ndërkombëtare besoj që Fehmi Hoxha e din sepse ka pasur rast me punua me të gjithë, pra të gjitha dëgjimet publike faza e konsultimeve ka me ndodhë mbi këtë bazë pasi ka me u shpallë konkurse ndërkombëtare i projektimit, te cilin konkurs ata e shpallin vetë, ata i përcaktojnë kriteret kuptohet ne bashkëpunim me komunën dhe do të konkurrojnë, ndërsa juria do të përzgjedh projektin me te mirë ideor e më pastaj fillon projekti kryesor me u hartua edhe tek me vone ne kemi me ditur se çka do të ketë në krejt atë zonë ku parashihet me ndodhë i ashtuquajtur i sheshe qendrorë i qytetit që ne veq si emërtim e kemi vënë emrin por mund të ketë plotë elemente tjera të cilat nuk mund të i prejdukojmë tash për shkak se faza e konsultimeve publike do të filloj, do të dëgjohen dhe do të vendosen plotë sene, ne ndërkohe pse po kërkojmë me shpallë zonë të interesit të përgjithshëm ose parcela me interes të përgjithshëm, kjo bëhet vetëm me mbrojtje potencialisht ndonjë invazion potencial që mundet me pas , edhe pse është pronë e komunës, mos me lejua se kemi hyrë në një proces të rëndësishëm të planifikimit me UN-Habitatit që është bartëse e asaj që quhet një planifikim prej A deri ZH ku sipas ligjit dëgjimet publike kanë me ndodhë. Në vetëm po kërkojmë me shpallë si zonë me mbrojtje dhe asgjë me shumë d.m.th. ne nuk e dimë se çka ka me ndodhë saktë tani, bilum unë besoj qe edhe Fehmia ka me u implikua në këtë proces, ata kanë kërkuar ekspertizë edhe prej komunës, UN-Habitati qe veq na kemi nënshkrua marrëveshje dhe njëra është e Rahovecit Zana Hoxha që punon me ata po ashtu me njërin nga kryesoret e UN-Habitat kam nënshkruar marrëveshje ne emër të qytetarëve të komunës se Rahovecit edhe ata i kryejnë krejt këto procedura edhe te dëgjimit publik.

Fehmi Hoxha – Faleminderit shume kryetar dhe kuvendarë të nderuar, unë edhe ne jemi për ndërtimin e sheshit patjetër mirëpo proceduralisht dhe juridikisht duhet me i krye disa procedura, në këtë rast merret vendimi për iniciimin e procedurave pasi është shume me rëndësi kjo, sepse kemi pasur raste edhe ne qeverisjen e kaluar ku kuvendaret kanë kërkuar, këtë po e themi sepse kemi parcelat që aktualisht komuna që ky kuvend 15 vite ka vendosur me ja dhanë në shfrytëzim Hotel Parkut edhe Hoteli është në kuadër të asaj parcele po ashtu edhe terasa është në kuadër te asaj parcele, kur të merret vendim për iniciimin e procedurave me pas formohet komisioni dhe duhet të merret pëlqim edhe nga ana e shfrytëzuesit aktual faktikisht kompania që e ka hotel Parkun, te merret vendim për iniciimin e procedurave, asgjë nuk i pengon UN-Habitatit edhe komisionit i cili do të bëj, propozimi i atyre që do të del pastaj shkon neper debate publike, shqyrtime publike dhe me pastaj ne marrim vendim këtu si kuvendë pasi që shterën të gjitha mundësitë juridike pra shfrytëzohen faktikisht edhe marrim vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm. Nëse nuk ju pëlqen qytetarëve atë që po dojnë me bo ose kontraktoreve qe kemi kontratë me ata, si do të marrim ne një vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm, nuk kemi nevojë kryetar sepse pronë komunale dhe nuk ka kush me hie aty, e menaxhon komuna e nuk e menaxhon ndonjë agjencionë tjetër që mundet me i zhvillua procedurat p.sh. agjencioni pyjor i Kosovës, pra ajo është pronë komunale dhe ky kuvend vendos për atë prandaj edhe njëherë po propozoj formulohet ndryshe si Marrja e vendimit nga ana a kuvendit komunal për iniciimin e procedurave për ndërtimin e sheshit të qendrës se qytetit. Faleminderit

Kryetari – Nëse me lejohet edhe një argument shtesë që duhet ta dinë edhe anëtarët e kuvendit se ka pretendime agjencionit kosovar i privatizimit, në e kemi shqyrtua me shume seriozitet këtë çështje, unë kam takuar edhe kryeshefin edhe shefat e departamenteve, aty në fakt është edhe prona e komunës edhe objekti figuron nga agjencinë kadastral, edhe objekti edhe pse komuna nuk ka ndërmarr asgjë nga viti 1985, ne të gjitha të drejtat ligjore i kemi me marr në shfrytëzim të përhershëm atë pronë ligjërish mirëpo nëse ne nuk e

mbrojmë pronën me vendim të kuvendit atëherë natyrisht mund të ballafaqohemi me pretendimet që mund të jenë joligjore ndoshta por që janë të natyrshme nga agjencioni kosovar i privatizimit. Pikërisht për këtë qëllim, në duhet ta mbrojmë pronën tonë nga përpjekjet e agjencioneve tjera pra institucioneve tjera eventualisht për ta rikthyer në pronësi. Ne jemi shume te sigurte, qe pajtohem me gjithë procedurën që ti e thua, qe vendimi për mbrojtjen e kësaj prone ose për shpalljen me interes të veçantë është vendimi me i drejtë i mundshëm në ballafaqimet eventuale të komunës në të ardhmen. Prandaj ne vetëm po kërkojmë me mbrojte nga marrja eventuale, te gjitha procedurat do të zgjidhen siç thua ti hotel Parki dhe të tjerat janë në rregull, jam plotësisht dakord me atë pjesë mirëpo ne duhet ta mbrojmë pronën e cila është komunale mirëpo dikush po thotë ka në regjistra të AKP-së se nuk është, ne e kemi verifikuar tashme definitivisht prandaj e kemi zgjedh sot momentin me qitë ne kuvendë sepse unë veç kisha menduar se qysh ne mandatin e parë e kanë qitë në Kuvendë por nuk e kishin pas qitë, pastaj në mandatin e Idrizit kam menduar se u qitë në Kuvendë mirëpo nuk ish qitë prandaj ne duhet vetëm me mbrojte pronën dhe asgjë më shumë pra vetëm me mbrojte nga pretenduesit eventuale, s’kemi kurrjë kundër askujt por mundemi me u ballafaqua nesër e kur ta kemi edhe vendimin për mbrojtjen nga Kuvendi Komunal që e ka shpallur zonë e interesit veçantë ose zonë të interesit të përgjithshëm është një siguri shtesë, pra ky është kuptimi i krejt kësaj kërkesë dhe ky është mesazhi i kësaj kërkesë kurse për pjesën tjetër që thuani ju Fehmi është ne rregull, pa procedura, pa shkua me marr pëlqimin tek shfrytëzuesi dhe pa i krye disa punë të tjera në Kuvend pra të gjitha këto i kuptoj shume mirë por vetëm ta mbrojmë si zonë.

Fehmi Hoxha – Nuk po dua me replikua kryetar mirëpo ligjërisht është dokumenti i parë që nxirret është marrja e mendimit për iniciimin e procedurave pra procedurat njëherë duhet të përfundojnë e me pastaj e shpallim me interes të përgjithshëm, askush këtu nuk është për me marr dikush tjetër apsulitikisht, por juridikisht duhet me vazhdua kështu si po ju them dhe po ju propozoj. Faleminderit

Dervish Çadraku – Përsëritet Kryesues, Kryetar, Nënkretar dhe ju të pranishëm kolegë. Unë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës është me së lehti për të kaluar në këtë Kuvend, ashtu si propozoj Fehmi Hoxha d.m.th. iniciimi i procedurës sepse ka shumë të panjohura këtu për të cilat pastaj do të ishim në përgjegjësi si kuvendarë për të cilën e kemi iniciua këtë procedurë. Unë mendoj që nuk shkon shume gjatë sikur që tha edhe dikush më përpara se prej kujt do ta mbrojmë në këtë pronë pasi kjo pronë është e komunës dhe për një muaj nuk është kohë e gjatë që neve me na furnizua me dokumentacione, me i njoftua njerëzit sepse jemi pastaj përgjegjës ne. Unë nuk po them që kjo të zgjatet por menjëherë ne mbledhjen tjetër të na furnizoni me materiale që të jemi mjaftueshëm të njoftuar dhe të vetëdijshëm për gjendjen dhe sigurisht me votua ne këtë me të drejt apo të drejtë kështu që unë edhe nëse e shtie në rend të ditës për me biseduar për këtë punë janë vetëm sugjerime për juve se çka me bo, përndryshe nuk mendoj se është mirë me kalua kjo pikë e rendit të ditës në këtë ditë d.m.th. me së largu mundemi me lanë për mbledhjen tjetër. Faleminderit!

FehmiCena- Faleminderit Kryesues, përsëritet për juve, Kryetarin, për kolegë këshilltarë, drejtorët, monitoruesit dhe gjithë ju prezentë në këtë sallë. Në fakt edhe ne kemi dilema dhe paqartësi rreth pikës së dhjetë për ndërtimin e këtij sheshi sepse kemi vërejtur se në kuadër të materialit janë dy prona që janë në shfrytëzim që ka të bëjë me Hotelin dhe tarracën e hotelit, që e tha edhe z. Hoxha paraprakisht edhe ata e kanë kontratën në shfrytëzim, ShPK “Moderne” deri në vitin 2029 dhe tash ne sikur po hasim ndesh me të sepse ky kuvend i ka dhënë në shfrytëzim atij këtë pjesë dhe tash po duam me shpallë me interes të përgjithshëm dhe nuk e dimë se çfarë destinimi pritet pas kësaj kur ne e shpallim me interes të përgjithshëm do të thotë në kuadër të sheshit dhe ne nuk e kemi parë strukturën e sheshit, në kuadër të sheshit qendror për të cilën ne jemi që të bëhet në qytet, çka do të ndodhë me hotel dhe ajo pjesë që është në shfrytëzim, ndoshta duhet të shfuqizohet vendimi ose ajo kontratë, edhe kjo pjesa e iniciimit edhe unë mendoj nuk e rrezikon pronën publike pasi ajo është pronë publike në kuadër të komunës dhe mund të shtyhet edhe për një kohë, në mënyrë që mos të biem ndesh edhe ligjërisht por edhe me interesin e palës që e ka në shfrytëzim këtë pjesë dhe që e ka dhënë kjo komunë.

Kryetari – Ju e dini se agjencioni kosovar i privatizimit për këto prona për të cilat ne po flasim tani, neve na ka paditur pra edhe për pronën e hotelit dhe natyrisht të gjitha pronat pretendon me i marr. Të gjitha pronat janë të komunës dhe po pretendojnë me na i marr, kemi padi që nga viti 2014 dhe ne jemi në dijeni si qeveri

komunale edhe une si kryetar komune. Unë e di se ligjërisht sipas përvojës tonë të përbashkët edhe të juajen, nuk mundem me marr por ne kemi padi edhe për pronat e hotelit qe po besoj që janë në dijeni edhe Fehmia dhe të tjerët dhe ne po kërkojmë me i mbrojte pronat, çdo vonesë Dervish Çadraku neve mundet me na nxjerrë telashe, në vetëm po kërkojmë vendim me i shpallë, të gjitha ato që thuani Fehmi Cena janë të drejta, ne nuk po kërkojmë me ja marr sepse edhe ashtu nuk kemi të drejtë pa procedurë me shpallë kontratë të pavlefshme që e ka deri 2029, përkundrazi ne jemi në rregull me ato dhe as nuk po kërkohet ajo, ne vetëm po kërkojmë që mos me na gjete ndonjë institucion tjetër pra një agjencion shume i rëndësishëm shtetëror që ti merr pronat e tua vetëm që ti nuk i ke shpallë zona të interesit të përgjithshëm për me i mbrojte me kuvend të komunës. Unë ju kisha lutur asnjë interes nuk e ka asnjëri prej juve dhe për këtë jam i bindur përveç interesit komunal, interesit qytetarë me i mbrojte pronat tona me një vendim të kuvendit komunal. Pra pretendimet janë të qarta pasi ne kemi lëndë në gjykatë, kurrë nuk është mbledhur seanca gjyqësorë pasi janë ka e dinë, presion është duke u bërë pasi AKP-ja është një agjencion shume i rëndësishëm edhe ne si komunë jemi të detyruar me u mbrojte në funksion të mbrojtjes nga pretendimet eventuale neve na duhet vendimi për mbrojtje nga Kuvendi Komunal dhe po besoj që ju veçse e keni kuptuar tani. Nuk qëndron ajo që e tha Dervishi që për një muaj sepse nesër mundet me u thirr seanca dhe ti ske vendim të kuvendit komunal për me mbrojte pronën tënde pra ne po kërkojmë vetëm me mbrojte pronën me vendim të kuvendit të komunës, sikur të isha në dijeni për kete ,qysh ne vitin 2018 e kisha qitë por tash e kemi marr vesh kur jemi shkue me verifikue procesin në AKP dhe ata na kanë thanë qe keni padi dhe dikush e dinë në komunë për këtë dhe unë tash e kam kuptuar tani në këtë dhjetë ditëshin e fundit dhe pikërisht edhe per kete edhe materiali ska ardhë me kohë në KPF.

Fehmi Hoxha –Faleminderit Kryetar, tani e kemi me te qartë edhe nuk kemi pasur nevoj me diskutue me herët.Qellimi është shum i mirë dhe kur vjen radha e pikës se rendit të ditës atëherë do të kyqemi gjithsesi ,pra gjithqka në rregull. Faleminderit shum

Dervish Çadraku – Faleminderit shumë, këto të dhëna që na keni dhënë tani, a i keni ditur më herët dhe pse me kohë nuk na keni njoftuar dhe tjetra pastaj që me siguri Qazimi e din më mirë, a ka konflikt këtu në qoftë se ai e ka paraqit atje padinë dhe a na lejon neve kjo mundësi, dhe e dyta, ju Kryetar a keni qenë të njoftuar kur është deponuar ajo padi, pasi menjëherë duhet me u njoftuar edhe ju si komunë që padia është bërë në llogari tuajën ose në dëm tuajin dhe është dashtë me ditë këtë më herët?

Kryetari – E para e punës ne materiale nuk jepen këto qka thuani ju,ne pronat komunale i kemi mbrojte me 200 hektar i kemi shpallë si zonë me ineteres të përgjithshëm,vetëm me i mbrojte nga pretendimet e dikujt. Unë kur jam kon në dijeni rreth kësaj ndoshta edhe nuk kom obligim me te tregue ty ose dikujt,ne momentin kur ne pasi që nevojitet si procedurë, ne kemi menduar se i kemi shpallë zona me interes të përgjithshëm ato dhe ku me dit sa herë edhe në kohën e z.Çeska,edhe te z.Vehapi,edhe ne mandatin e parë edhe tash kemi shpallur plot her,gati nuk ka seancë të kuvendit komunal që nuk bëjmë diqka për me shpallë zona të mbrojtura me vendim të kuvendit. Tash këto informata ndoshta i kan ditur njerzt,por une skam padi tash pasiqë ajo padi është që nga viti 2014 dhe tash unë po i frigsohem, ne qoftëse na nuk kemi vendim të kuvendit komunal sdi qysh do ta mbrojmë pronën tonë pra neve na duhet argument faktë shtesë dhe asgjë me shume pasi janë prona të komunës.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar i nderuar, të nderuar kolegë e qesim në votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimsisht aprovet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka rreth procesverbalit, atëherë nëse jo,e qesim në votim. Konstatoj se unanimsisht aprovet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve – këtu kemi propozimin e asamblistit Rexhep Oruqi për komisionin e stacionit të autobusëve të bëhet plotësim ndryshimi i vendimit.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë, pyetja ime ka të bëj me drejtorin e arsimit, deshta me pyet drejtorin që a është e mundur apo a është ndonjë ligje i msheftë që ne nuk e dimë që një vend me dal në konkurs dhe një tjetër mos me dal në konkurs pasi që në shkollën profesionale „Selajdin Mullaabazi,-Mici,,dy mësimdhënëse kanë kaluar në pushim të lehonisë, drejtori një vende e ka qitë në faqe të komunës në konkurs

për Matematike kurse për lëndët e Juridikut një vend nuk e ka qitë në konkurse po mendoj në faqe të komunës ndoshta e ka shpallë konkursin por e ka mbajtur në dollap të vetin ku ta dimë na edhe komuna jonë i ka ja 100 juristë sa mundem me dit unë e merr prej komunës së Prizrenit pa konkurse, vjen mësimdhënësja dhe pyet ku është drejtorja komunale e arsimit saqë të bën me dyshua se as drejtorin komunale të arsimit nuk e din.
Faleminderit

Faton Ramadani – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm. Unë kam një pyetje për organin përgjegjës deshta me bo rreth, para një viti me parë afërsisht i ke formuar dy komisione : komisionin për emërimin e rrugëve dhe shesheve dhe komisionin e ankesave. Deshta me u informua se ku ka ngecur puna, pse s'po hec ky proces përpara pasi që ka shumë ankesa neper lagje dhe fshatra. Faleminderit

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë kolegët keshilltarët, drejtoret, kryetarin dhe juve kryesues. Është një kërkesë nga sholla fillore „Katër Dëshmorët,, që kërkon rregullimin në kuadër të efijencës, ndrrimin e dritareve, dyerve dhe fasadimin e objektit. Dua të di me shumë nga drejtori sa është i informuar për kërkesën që e ka sjellë shkolla „Katër Dëshmorët,, Ratkoc në DKA, me pae sa ka mundësi me aplikua programin e efijencës në këtë shkollë dhe kur do të arrij të aplikoj në cilin vite.

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë, unë kisha dy pyetje, e para është pyetja nga Shqipe Kryeziu që në fakt është për herë të dytë pasi edhe ne seancën e kaluar ka qenë e njëjta pyetje dhe ka marr një përgjigje, konkursi ka qenë publik për lëndë juridike dhe ka qenë i shpallur. Është e vërtetë që për shkaqe teknike apo ku ta di unë në faqen e Komunës nuk është shpallë por ka qenë i shpallur në tabelën e shpalljeve dhe ka pasur edhe kandidatë që kanë aplikue, që ju nuk e dini për këtë nuk kam fajë unë ndërsa tek pyetja e dytë për shkollën fillore „Katër Dëshmorët,, është e vërtetë që shkolla e ka dërguar një kërkesë që të përfshihet në programin e efijencës dhe ne atë kërkesë e kemi përcjellur dhe ne kemi edhe zyrtarin për efijencë të energjisë në kuadër të komunës. Këtë vite jemi duke bërë përpjekje në kuadër të Komunës që edhe shkollat tjera përveç atyre që i kemi në këtë program të efijencës. Faleminderit

Shqipe Kryeziu – Drejtor ju ne disa konkurse i qitni edhe rezultatet edhe lëndët mirëpo vetëm të lëndet e Juridikut nuk i keni vendos edhe edhe atë ditë që thuani që i keni pranua ju keni nënshkrua marrëveshjen alejdi 2 dhe shkolla „Selajdin Mullaabazi- Mici,, a ka pas përfaqësues në komision dhe kush ka qenë komision. Për me dit pasi që çdo rezultat del në faqen zyrtare të Komunës mirëpo pikërisht për këtë vend nuk ka dal asnjë rezultat, në Matematike ka dalur një konkurs me gjithë kandidatet mirëpo vetëm për lëndet e Juridikut nuk kanë dalë asnjë rezultat. Faleminderit

Kryetari – Është e vërtetë që Kuvendi i Komunës ka formua një komision për emërimin e rrugëve, shesheve, rrugicave dhe njëkohësisht edhe një komision për ankesa. Vendimi i fundit komunal i rishikuar kuptohet me plotësime për emërimin e rrugëve, shesheve, rrugicave ka qenë në vitin 2015, tash kemi edhe një listë rezervë të cilat kanë ardhë si ankesa të komunitetit qoftë përmes këshillave të fshatrave etj. Sipas ligjit në qoftë se ka ndryshime ose ka kërkesa të reja duhet me u plotësua ajo lista rezervë por përsëri kalon ajo në Kuvend të Komunës. Deri me tani ne i kemi bërë korrigjimet të cilat janë bërë disa gabime gjatë kodimit të rrugëve që neve na kanë lejua pra agjencioni kadastral edhe komisioni sepse është edhe komisioni evropian i përfshirë në këtë projekt, e din edhe Fehmia ku ka bërë ndonjë gabim p.sh. nuk është ndërprerë rruga ose ku nuk është shkruar mirë, na kanë lejua me i bërë ri rregullimet në Gjeoportali, përndryshe neve na është thënë se ky problem është për të gjitha komunat, së aty ku është e emërtuar është problem pa kalua një periudhë se paku që mundesh me ndryshua. Ky komision që është formuar tani dhe i cili nuk ka fillua aktivitetin për fat të keq, zyrtarisht është i shpallur pra i formuar që edhe anëtarët e kuvendit janë të përfshirë, krejt çka mundet me bo në këtë fazë në baze të njohurive tona mundet aty ku ka rrugë të reja me hapë kode të reja, rrugica të reja etj. dhe natyrisht me i marr emrat prej listës rezervë të ankesave që është një listë e gjatë e ankesave edhe me sjellë atë dosje pra atë material me shqyrtua në kuvendë për ta aprovuar. Emërtimet ekzistuese pra dëshira e

plotë neve është për me ndrrue, mirëpo unë as nuk po mundem me ndërrua dhe nuk po mundet bash hiq kurrkush ,kush mendon ndryshe që munden mu ndërrua ato, mendoj qe e ka gabim për shkak se dhe unë kam provua se ne disa vende ka gabime, jo ato lloj gabime që janë kundër ndokujt por janë kërkesa të qytetarëve qe kanë kërkuar me i ndërrua por vendimi i kuvendit komunal është kodue,është regjistrua ne agjencion kadastral, është futur ne gjeoportat dhe tani është problem me u ndryshua kurse për rastet e reja unë qysh tani jam ka e ftojë Menaxherin sepse përgjegjëse për këtë është drejtoria e urbanizimit me thirr komisionin sa ma shpejt dhe zyrtarisht me fillua punën se edhe une kam shprehë pakënaqësi sepse është formuar qysh moti edhe nuk ka punua bash hiq kurrgjë hiq dhe nuk u mbledhë ky komision asnjëherë, tani më pastaj komisioni i ankesave mbi bazën e punës tyre e bën punën edhe komisioni i ankesave që edhe ai është i themeluar në Kuvendë.

Ali Zhuniqi – Përhëndetje kryesues dhe për gjithë ju të pranishëm kolegë asamblastë. Unë deshta me adresua në lidhje me konkursin me pyetjen e muajit të kaluar që kemi bërë që drejtori brenda dy muajve ra ne kundërshtim dy here me veten, herën e kaluar tha që e kom dorëzua konkursin mirëpo nuk është shfaqur në tabelë kurse tash del thotë se e kemi shfaqur në tabelë, unë kisha than drejtorit që të koordinohet ose se paku të shkruan për ti mbajtur në mendë kurse tjetra është se ke përgjegjësi publike për të na treguar ne rastin konkret për konkursin në fjalë se çka ka ndodhur, mos na detyro neve si grup i asamblesë me bo padi nëpërmjet prokurorisë me ngritë procedura penale ndaj teje. Jemi vend i vogël edhe jemi mundur me funksionue si kuvendë deri tash shume mirë, mos na detyroni tash me hije procedurave penale edhe ti pastaj me dhanë përgjegjësi para prokurorisë edhe gjyqit. Ju duhet të dilni dhe te tregoni nëse ka ndodhë, duhesh me mbajte përgjegjësi publike për arsye se mbani post publikë aty edhe me votën e qytetareve edhe duhet me dhanë përgjegjësi aq sa jemi ne këtu si përfaqësues pra duhet se bashku interesat e përgjithshme me i mbrojte këtu, e jo me u mundua me krijua amulli se kinse nuk jeni ne dijeni, ne seancën e kaluar thuani e kam dërguar dhe nuk është vendos në tabelë për shkaqe teknike kurse tani thuani e kam qitë ne tabelë për shkaqe teknike, pra dilni edhe tregoni si është e vërteta e kësaj pune ose duhet me ngritë si grup procedura penale.

Avni Morina – Unë e thash edhe me herët se është shpallë ne tabelën e shpalljeve që e keni para se me shkua te zyra e DKA-së e jo në faqen zyrtare të Komunës. Në faqen e komunës nuk është shpallur për arsye për çështje teknike për shkak se punëtorët që punojnë aty nuk e kanë shpallur që mund edhe të kenë harruar për ndryshe 15 ditë ka qenë e shpallur konkursi i shpallur ne tabelën e shpalljeve që gjithashtu janë edhe rezultatet. Pyetja nga Shqipe Kryeziu për projektin e shkollës fillore „Katër deshmoret,, drejtori i shkollës e ka nënshkruar marrëveshjen.

Kryetari – Unë e kam dhënë fjalën këtu me respektua vendimin e Kuvendit të Komunës me i pagua komisionet ka 50 euro mirëpo pasi që nuk kanë ardhë mjetet pasi nuk kemi të drejtë me bo pagesa sot sepse nuk na lejon ligji. Jam shume i sigurt dhe pajtohem me u ndërrua vendimi se aty thotë me të hyrat e stacionit mirëpo nuk ka te hyra stacioni që edhe kanë edhe probleme serioze, sivjet kemi plan me hije me një projekt me Ministrinë e zhvillimit rajonal që po besojmë që kemi me boe diçka por pagesat po ju siguroj për komisione edhe për komisionin për emërtimin e rrugëve edhe për çdo komision që e ka themelua Kuvendi sa here të mblidhen kanë me u pagua mëditjet, tash a ka nevojë me u ndryshua vendimi, ligjërisht është në rregull dhe nuk guxojmë edhe me ndryshua sepse u konsultova edhe me zyrën ligjore, nuk guxojmë me ndryshua sepse ne fakt ne dojmë me gjete modalitetin që komisionet të cilat i kanë themelua kuvendi me i pagua mëditjet edhe për krejt angazhimet edhe me u shpërblye për punën e tyre, realisht juve është dashtë me ju pagua stacioni jo vetëm 50 euro por edhe me shume por ata nuk mundem me i sigurua edhe rrogat e vet sepse kanë telashe. Unë e kam një raport edhe prej stacionit apo bordit të stacionit të autobusëve, Unë të premtoj Rexhep Oruçi që ne momentin që ne kemi të drejtë me i dhanë mëditjet për komisione ju do të paguheni për punën që keni bërë pasi kemi drejtorin e Financave këtu edhe ky mund të na tregoj edhe kur munden me u lëshua paret sepse unë nuk i njoh këto problematika por ne jemi pajtua ne mbledhjen e kaluar të Kuvendit që

Komisionet kanë me u pagua, i kemi disa obligime po ashtu edhe një seancë që e kemi mbajtur edhe atë e kam proceduar dhe e kam nënshkruar mirëpo tash kur do të bëhen pagesat këtë punë unë s'mundem me ditë sepse është kompetentë drejtori i Financave.

Rexhep Oruqi – Ndoshta një keqkuptim nga unë dhe kryetari, unë nuk po kërkoj që këto mjete me mi dhanë sot apo nesër apo pas një jave por le të futet në rend që ky vendim kështu si është nuk është në rregull, nuk mundet Komuna me pagua mëditjet ku këtu është decidivisht e qartë stacionit të autobusëve me i pagua. Zyra ligjore e ka bo këtë vendim me siguri por shoqëri aksionare nuk është Radoniqi ky që punon me vite, nuk është Ekoregjioni që punon me vite por këtë si komision duhet me themelua ndërmarrjen publike në emër të komunës por këto nuk kemi pse të kërkojmë nga stacioni, kur regjistrohet kompania atëherë komisioni i merr mjetet andej pasi tash është e paregjistrune dhe për këtë ju lutem mundësisht kur të krijohen mjetet që me ditë a do i drejtohem komunës për pagesë apo kujt sepse në stacion në nuk mund të marrim asgjë sepse janë në gjendje të vështirë financiare atëherë çka me punua sepse në gjysmën e punës e kemi të pakryer.

Isak Hoti – Përhëndetje kryesues, kryetar, drejtor, delegatë të nderuar dhe gjithë ju të pranishëm. Baca Rexhep vendimi si vendim është krejt në rregull sepse ligji për ndërmarrjet publike e përcakton ashtu si është por ne mos të harrojmë se ne 100% jemi aksionar të atij vendi, edhe ne e kemi të drejtën me qatë vendim qysh është i njëjte me bo pagesën prej Komunës sepse jemi aksionar 100% në atë ndërmarrje publike dhe na vendosim për atë ndërmarrje kështu që mjetet munden me u marr edhe prej kodit të komunës pa problem sepse kur ska andej mundet edhe knena sepse jemi 100% aksionar. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit shume, atëherë të nderuar kuvendarë pasi nuk kemi tjerë të lajmëruar për pikën e dytë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratim të Buxhetit për vitin 2020 –

Afrim Limani – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, ju asambleistë, përfaqësuesit e KFOR-it, të OSBE-së dhe gjithë ju të pranishëm. Fillimisht dua të ju përkujtoj se Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2020 është 14,735,819 euro, grandin e përgjithshëm është 5 843 393 euro, Këshilli i Hoçës së Madhe 24 904 euro, grandin specifik të arsimit 5 320 978 euro ndërsa grandin specifik të shëndetësisë është 1 889 703 euro, pra në totalë grandin është 13 578 978 euro se bashku me të hyrat vetanake të cilat janë prej 1 156 841 euro atëherë kemi një buxhet në totalë prej 14 735 819 euro. Ky buxhet është i shpërndarë në kategori ekonomike dhe me këtë shumë: në paga dhe mëditje 8 644 000, në mallra dhe shërbime 1 594 330, shërbime komunal 280 500, subvencione dhe transfere 311 000, ndërsa investime kapitale 3 905 770 euro. Dallimi i buxhetit të vitit 2020 në raport me vitin 2019 është ky: në grandin e përgjithshëm dallimi është 612 097 euro, në Këshillin e Hoçës së Madhe 1410 euro, në grandin specifik të arsimit 440 499 euro, në grandin specifik të shëndetësisë 101 463, pra me një ndryshim prej 1 155 469 euro. Mirëpo në buxhetin në total në krahasim me vitin 2019 është 974 928 euro kur i qesim edhe të hyrat vetanake të cilat kanë një zvogëlim prej 11 926 duke e ditur që për vitin 2020 nuk e kemi huamarrjen në arsim dhe shëndetësi të cile në kemi pasur në arsim 33 000 ndërsa në shëndetësi 134 899 euro, pra ndryshimi nga viti i kaluar i buxhetit të komunës së Rahovecit është 974 928 euro. Për dallim nga seanca e shtatorit, në kuadër të listës së investimeve kapitale dhe total të KAB-it të buxhetit ka disa ndryshime: e kemi bërë një planifikim dhe harmonizim të saktë të të hyrave vetanake në raport me periudhën e kaluar sepse edhe hapësira edhe koha na ka mundësuar ta bëjmë këtë veprim duke ditur se buxheti është mbyllur me 31 Dhjetor atëherë kemi bërë një analizë të saktë dhe besoj që e kemi një planifikim shume të saktë të të hyrave vetanake pastaj kemi bërë edhe përshtatjen pra harmonizimin në kuadër të drejtorive përkatëse sepse e dini edhe ju ka pasur kode të cilat kanë qenë edhe në kuadër të një drejtorie tjetër do të thotë këtë problem e kemi zgjidhur që konsiderojë në mënyrën më të mirë e mundshme pastaj ndryshim tjetër në kuadër të listës për investime kapitale nuk ka më keqklasifikim, të gjitha projektet kapitale të cilat kanë qenë në kuadër të listës së projekteve kapitale që i kanë takuar mallra dhe shërbime tash më nuk do të ketë edhe pse do kemi problem gjatë vitit 2019 për shkak se prishen balancat buxhetore dhe në fund të

vitit do të barten një sasi e madhe e borgjeve mirëpo atë veprim e kemi bërë edhe nuk kemi më keq klasifikime edhe për këtë ju siguroj edhe ju garantoj sepse ne Janar të këtij viti ka dalur një udhëzim i ri administrativ që rregullorja 04/2019 që përcakton qartë klasifikimin e shpenzimeve kapitale dhe disa projekteve tjera do të thotë ne jemi bazuar kryesisht në atë rregullore edhe ju siguroj që nuk ka keq klasifikime. Të nderuar asamblistë ju garantoj se ky buxhete është i planifikuar ne harmoni të plotë me qarkoren e parë dhe të dytë buxhetore duke u bazuar në ligjin e Financave Publike dhe përgjegjësi andaj unë kërkoj nga ju që ta votoni këtë buxhete sepse kemi arsye e para, se pse ky buxhete ka një ndryshim prej 1 milion eurove dhe e dyta është buxhete i qytetareve të komunës tonë. Faliminderit, ju mund ta shikoni listën e projekteve kapitale dhe pres ndonjë pyetje.

Rasim Fazliu – Përsëritje kryesues për juve, për kryetarin, drejtorët, anëtarët e kuvendit komunal, përfaqësuesit e OSBE-së, të KFOR-it, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë ju të pranishmit ne sallë. E falënderoj drejtorin që na ka sjellë buxhetin për vitin 2020 për herë të dytë. Me 26 shtator 2019 ne mënyrë të detajuar e kemi analizuar edhe kemi diskutuar për buxhetin për vitin 2020 dhe kemi dalë me qëndrime konkrete mirëpo ndodhi ajo që ndodhi siç e dini edhe ju edhe qytetarët janë shumë mirë të informuar që në çastin që kryesuesi deshi me vënë në votim, kryetari doli në skenë edhe tërhoqi pikën e rendit të ditës, edhe neve nuk na u dha mundësia me votua buxhetin atëherë edhe ishte keq sepse edhe neper media pra portale dolën fjalë jo të këndshme ngase kuvendarëve ju hedhe faji se kuvendarët nuk kanë deshtë me votua buxhetin por nuk ishte ajo e vërteta sepse kuvendarët kanë qenë të gatshëm me votua buxhetin me ndryshimet që kemi dhënë mirëpo nuk na është dhënë mundësia për shkak se thash edhe me herët kryetari për arsye të veta që e din ai, e tërhoqi pikën prej rendit të ditës. Tash jemi në atë pikë, në grupi i PDK-së e kemi analizuar në mënyrë të detajuar prapë edhe i kemi parë disa ndryshime që janë të vogla pra kozmetike siç e tha edhe Sali Sallteku në fillim të mbledhjes, ndryshimet janë shumë të vogla pra janë disa projekte të caktuara me shumen 10.000 apo 20.000 euro të cilat prapë janë gjuajtur diku tjetër mirëpo ndryshime në esencë nuk ka në buxhet. Por tani ne duhet ti analizojmë gjërat mirë, të merremi vesh për këtë, është interesant që edhe qeveria komunale përkatësisht Drejtoria e Financave ju ka drejtuar me shkresë Ministrisë së Financave që po ashtu e kanë kthyer një përgjigje që e kemi pasur edhe ne shefat e grupeve atë përgjigje, unë dua të ju them, që absolutisht nuk jam i kënaqur me përgjigjen që kanë dhënë Ministria e Financave sepse i kanë ikur përgjigjes së drejtpërdrejtë dhe vetëm na kanë dërguar interpretimin e ligjit, ne ligjin mund ta shohim edhe vet përmes telefonave të mençur që i kemi dhe nuk kemi pasur nevojë për shkresën hiq, pra Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal u dashtë me qenë të prerë në përgjigjen kur e kanë dhënë, kur ja ka dërguar drejtori i Financave i Komunës tonë, pra u dashtë me qenë të saktë që ky kod të përcaktohet në mënyrë të detajuar se është në projekte kapitale apo është në subvencione apo është në mallra dhe shërbime, e jo me thanë që po ju dërgojmë nenet dhe ju tash shikoni si janë d.m.th. ka përgjegjësi edhe Ministria e Financave edhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal sepse nuk na kanë dhënë përgjigjen që duhet dhe si duhet të drejtpërdrejtë dhe qysh kemi kërkuar ne, por kanë shkuar në mënyrë tërthorazi na kanë përcjellë ligjin siç e thashë. Por tani jemi këtu ku jemi, pra jemi para buxhetit për vitin 2020 e kemi tani shansin e fundit dhe duhet të mendojmë edhe të reflektojmë ndoshta ashtu siç i ka hije edhe qysh është interesi i qytetareve të Komunës së Rahovecit. Para se me thënë diçka tjetër, desha të ndalem pak në përmbajtje të materialit që drejtori e ceku tha ka lëvizje, së pari po dua të ndalem te KAB-i, drejtor i nderuar konsideroj që të hyrat vetanake duke u bazuar në të hyrat apo të ardhurat që ka komuna jonë edhe që pritet dita ditës me u rritë qoftë taksa mbi tokat e plot të tjera ose participime nga bujqësia, unë mendoj që janë planifikuar pak dhe për atë pastaj po dalin tepër d.m.th. për mua që po jap një mendim në emër të grupit që të hyrat vetanake u dashtë me u paraparë pak më tepër e jo sa janë paraparë tani mbi 1 milion euro sepse prapë me siguri ne kemi me vjelë të ardhura më të mira e që është mirë për qytetarët tanë por pse mos me bo edhe planifikimin e mirë sepse në vitin 2019 ne në bazë të analizave që i

keni bërë me grupin e kemi parë që të hyrat kanë qenë më të mëdha se sa planifikimi që u bo tani për vitin 2020 pra kjo është logjika tani që unë po flas në parim pra kjo është një mendim i imi pastaj kalojmë tutje p.sh. është interesant sikurse thatë që me 26 shtator 2019 sikur të kishte kaluar buxheti, a do të kishte pasoja me këto propozime që i keni dhënë ju atëherë në krahasime tani që keni bërë ndryshime për të njëjtin buxhet p.sh. te urbanizmi kanë qenë të parapara 22.450 euro ndërsa tani i keni qitë 36.450 euro ose te kadastra dhe gjeodezi kanë qenë 17.500 euro kurse tani 71.250 euro, por po i përmendi këto ndryshime dhe sikurse ne ta kishim miratuar këtë buxhet në shtator a do të kishim gabuar diçka apo jo, për shkak të këtyre ndryshimeve që na keni sjellë tani por si do qoftë ju këto gjëra i keni analizuar më mirë dhe sigurisht i dini më mirë por unë i përmenda disa vërejtje të cilat neve na kanë rënë në sy si grup. Tani po ndalem pak te projektet kapitale këtu që janë, i nderuar drejtor, Kryetar pra ne grupi i PDK-së qëndrojmë pranë konstatimit që në buxhetin për vitin 2020 ka keq klasifikime dhe tani do shkojë me radhë në projektet të cilat janë këtu te cilat i kemi shenjëzuar p.sh. kodin 47865 **Stalla dhe ferma të vogla për fermerë** në vlerë 60.000 euro, nuk është kapitale kjo sipas grupit të PDK-së por është subvencion pastaj kemi 40827 **Participimi në projekte me bashkëfinancim në bujqësi**, edhe ky prej 40.000 euro edhe ky është subvencion pastaj kodin 47832 **Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizëm bujqësor** 200.000 euro edhe ky është subvencion, pastaj kemi kodin 46674 **Ndërtimi i serave me participim** vlera 160.000 euro edhe ky është subvencion, pastaj kemi kodin 40838 **Mbikëqyrja e punimeve në vazhdim**, ky është shërbim, pastaj kodin 40839 **Hartimi i projekteve të ndryshme** edhe ky është shërbim, kodin 48025 **Hartimi i planit lokal të veprimit në mjedis** edhe ky është shërbim, pra gjithsesi qëndrojmë pranë asaj që kemi të bëjmë me keq klasifikime. Siç e thash edhe më herët që jemi në situatën e tillë para buxhetit edhe mendoj që duhet të reflektojmë disi pra të bëjmë diçka, mendimi i grupit të PDK-së është që, Kryetari pas mbledhjes së shtatorit i ka përhapur disa fjalë neper rrjetet sociale edhe na ka fajësuar neve edhe për mendimin e grupit tonë ka gabuar kryetari ashtu që ka vepruar sepse ne nuk kemi qenë fajtor për shkak që nuk na u dha mundësia me votua buxhetin sepse kryetari pas asaj mbledhje ka mundur me thirr një mbledhje tjetër, me na qit buxhetin prapë edhe prapë se ka thirr, pastaj siç e thashë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka reaguar hiq edhe e din që Komuna e Rahovecit nuk e ka miratuar buxhetin. Unë pres reflektim edhe prej Auditorit të Përgjithshëm kur të vjen këtu me auditua komunën tonë me na sqaruar edhe me na dhënë mendimin për këto gjëra edhe mos me pas ne të ardhmen probleme rreth kësaj edhe me mbete komuna jonë pa buxhet pra miratim të buxhetit. Duke u bazuar në të gjitha këto, grupi i PDK-së i ka analizuar të gjitha këto gjëra me shumë vëmendje duke pasur parasysh interesin e qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe duke pasur parasysh interesin e fermerëve, bujqve në përgjithësi pastaj edhe të afaristëve që operojnë në komunën tonë, ne mendojmë që buxheti duhet me kaluar edhe ne do të jemi pro buxhetit për vitin 2020 për me kaluar këtë buxhet mirëpo me të gjitha këto vërejtje që i dhamë edhe këto klasifikime që i bëmë që në të ardhmen të mos përsëriten. Ju faleminderit.

Fehmi Hoxha – Faleminderit kryesues, shefi jonë i tha të gjitha por ka edhe shumëçka me thanë mirëpo në aspektin profesional po kthehem tek të hyrat vetanake të drejtorisë për urbanizëm, unë mendoj se këtu nuk është e planifikuar ashtu si duhet duke ditur se disa pozicione nuk mund të arrihen disa të tjera që duhet të shtohen kështu që po dal me propozimin konkret edhe sugjeroj drejtorin e Financave që ti miratoj se jam shume i sigurte se drejtori për Urbanizëm nuk e ka planifikuar kështu sepse e di ma mirë se qysh bohet kjo. Faqe nr.10 tek të hyrat vetanake, Drejtoria e Urbanizmit taksa komunale për leje ndërtimore 17 700 euro për vitin 2020 që është ne rregull, mundet me ndodh që me tejkalua pak por jo shumë, taksat tjera administrative 4200 euro, nuk e di se për çfarë taksa tjera administrative e ka fjalën që unë mendoj se nuk ka në drejtorin e urbanizmit taksa administrative, mund të ndodh që 1 apo 2 euro diçka, prandaj drejtori i Financave ju lutem nëse ka mundësi me shënuar këtë propozimin 4200 është e parapamë këtu, te hiqen 3200 euro dhe me lanë vetëm 1000 euro që me as 1000 euro nuk mundemi me realizua mirëpo le të jetë si kodë me 1000 euro taksa

tjera administrative te largohen si dhe taksa për legalizimin e objekteve që këtu është 8000 euro, pra vetëm ka fundi i vitit kaluar rreth 6000 euro Komuna ka inkasuar kështu që nuk është planifikim i mirë këtu si dhe leje mjedisore komunale që është e pamundur 6000 euro me u inkasue, rreth 3000 euro është maksimumi prandaj tek leja mjedisore komunale të largohet 3000 euro, tek taksat tjera administrative te largohen 3200 euro dhe këto 6200 euro të shtohen tel legalizimi ku 8000 euro të bëhet 14200 euro, kjo nuk prish punë fare mirëpo po ju garantoj që është në rregull ky propozimi jem që mundet me u miratua edhe me u aprovua pra të realizohet ky planifikim i të hyrave, nëse ka mundësi direkt ta bëni përmirësimin për ndryshim unë kërkoj që ky të hyje në votim. Faleminderit

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, është e vërtetë që ne buxhetin për vitin 2020 e kemi shqyrtuar me 26 shtator të vitit 2019 dhe si shef i grupit i kemi pasur ato vërejtjet tona si grup i LDK-së në lidhje me përgatitjen e buxhetit. Vërejtjet tona ne i kemi klasifikuar në tri grupe: në planifikimin e të hyrave vetanake që pak a shumë u cekën edhe nga parafolësit te disa drejtori p.sh. te urbanizmi, të shërbimet publike që ka qenë një diskrepancë pra dallim i madhe i planifikimit nga viti 2019 ne 2020, planifikimi ka qenë më i vogël, e dimë se diçka është punuar në ndërkohë nga drejtoritë përkatëse, vërejtja e dytë ka qenë te investimet kapitale ku në shumicën e kodeve janë prezantuar shpenzimet por pa u specifikuar projektet kjo ka qenë vërejtja jonë, kanë qenë një numër i madhe i kodeve në ndërkohe është punuar, disa kode janë përmirësuar, ne i kemi pasur me e-mail adresë, ne i kemi dërguar disa materiale prej disa drejtorive, kjo është e vërteta dhe ata i kanë paraparë një pjesë të projekteve nëpër këto kode mirëpo megjithatë kanë mbetur disa kode përsëri të prezantuara në mënyre të përgjithësuar. Ne kemi kërkuar për secilin kod me pas specifikim të projekteve, me ditë se cili projekt është në atë kod, ku do të jetë ai projekt në mënyrë që ne të mundemi me përcjellë nëse nuk e di se për cilin projekt është fjala dhe në bazë të një vlerësimi që kemi bërë ne, te jo specifikimi i projekteve është një shumë prej 393.000 euro d.m.th. të paspecifikuara që ne nuk e dimë se për cilat projekte do të bëhen shpenzime, në mënyrë të përgjithësuar po p.sh. rrugët në qytetin Rahovecit ose ne komunën e Rahovecit por cilat rrugë ose rrjet kanalizimi ose trotuare pra këto nuk janë të specifikuara për shumen 393,000 euro. Tjetër vërejtje ka qenë te keq klasifikimi i kategorive buxhetore neper kode, në kuadër të investimeve kapitale neper kode ka pasur pjesë që ne i kemi konsideruar se ato janë mallra dhe shërbime dhe subvencione. Në shtator gjithsej kanë qenë 11 kode të tilla, drejtoritë në ndërkohe kanë punuar, po e shohim në ndërkohe materialin e ri që kemi marr për këtë mbledhje janë bërë disa ndryshime gjithsej pra 4 kode janë larguar dhe kanë mbetur edhe 7 kode që ne konsiderojmë se është keq klasifikim i kategorive buxhetore dhe unë po i lexoj këto kode me rend, është kodi 47865 **Stalla dhe ferma të vogla për fermerë** shuma 60,000 euro që ne mendojmë janë subvencione, kodi 40827 **Participimi në projektin me bashkëfinancim në bujqësi** 80,000 euro gjithashtu subvencione, kodi 47832 **Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizëm bujqësor** 200,000 euro që ne mendojmë janë subvencione, kodi 46674 **Ndërtimi i serave me participim** 200,000 euro që gjithashtu mendojmë se janë subvencione, kodi i ri ndërhyrje ndaj situatave kritike në bujqësi –nuk ka sqarim se cilat janë ato situata kritike pra 30,000 euro edhe ky mendojmë që është subvencione, kodi 40839 **Hartimi i projekteve të ndryshme** 30,000 euro që ne mendojmë se janë mallra dhe shërbime dhe kodi 48025 **Hartimi i planit lokal të veprimit në mjedis** 5,000 euro është në mallra dhe nuk është kapitale kurse ju e keni përfshirë në kuadër të investimeve kapitale. Në bazë të shumës së mjeteve në të holla kur në shtator e kemi vlerësuar, ka qenë një shumë prej 715,000 eurove që ka qenë keq klasifikim, tash me këto përmirësime që janë shumë të vogla në shumen e të hollave janë shumë të vogla, prapë kapin shumicën e të hollave që ne konsiderojmë që janë keq klasifikim prej 605.000 euro. Kryetar, ne jemi të vetëdijshëm se buxheti është diçka shumë me rëndësi pra është jetike për qytetaret tanë, për veprimtari të ndryshme të qeverisë lokale mirëpo ne i kemi kërkuar dhe kërkojmë që buxheti të përgatitet pa këto gabime, pa këto lëshime të cilat vijnë ndesh me rregullat në fuqi dhe ligjet siç është ligji mbi menaxhimin e financave publike, pastaj ligji i prokurimit publik

dhe këto vërejtje i keni pasur gjithashtu edhe në raportin Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe të njëjtat pak a shumë kanë qenë të shfaqura atëherë dhe ne i kemi diskutua këtu për keq klasifikime mirëpo ju përsëri po doni me i bë gabimet e njëjta që për ne nuk janë të kalueshme. Ne si grup sigurisht jemi pro kalimit të buxhetit, te kjo e para planifikimi i të hyrave vetanake mendoj se nuk kemi vërejtje shumë të mëdha sepse janë bërë disa ndryshime te pjesa e planifikimit të të hyrave ajo është me mundësi mirëpo te specifikimi i projekteve duhet bërë ndryshime gjithashtu edhe te pjesa që ne e konsiderojmë që kemi keq klasifikime. Ne jemi të gatshëm që për hir të interesit të qytetareve që të kaloj buxheti, te ulemi të bisedojmë me te gjitha grupet e asamblistëve në mënyrë që me këto të hollat ta bëjmë ridestinimin nga kapitalet duhet të kalojnë d.m.th. këto që ne konsiderojmë që janë subvencione dhe mallra të kalojnë në investime kapitale, kemi ku të investojmë. Faleminderit!

Ali Morina – Faleminderit i nderuari kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive dhe ju të nderuar kolegë asamblistë. Ne e kemi shqyrtua me kujdes projektbuxhetin e propozuar dhe të ofruar nga drejtoria e financave madje për herë të dytë me disa ndryshime dhe konsiderojmë se është një buxhete i mirë që i përfshin disa projekte të rëndësishme që janë vazhdim por edhe projekte të reja që janë paraqit dhe janë përfshije në këtë projektbuxhete. Ndoshta nuk është buxheti më i mirë i mundshëm por megjithatë është buxhete i mirë, në interes të qytetareve, me projekte të rëndësishme për qytetaret e komunës së Rahovecit. Sa i përket të hyrave vetanake, konsideroj se është bërë një punë e mirë, parafolësit e shprehën se kemi keq planifikim mirëpo unë konsideroj se nuk është keq planifikim, është mirë që është rritur madje me mujtë me rritë edhe me tepër mirëpo më përpara kur e kemi pasur të planifikuar tavanin buxhetorë 1 600 000 asnjëherë nuk kemi mundur me arrite edhe kemi thënë se kemi planifikuar shumë e nuk po mundemi me arrite pra prape ka qenë keq planifikim. Unë konsideroj se është planifikim i mirë madje me mujtë me tejkalua edhe me tepër do të ishte edhe më mirë. Konsideroj se ne emër të grupit të AAK-së jemi pro këtij buxheti dhe urojmë që ky buxhete të rritet edhe më shumë dhe të zhvillohen projektet e rëndësishme për qytetaret e komunës së Rahovecit. Faleminderit

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë, unë deshta të ndalem te buxheti total për vitin 2020 i paraparë është 14 735 820 euro që krahasuar me vitin 2019 ka qenë 13 658 891 euro ku diferenca sipas llogaritjes time është dikun 1 086 929 euro. Tek paga dhe mëditjet ne 2019 ka qenë 7 435 569 kurse për vitin 2020 është 8 644 220 e që i bie 1 208 551 euro më shumë. Arsyeja se pse është tek pagat dhe mëditjet 8 644 220 a ka punëtorë që keni marr me kontratë mbi vepër që është rritur vlera më e madhe për paga dhe mëditje ku mallra dhe shërbime janë 1 514 331 ne vitin 2019 kurse për vitin 2020 janë 1 594 330 që i bie diferenca 79 999 euro. Shpenzimet komunale në vitin 2019 kanë qenë 255 500 kurse për vitin 2020 janë 280 500 euro, pra diferenca është 25 000 euro më shumë, Subvencionet dhe transferet kanë qenë 250 000 kurse për vitin 2020 janë 311 000 euro, që i bie 61 000 euro më shumë, Investimet kapitale në vitin 2019 kanë qenë 4 203 391 kurse për vitin 2020 janë 3 905 770 euro pra buxheti është më i madhe ndërsa investimet kapitale janë më të vogla, cila është ajo arsye, a ka me qenë buxheti më i vogël ne 2019 kurse investimet kapitale kanë qenë 4 203 391 kurse për vitin 2020 investimet kapitale janë 3 905 770 euro që i bie me pak 97 621 euro. Faleminderit, veç deshta një sqarim për këto.

Faton Ramadani – Faleminderit kryesues, deshta të lidhëm edhe unë tek projektbuxheti, vetëm tek zyra e kryetarit të Kuvendit sepse të tjerat veç janë diskutuar, për vitin 2019 të planifikuar edhe të shpenzuara kanë qenë 103 460 euro kurse për vitin 2020 i keni planifikuar 211 000 euro, pse kjo diferencë e madhe pothuajse 100%, po mendoj se mos po punësoni si shumë tek pagat është fjala.

Kryesuesi- Po i nderuar, rritja është bwrw pwr shkak tw ligjit tw pagave, i cili bwn rritje 100%.

Dervish Çadraku – Shumë gjëra i thanë parafolësit dhe që pajtohem me vërejtjet e tyre, është e vërtetë që buxheti herën e kaluar që u ardhë këtu, ka dalë i pa miratuar dhe në një farë mënyre të dhunshme u tërheq nga

rendi i ditës pa të drejtë por të gjithë ne duhet ta kuptojmë e aq më tepër ju që ky buxhet që vjen këtu është buxhete i propozuar nga administrata apo nga kryetari i komunës bashke me bashkëpunëtorët e tij, që nuk do të thotë me qenë strikt, këtu vjen për tu miratuar, për tu propozuar, për tu eliminuar dhe në fund për ta finalizuar në bashkëpunim me ne si përfaqësues të popullit që jemi ne këtu sepse ne po aq mirë e dimë nevojat e popullit për çdo gjë në komunën tonë, prandaj duhet të kihet parasysh këto propozimet tona apo vërejtjet tona që kanë qenë edhe janë sot edhe nga parafolësit edhe nga ne si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Në radhë të parë, unë dua të them se vërejtjet që i dhanë për kodet e diskutueshme që ishin që nuk janë subvencione, unë mendoj që nuk e kemi një përgjigje shume të saktë siç tha edhe parafolësi z. Fazliu por unë mendoj se kjo është në ndërgjegjen tuaj edhe në përgjegjësinë tuaj si Kryetar i Komunës keni të drejtë apo nuk keni të drejtë sepse tash këtu çështjet po dalin të diskutueshme sepse edhe përgjigjja ishte dualiste apo sipërfaqësore dhe jo e saktë pra striktë kështu që ne e lëmë në përgjegjësinë tuaj. Kur është fjala për projektet kapitale, unë edhe atë ditë edhe sot edhe të tjerët e diskutuan që mirë është të përfillen kërkesat, kemi plot projekte të cilat nuk janë të emëruara në mënyrë të përgjithësuar, pjesërisht ju keni përgjigj kërkesave tona por jo tërësisht, nuk e di materialisht edhe teknikisht me i krye këto por megjithatë sipas kërkesave të kuvendareve duhet megjithatë të përfillen këto edhe mendoj që duhet me ndodhë në të ardhmen. Kur është puna te projektet kapitale, unë kam disa vërejtje këtu që projektet kapitale duhet të bëhen në mënyrë të balancuar, ne kemi pasur edhe disa dalje në teren kur kemi biseduar me qytetarët dhe nevojat e tyre kemi vërejt që janë të shumë llojshme edhe dimë që buxheti i Komunës është i pamjaftueshëm për ti kryer nevojat e qytetareve por atëherë duhet t'i klasifikojmë se cilat janë me emergjente, cilat janë më të kalueshme në pikëpamje buxhetore dhe ti klasifikojmë në këtë drejtim dhe jo p.sh. të investojmë në një projekt i cili ndoshta është shumë me afatgjatë dhe nuk është aty për aty i nevojshëm për qytetarin dhe ne kemi dhënë disa mjete bukur të mëdha që tash nuk e di a ka nevojë për ti theksuar këtu por kemi një lloje disbalansimi të investimeve p.sh. unë shkoj në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ne Rahovec dhe nuk mundem të bëj asnjë analizë dhe jo njëherë por po e theksoj disa herë këtë, nuk kemi as reagenca dhe po dojmë me ndërtuar një ndërtesë të emergjencës që është shume e mirë, ë nevojshme dhe duhet të bëhet, po ju do të thuani se furnizimi do të bëhet nga qendra, qytetari se pari vjen te ju pra te Kryetari te menaxhuesi i Komunës dhe kërkojnë t'i kryhet ky shërbim prandaj duhet ta keni një përgjigje pse nuk ka barna elementare pra reagenca për qytetarin i cili ka nevojë që shpesh herë edhe skajshmerisht për shkak të gjendjes ekonomike shume të rëndë dhe nuk kanë mundësi as barnat ti paguajnë. Prandaj unë po mendoj që është përgjegjësi e juaja se pse nuk ka funksionuar kjo punë. Nëpër shkolla, ne po ndërtojmë shkolla dhe kemi një trend të kundërt të ndërtimeve të cilat shkojnë vetëm në llogari të operatoreve që ndërtojnë sepse nëse ne këqyrim përqindjen e lindshmërisë atëherë ne po dalim që jemi ne deficit për ditë e me shumë duke ikur prandaj edhe shkollat do ta kenë fatin e Dardanës, në vend se në shkollat tona të mbushen me mjete konkretizuese sepse fëmijët nuk po donë me ndëgjue jo prindin por as mësuesin prandaj me mjete konkretizuese që të ja bëjmë me interesant fëmisë, ti mbushim laboratorët dhe kabinetet që në mënyrë konkretizuese atyre të ju mundësojmë absorbimin e dijeve pra këtu kemi një deficit, nuk po them se ju nuk keni ndarë mjete të mjaftueshme për mjete konkretizuese për laboratorë dhe kabinete, i kemi diku tash s'po dua me ti numërua sepse me siguri flasim edhe të tjerët prapë, i kemi disa kompjuterë që i bijnë nga jashtë që janë të përdorur që mund të shfrytëzohen se si hapen dritaret e kompjuterit por konkretisht është mirë që të mendoni kryetar sepse shkollat i kemi të zbrazëta edhe nuk kemi aktivitete pastaj dhe nuk kemi motiv për të vazhduar për këtë punë. E kemi shtëpinë e pleqve të cilën e keni vendos atje naltë që nuk e di kush e ka dërgue atje, a e keni dërgua ju apo qeveria para juve por tani flas kështu pleqtë edhe ashtu kanë mbetur pa fëmijë pa njerëzit e tyre dhe ne i kemi dërgu në mal atje edhe në ndeja ditore si do të shkojnë ata atje edhe i keni ndarë 10,000 euro, çka mundeni me bo me atë shumë të hollave për me funksionalizue ndejën ditore të atyre. Përveç kësaj këtu ishte një treg ditor, nuk e di ku është ai treg ditor që keni ndarë 10 000 euro sepse ka dy definicione,

aty ku e keni shkruar me hije në interesin e përgjithshëm e keni shkruar treg javor kurse këtu e keni shkruar tregë ditor d.m.th. po dua me ditë a është i njëjti pra sipas juve tregu ditor dhe javor qenka i njëjti. Unë mendoj që keni ndarë mjete pak edhe për qendrën rinore 10,000 euro sepse të rinjtë sigurisht që kanë nevojë, ne kemi një qendër aty mirëpo nuk e di sa është funksionale apo është e re kjo dhe nuk e di çka mundet me u bo me 10,000 euro, kemi ndërtuar çerdhet me shume metra katror edhe nuk kemi kon me futë brenda konkretisht nuk kemi mjete brenda për ti funksionalizuar ato, këtu kemi një dobësi shumë të madhe për të cilën ne duhet të bisedojmë. Këtu e kam të paqartë edhe një kodë, për të cilin jam i interesuar që kam thënë edhe atëherë që komuna jonë nuk ka gropa septike ose impiante, e di që impiantet kërkojnë shpenzime të mëdha, kërkojnë por këtu e kemi ne 150,000 euro pra me këtë shumë ne mundemi me ndërtua një gropë septike për Rahovecin që ka mbi 15,000 banorë. Pra me këtë shumë të hollave ne mundemi me ndërtuar edhe gropën septike në Ratkoc edhe në Krushe pra këtu keni shkruar ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) pra cila është këtu sepse mundeni me qitë ashtu apo kështu edhe unë kam kërkuar po ashtu për oborrin e shkollës që unë kam propozua herën e kaluar, a do të bëhet ai oborr edhe trotuari që do të bëhet Gradish deri te Kanioni që kam kërkuar prapë, po me intereson a do të lidhet kjo rrugë e trotuarit me pjesën Gradishit që dërgon atje sikurse e ka bërë Gjakova. Ne jemi pjesërisht për me kalua ky buxhet, nëse kemi këto vërejtje edhe i kemi parasysh këto vërejtje edhe i futemi aty d.m.th. jo vetëm ti kemi në letër por ne duam garanci nëse ndërtohet gropa septike, nëse rregullohet oborri i shkollës, nëse rregullohen ndriçimet pra ne do ta votojm për ndryshe nuk mundemi me votuar. Faleminderit.

Kryetari – Sot edhe asnjë ditë nuk e kam ndërmend me u marrë me fjalë sepse edhe nuk me takon pasi jam edhe Kryetar i Komunës edhe besoj që jemi dakord që buxheti nga shtatori deri me tani ka disa ndryshime dhe sqarime shtesë pavarësisht se si cilësohen, është e drejtë që të gjykohet apo të vlerësohet edhe unë e admiroj kontributin e secilit prej Rasimit që në mënyrë të detajuar dhe të qartë ka folur konkretisht, unë besoj që ne të gjithë jemi dakord me disa që mund të mos jen dilema për mua por për të tjerët mund të jenë ato që na ka sjellë Ministria e Financave kur ne i kemi bërë pyetje se si klasifikohen pra si cilësohen qeto kode. Unë po ju jap vetëm një shembull kur u përmendën serat ose bashkëfinancimi, neve auditori gjeneral apo kombëtar na ka thënë të vetmen vërejtje që janë investime kapitale mirëpo nuk duhet me llogari private me i dhanë përfutjesit por duhet me i dhanë llogari komunës me participim me 20%. Këtu na ka dhënë vërejtje te serat, sido qoftë ne e presim ndihmën e auditorit që do ta kemi shumë shpejt në Shkurt apo Mars ata vijnë dhe do të na ndihmojnë. Tani do të ndalem se ka keq klasifikime në masën më të madhe që janë gjykua nga anëtarët e Kuvendit, qoftë nga Drejtoria e Financave, qoftë nga sugjerimet apo rekomandimet që kanë dal nga rregullorja që përmendi drejtori i Financave janë shterua pra maksimalisht janë larguar keq klasifikimet, shpresojmë që s’do të kemi dhe për këtë na ndihmon auditori kombëtar kur të vjen tash edhe na konstaton se a ka keq klasifikime apo jo. Ato që ti kam thënë në letër Dervish Çadraku janë të qarta pavarësisht që janë thënë përmes drejtorive, oborri i shkollës, shtigjet e ecjes, përmendet rruga transite se dhe atje do të bëhet një shtegë i ecjes që do të lidhet me transitin e ri. Te shtëpia e pleqve, nuk ka tjetër kund dhe ne e kemi planifikua edhe e kemi dërgua atje, kur do që të ndërtohet, pleqtë kanë me pas sigurtë transportin, higjienën edhe ushqimin ditor aty pra do të organizojmë transportin 3deri në 4 herë ne ditë dhe e marrim përsipër si komunë sepse nuk ka pronë në qytete, vendi është i mirë i pastër dhe prona është i Komunës dhe objekti do të ndërtohet mirë. Shkollat ne po i ndërtojmë, nëse e kam pasur në buxhete me ndërtua shkollën në Reti dhe Hoxhë të vogël e Brestoc nga buxheti i ish qeverisë se kaluar ose ish kryetarit, unë nuk e heqë sepse aty nuk ka pasur kushte as në Reti e as ne Hoxhë të vogël e Brestoc, nuk ka kushte as në Fortesë që kur të bien shi aty e merr uji, ska kushte për eficiencë pra nuk banë me u zbatua programi i eficiencës, mirëpo nuk kemi qare pa e ndërtua ne atë madje ka kërkesa edhe për shkolla të reja ju e dini shumë mirë që ka edhe në kuvendë, ne kemi programe eficiencë për shkolla mirpo kemi edhe shkolla të reja që po i ndërtojmë. Unë jam dakord që ska rini mirëpo kjo i bien që ne

të planifikojmë me mirë familjen, të rrisim natalitetin. Ne po përpiqemi me i permisue çdo ditë, janë disa prioritete që gjykohen ma te rëndësishme, me të shpejt që duhet me realizua, unë besoj që në vitin 2020 kam me dëshmuar se ka pas me pak disbalancë, në vitin 2019 kanë fillua me u stabilizua mirëpo në 2020 edhe më shumë për shkak se ne kemi lidhur kontrata. Të gropat septike, ne kemi një projekte që kemi marrë një donacion prej MAPL-së, kanalizimet dhe gropat septike, tash ne i kemi ndaje 150 000 euro sipas prioriteteve dhe sipas atyre që merren me projekte, na tregojnë specifikisht se ku mundet të bëhet një gropë septike, sa i takon kolektorëve apo impianteve e dini që janë projekte milionëshe të cilat ne ju kemi adresua Ministrisë së Financave dhe shpresojmë me gjete ndonjë donatorë. Nuk ka kapacitet buxheti komunal me përballua shuma mbi 10 milion eurove, jemi të interesuar me i bo ato në momentin kur i bëjmë, kemi kërkesë pozitive unë po ju garantoj se kemi me ju informua. Te barnat esenciale te reagencat, ne edhe nga buxheti komunal ndajmë diçka por përgjegjësin për furnizim me barna esenciale kryesisht e ka marr Ministria, unë besoj që ka më pak ankesa dhe gjithnjë me pak do të ketë ankesa në QKMF e sidomos kur të përrurohet objekti i ri i emergjencës. Ne kemi fillua me stabilizua edhe pse nuk jemi të kënaqur asnjëherë sepse këto janë gjëra që kaniherë disa reagenca shkojnë me shume pasi nuk varet gjithçka prej neve mirëpo ajo çka varet me ndihmën e juaj, ne kemi marr vendimin dhe është lidhur kontrata për me shtua reagencët, laboratorët etj. që kemi investua edhe me buxhete tonin që po besoj që ankesa ka me pas me pak. Unë vërtet që kemi reflektue dhe me këtë po ju drejtohem shëfave të grupeve, prej Rasim Fazliut që e mori fjalën i pari, në kemi reflektua edhe unë kam insistua te drejtori i Financave që me pas sqarime, me pas informata shtesë grupet tona politike, përfaqësuesit e zgjedhur dhe maksimalisht aq sa ka lejua faza ku jemi, rrethanat apo infrastruktura ligjore ku jemi, ne kemi operua në përputhje me kërkesat të cilat janë dëgjuar në seancën e shtatorit. Kemi tentuar me heqë keq klasifikimin, me bo planifikim me te mirë edhe të hyrave edhe me bo sqarime shtesë me i specifikua kodet e përgjithshme me i konkretizua me prioritete të veçanta. Natyrisht unë jam i bindur që ne, jemi munduar me bo atë që duhet me bo. Ne jemi vonuar pak në miratim të buxhetit mirëpo unë po mendoj që ky buxhete megjithatë është një buxhete që karshi rrethanave ku jemi, ligjeve që i kemi në fuqi, mundësive tona buxhetore është për qytetaret e komunës dhe për asnjë parti politike. Tash unë si kryetar i komunës si propozues i buxhetit kemi pasur konsultime shtesë dhe jemi munduar me informua edhe ne mënyrë zyrtare edhe kuvendin e komunës, përgjegjësit e grupeve me materiale shtesë edhe unë po mendoj që ka ardhur koha me aprovua buxhetin e komunës me plotë vërejtjet të cilat ne i dëgjuam dhe po ashtu edhe me plot vërejtje që ka me na dhanë auditori i përgjithshëm pra zyra kombëtare e auditimit, ata do të na ndihmojnë ata pak me shume se sa ne mendojmë, kane me specifikua a kemi bo keq klasifikimin, kanë me specifikua a kemi bërë planifikim të mirë, kanë me specifikua se ku janë të metat dhe raportin e auditorit ju keni me pas në kuvendë. E dini që në korrik ka me ardhë në kuvendë të komunës dhe keni me pas rastin me debatua për raportin e auditorit gjeneral. E di që edhe ne i kemi të metat tona, po aq sa doni ju si përfaqësues të zgjedhur, besoj që e kuptoni edhe për mua si kryetar i zgjedhur nga qytetaret, edhe unë kam dëshirë me realizua sa me shumë me konkretizua edhe ju e dini se kam njëfarë burrnje pasi edhe me ndihmën e juve as unë vet nuk mundem ta bëj. Pra nuk janë veç drejtoret që me ndihmojnë por me ndihmon edhe Kuvendi i Komunës, me ndihmojnë edhe grupet tjera politike edhe unë mendoj që kryetari i Komunës pa ndihmën e njerëzve që bëjnë vërejtje, plotësime dhe japin ide me propozime, problem është me u implementue vizioni i kryetarit të komunës edhe pse drejtpërdrejt jam i zgjedhur. Unë e kam kërkuar ndihmën e juaj dhe jam ka e kërkoj edhe tani për me votua buxhetin për shkak se nuk është mirë me u vonua, ju e dini se nuk është miratuar as buxheti i Kuvendit të Kosovës për disa arsye themelore sidomos për ata që janë me përvojë, ju tash duhet me dëgjua mua sepse atëherë u kon fushatë pra duhet të jemi korrekt, nëse jam dal atëherë me postime sepse kam besuar se jam kon i bindur që ka me kalua, për shkak se nuk kam pasur ndonjë informatë që nuk kam me kalua. Unë e kam ndjek procesin e konsultimeve publike si kryetar, komiteti për Politike dhe Financa i ka krye punët e veta dhe unë kam pasur ndonjë situatë sepse me pas ditë i

kisha thirre edhe shefat e grupeve, kisha bo seancë paraprake të kuvendit mirëpo besoni që nuk u kon e lehtë mos me kalua në atë kohë për mua, për shkak se me ikë disa situatave, me i dhanë mundësi ekzekutivit të komunës me bo përmirësime apo sqarime, unë e kam tërheq prej rendit të ditës që natyrisht jo dhunshëm por e kam tërheq sepse propozuesi pra kryetari i komunës ka vlerësua me lanë për një etapë tjetër ndoshta me i bo këto përmirësime, me i adresua këto shqetësime të cilat ju i keni thanë këto dhe ne maksimumin e kemi bo. Unë ju ftojë me votua Kornizën afatmesme buxhetore gjegjësisht buxhetin për vitin 2020 si një e mirë e madhe e jona e përbashkët për të ja kthyer për të mirë qytetareve të kësaj komune natyrisht që ky buxhete prej mbi 14 milion eurove pastaj 40 milion edhe me donatorë edhe me ndonjë grand qeveritarë sepse sa me shume që ne absorbojmë fonde e hime neper programe edhe me mirë është për qytetarët e Komunës. Sa i përket keq klasifikimeve edhe njëherë po them auditorin e kemi, ma mirë ju më lan faje mua sepse edhe unë duhet me i marr përgjegjësitë fajet e të metat e mia por unë besoj që është momenti shumë i përshtatshëm që të aprovohet buxheti kuptohet duke i marr parasysh vërejtjet, sugjerimet, rekomandimet e kuvendit të Komunës. Urojë që të kaloj buxheti edhe unë besoj që ne kemi me u pae prapë edhe kemi me u pae ballë për ballë, nuk kam dëshire askënd me pae kokulur sepse e tha edhe drejtori Afrim Limani që e keni pae edhe vet se afërsisht 1 milion euro është diferenca kuptohet diferencën me shume e ka rrit ligji i pagave dhe se di a do të bëhet fuqiplotë dhe na kemi rritje në buxhetin e pagave gjithkrah, nuk është se janë rritur shumë investimet kapitale, ka një rritje të vogël por jo sa kemi nevojë ne ose siç kemi kërkesë si komunë edhe sikur komunat tjera. Faleminderit shume, nuk jam dal këtu me ju dhanë sqarime secilit, jam përpjekur me bo një shpjegim parimor për katër shefat e grupeve parlamentare. Ne jemi këtu dhe kërkoj edhe njëherë me aprovua buxhetin e Komunës se Rahovecit.

Afrim Limani – E ndiej si obligim me ju dhanë një përgjigje të shkurtë për disa çështje të cilat u ngritën edhe pse shumë gjëra i tha edhe kryetari. Dua të filloj nga pyetjet e parashtruara nga Rasim Fazliu, Fehmi Cena dhe asamblistë të tjerë dhe përgjigja ime do të ndërlidhet edhe me pyetjet që i kanë bërë edhe të tjerët. Të hyrat vetanake në total janë të pakta, nga pyetja e parashtruar në krahasim me vitin e kaluar se pse janë të pakta. Nëse ju kujtohet të nderuar asamblistë edhe në raport financiar e kam potencuar këtë çështje edhe kam kërkuar nga Ministria e Financave që me i rritë të hyrat vetanake, këtë nuk kemi mundur me bo për shkak se arsyetimi i tyre ishte se ne jemi brenda kornizave dhe tani nuk mundemi mirëpo edhe këto të hyra të cilat janë të planifikuara janë me të vogla në krahasim me vitin e kaluar dhe duhet ta dimë një gjë se gjobat e gjykatave dhe të trafikut tani nuk planifikohen ne kuadër të komunës sepse këto të hyra planifikohen drejtpërdrejt nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ne këtë vite i kemi pasur 180 000 euro vetëm gjoba në trafikë edhe afërsisht 17 000 atje llogaritet që buxheti jonë sikur të kishim planifikuar ne atëherë përafërsisht edhe mbi 20 000 euro do të ishte rritur vlera e buxhetit. A do të kishte pasoja sikur të ishte planifikuar në shtator, kjo e mirë pozitive e kësaj është sepse ndoshta pikërisht tek të hyrat vetanake pasi neve veç sa na ka ardhë një shkresë nga Ministria e Financave duhet ti rirregullojmë pasi kjo na është gjetur në kohën me te përshtatshme të planifikimit të të hyrave. Te keq klasifikimet u parashtrua pyetja, tek hartimi i projekteve që është në kuadër të listës së projekteve kapitale sepse e kam sqaruar edhe ne Komitetin për Politike dhe Financa, nëse i hije të hartimit të një projekti kapital e rritë vlerën e atij projekti dhe kjo është e përcaktuar saktë me ligje. Siç e thash edhe në fillim, po besoj që kemi bërë një planifikim jashtëzakonisht të mirë të hyrave vatanake sepse e kemi pasur edhe kohën në dispozicion edhe krahasimi në baze të realizimit, por pasi keni kaluar edhe ju një mandatë si drejtor këtu ta besoj edhe e pranoj propozimin tuaj. Pra duhet ta potencoj se nuk ka keq klasifikime pastaj Masari dhe Ftoni e bënë pyetjen e njëjtë tek ndryshimi i buxhetit sepse grandit i përgjithshëm është rritur në atë vlerë edhe limitet dhe tavanet buxhetore i cakton Ministria e Financave në kategori të veçanta si p.sh. në paga e cakton shumen e caktuar se sa duhet të jetë atëherë ne nuk guxojmë me lëvizje brenda asaj strukture edhe mallrat dhe shërbimet janë rritur për një vlerë të caktuar me kërkesë tonë duke ditur se i kemi ikur keq klasifikimeve në mënyrë që mos të na kalon limiti i caktuar mbi vlerën 140 000 pra kjo është arsyeja sepse i

cakton Ministria e Financave limitet dhe tavanet pastaj Dervish për sugjerimet dhe vërejtjet e tua i kemi parasysh në të ardhmen.

Fehmi Cena – Para se me vënë në votim, kishim kërkuar një pauzë prej 10 minuta, sigurisht nëse pajtohen edhe të tjerët.

Rasim Fazliu - Unë mendoj që të gjitha bisedimet i bëme dhe unë mendoj që çfarëdo konsultimi që bëjmë nuk mundemi me i tejkaluar pasi na e dhamë qëndrimin tonë si PDK edhe tash unë nuk mundem me bo marrëveshje tjera pra nuk kemi çka me ndryshuar pasi na e dhamë qëndrimin tonë, vërejtjet tona dhe të gjitha çka patëm për ti thënë edhe tani mendoj se nuk kemi çka me kontribuar diçka me tepër.

Fehmi Cena – Për t'i qartësuar, ne si grup i LDK-së po e themi kështu pozicionin tonë definitiv, në të gjitha vërejtjet i kemi grupuar në tre grupe: tek planifikimi i të hyrave vetanake, ato vërejtje që i kemi pasur ne thamë që janë përmirësuar dukshëm edhe për atë s'ka asnjë problem, te specifikimi i projekteve që e kemi shikuar, unë përmenda shifrën, afërsisht 80% i keni specifikua mirëpo 20% nuk i keni specifikua. Ne jemi të vetëdijshëm se edhe në të kaluarën nuk ka pasur specifikime të projekteve nëpër kode dhe në rregull është edhe megjithatë është një përmirësim por te keq klasifikimet kjo është ajo pjesë e pakalueshme. Nëse e kërkon votën tonë, unë e thash që është një pjesë që ne mendojmë se bie ndeshë me ligjin, me rregullat dhe kjo është e pakalueshme. Ajo çka është kapitale pra është kapitale, e thamë shuma prej 605,000 euro e keni nga subvencionet dhe mallrat e shërbimet në kapitale, pra është keq klasifikim, po e potencoj ne jemi të gatshëm që këtë shumë që të mos humbet buxheti prapë ta ri destinojmë për projekte kapitale që gjithashtu është në interes të qytetareve pra kemi ku të investojmë edhe në infrastrukturë rrugore, në ujësjellës, në kanalizime, ujëra atmosferike në qytetin Rahovecit që asgjë nuk është bërë deri me tani, edhe në arsim edhe në shëndetësi. Për subvencione jemi gjithashtu për subvencionimin e bujqve por nga buxheti për subvencione e jo nga kapitalet sepse jam i sigurt se kemi me pas vërejtje përsëri nga Zyra Kombëtare e Auditorit dhe nuk kemi dëshirë me i përsërit këto do të thotë ju e keni përgatit buxhetin, nuk po themi që është shume i keq, që mendoj se ka shumë gjëra të mira mirëpo ne duam që i gjithi të jetë sa më i mirë dhe sa më i kalueshëm edhe konformë ligjeve edhe rregullave pra të jemi më të pastër ndaj qytetareve tanë. Faleminderit.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendarë, e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës. Të nderuar kuvendarë, me 20 vota pro, 1 kundër dhe 6 abstenime konstatojmë se aprovohet buxheti për vitin 2020. Faleminderit shumë.

Sali Sallteku – Unë e di që jemi në shërbim të qytetareve të gjithë ne këtu por le ta dinë të gjithë kuvendaret edhe ata që e votuan edhe ata që nuk e votuan se nuk i kemi bo hajrë komunës pasi Kryetari pak me përpara tha se nuk e kam ditë se qysh ka me ardhë puna pasi nuk e din se ku i ka shtatë delegatë. Unë mendoj se është deshtë me ditë që mos me ardh në këtë gjendje qashtu si tani. Faleminderit shumë.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2019.

Afrim Limani – Përshëndetje edhe njëherë të nderuar asambleistë, raporti financiar i komunës së Rahovecit për vitin 2019 konsideroj që në këtë raporte janë të futura të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet financiare të cilat janë zhvilluar gjatë vitit fiskal 2019. Për dallim prej herëve tjera, ky raporte kësaj radhe ka një formë tjetër të dizajnit edhe janë të futura të gjitha shënimet në mënyre analitike në bazë të llogarive të arkëtueshme të cilat i kemi. Raporti përbehet prej 3 pjesëve: pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimeve të buxhetit dhe pjesa e aktiviteteve të prokurimit të cilat kanë ndodhur gjatë vitit fiskal 2019. Unë do të jem më i shkurtër kësaj here në raportim duke ditur që kemi edhe shume pika tjera të rendit të ditës mirëpo shkurtimisht do të them disa të dhëna. Të hyrat e komunës së Rahovecit për vitin 2019 në total janë 1 308 477 euro bashke me gjobat e gjykatave dhe të trafikut. Kur e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë kemi një rezultat të hyra pozitive me një vlerë prej 148 297 euro. Realizimi i buxhetit është në masën prej 14 688 601 euro kështu që në total përqindja e shpenzimit të buxhetit është 98.71% që është një performancë e mirë e shpenzimit të buxhetit dhe kjo performancë është njëherit edhe kriter për thithjen e donacioneve të ndryshme qoftë në donacione të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Pastaj i keni në raport kategorinë e shpenzimeve të

mallrave dhe shërbimeve sipas kodeve ekonomike të përshkruara në mënyre të detajuar dhe krejt në fund do të ju tregoj pjesën e borgjëve të cilën i kemi bartur për vitin 2020 dhe këto janë në mallra dhe shërbime kemi 96 091 euro që është performance e mire e shpenzimit të buxhetit njëkohësisht edhe këtë vitë bartim më pak borgje se në periudhën e njëjte të vitit të kaluar ku e dimë ne se kemi bartur dikun prej 176 000 euro kurse tash i kemi 96 000 euro, shpenzime komunali kemi 7239 euro, subvencione 1580 euro dhe investime kapitale prej 765 426 euro që do të thotë se borgji financiar ka zbritë dukshëm në raport me periudhën e njëjte të vitit të kaluar kur i kemi pasur mbi 1 milion e gjysme. Unë më tepër nuk dua të ju marr kohë, pres ndonjë pyetje nga ana juaj.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për prezantimin, fjala është për ju kuvendarë të nderuar, nëse dikush ka diçka për të thënë.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, fillimisht e falënderoj drejtorin për paraqitjen e raportit financiar për vitin 2019. Nëse bazohemi tek tabela 1.3 shohim se nga viti në vite kemi rritje të hyrave të rregullta apo vetanake. Në vitin 2019 kemi tejkalim të hyrave kundrejt asaj sa janë planifikuar, kjo është mirë dhe ju gëzohem këtyre shifrave por konsideroj se kjo nuk ndodhë për shkak planifikimit të dobët apo keq planifikimit p.sh. tek kodi 40110 tatimi në pronë dhe tatimi në tokë. Planifikimi për 2019 është më i vogël se realizimi që është bërë në vitin 2018 pastaj tek kodi 50409 participimet nga bujqësia që planifikimi për vitin 2019 është larg realizimit që ka ndodhur në vitin 2018 e të tjera. Këto tregojnë se planifikimi nuk është bërë si duhet edhe ka ardhë deri te tejkalimi i planifikimit ndërsa tel tabela 3.2 shpenzimet sipas kategorive ekonomike, mendoj që shpenzimi i mjeteve buxhetore neper kategori ekonomike është në nivelin e duhur. Urojë që kjo përqindje e prezantuar të përputhet me shifrat që do të dalin nga auditori i përgjithshëm. Te mallrat dhe shërbimet kemi rritje të shpenzimeve krahasuar vitin 2019 me vitin 2018,. Në vitin 2018 janë shpenzuar 975 105 euro ndërsa ne vitin 2019 janë shpenzuar 1 352 072 euro d.m.th. 376 968 euro më shumë. Faqe 21 tek raporti i obligimeve të papaguara për vitin 2019 tek tabela 4.1 mallra dhe shërbime, me erdhi interesant se faturat e vitit 2016 dhe 2017 disa ishin të papaguara kurse ne vitin 2018 të gjitha ishin të paguara. Mendoj se pagesa duhet të bëhet me radhë sipas viteve e jo të kryhen të vitit 2018 kurse të viteve të mëparshme 2016 dhe 2017 mbesin pa u paguar. Gjithashtu edhe ne raportin financiar për vitin 2019 mungon paraqitja e buxhetimit gjinorë në mënyre të detajuar. Ju faleminderit për vëmendje.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, ne kemi përpara raportin financiar për vitin 2019 të përgatitur nga ana e drejtorisë, më ç’rast e falënderoj për formën e prezantuar. Është e qartë, është e prezantuar në formën tabelorë gjithashtu e tha edhe drejtori në raporte me planifikimin ka pasur tejkalim të të hyrave edhe planifikimi natyrisht të hyrat janë planifikuar duke përfshirë edhe gjërat në trafik edhe në gjykatë, duhet pasur parasysh se prej këtij viti faktikisht këto nuk do të përfshihen në planin buxhetor për të hyrat dhe qeveria lokale duhet të ketë parasysh në mënyrë që ti përmbushë ato obligime që i ka marrë për këtë vit. Në faqe 5, dua të bëj disa ndërhyrje te krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike, do të thotë po e shoh që edhe nëse tatimi në pronë që konsiderojmë që është ajo forma ma e qëndrueshme e të hyrave që ka pasur rritje të hyrave por me poshtë nëse shikojmë disa kode tjera p.sh. kodi 5000 Taksa komunale për leje ndërtimi ne raport me planifikimin, të hyra ka pasur shumë pak pastaj është taksa për legalizim të objekteve gjithashtu nga 38,000 në 533 euro d.m.th. ka pasur pak të hyra pastaj shfrytëzimi i pronës publike gjithashtu që po i përmendi disa kode ku vërtetë ka diferencë të madhe në mes planifikimit dhe të hyrave nga 34,000 në 13,000 euro, qiraja në objekte publike nga 8,000 në 2,000, janë disa kode që duhet të shikohen mirë pse është kjo diskrepancë, te shëndetësia gjithashtu participimi ka qenë i paraparë 50,000 kurse të hyrat janë 37,695 euro, nuk është keq mirëpo ekzistojnë forma për me i rritë të hyrat edhe në shëndetësi p.sh. unë e kam cekur edhe më herët komisioni mjekësor për certifikata për patentë shofer, pse nuk po e formon QKMF-ja në Rahovec sepse aty krijohen të hyrat edhe krijohet shërbimi për qytetaret tanë, gjithashtu edhe sistemi i informimit

shëndetësor i cili ka çaluar në këtë vit i QKMF-së që gjithashtu inkorporon në vete të hyra shtesë edhe me siguri participimi kishte me qenë më i mirë, do të thotë drejtoria duhet të shikojë në të ardhmen të punoj në këtë drejtim. Te shpenzimet sipas programeve, janë prezantuar shpenzimet, te shëndetësia kemi pasur planifikim të shpenzimeve edhe për subvencione 50,000 euro që këtu nuk i kemi në tabelën 3.1 që është dashtë të prezantohen ato shpenzime se për çka janë bërë ato 50,000 euro, është përmendur se ato shpenzime do të bëhen për subvencione po ashtu edhe kategoria e ndihmave momentale për qytetarë më tepër për të sëmur që këtu nuk figuron pra është një vërejtje që unë kërkoj sqarim prej drejtorit pse nuk figuron këtu 50,000 që është paraparë ndërsa subvencioni në shëndetësi te shpenzimet është zero. Pastaj tabela 3.1 tek shpenzimet shërbime dhe mallra sipas kodeve ekonomike, ne kemi vërejtur se shpenzimet në raport me 2018 janë bërë me tepër në mallra dhe shërbime, një diferencë që nëse i përfshijmë edhe këto 96,000 euro borgj që po mbetet komuna edhe 377,000 pra afër 500,000 euro po mbetemi faktikisht që janë shpenzuar nga shërbimet dhe mallrat. Mendoj se kjo është një kategori buxhetore ku komuna mundet me kursyer me tepër edhe mos me bo shpenzime aq shumë, në mënyrë që ato mjete të kursyera pastaj të shfrytëzohen për projekte të ndryshme që janë në interes të qytetareve. Kisha me theksuar veçanërisht kodi 13501 mobile me pak se 1000 euro, për derisa për vitin 2018 shpenzimet kanë qenë 29,000 kurse në vitin 2019 kanë qenë 49,000 euro do të thotë është një diferencë e shpenzimeve shumë e madhe. Te pajisje tjera, me pak se 1000 euro që në vitin 2018 kishte 15,000 euro kurse në vitin 2020 kishte 60,918 euro, që është një dallim shumë i madhe, tek furnizimet mjekësorë gjithashtu ka pasur një shpenzim më të madhe nga 9000 euro në vitin 2018 ndërsa në vitin 2020 është 26,000 euro. E di që në shëndetësi munden të shpenzohen, ka arsye me u shpenzua mirëpo nuk e di për çfarë qëllimi janë shpenzuar këto të holla më tepër për vitin 2020. E kemi vërejtë se kemi pasur vërejtje rreth furnizimeve shëndetësore p.sh. për laboratorë, se kanë munguar reagencat për një kohë të gjatë etj. kështu që nuk mund të lavdërohem se furnizimet kanë qenë më të mira për vitin 2019 në raport me vitin 2018 ndërsa shpenzimet janë bërë me shumë kështu që drejtori sikur të ishte këtu mirë do ishte me na sqarua pak rreth kësaj. Sa i përket pjesës së borgjeve, obligimeve buxhetore të komunës drejtori i ceku, pyetja ime do ishte se pse kanë mbetur ashtu ato borgje dhe pse nuk janë paguar nga pjesa e buxhetit që është paraparë. Faleminderit

Kryetari – E di që raportin financiar e përgatitë drejtoria për Financa dhe Buxhet por natyrisht që dikush mundet me thanë se pse s’po del drejtori ka me dal menjëherë mirëpo unë po duhet me i dhanë disa sqarime që për bindjen time janë parimore dhe të nevojshme. Ligji për legalizime përkatësisht udhëzimi i ri, në shtator të vitit 2019 ata që janë të informuar e dinë, drejtori i urbanizmit është këtu prandaj ne kemi besue që mundet me rifillua ose me fillua procesi i legalizimit edhe më herët që nuk ka ndodhur tek ka fundi i vitit 2019 prandaj edhe nuk është planifikim i keq por nuk ka mundur me pas të hyra, tash kemi prurje nga legalizimet jo në masë të madhe mirëpo kanë filluar, besoj që është i aplikueshëm edhe kanë filluar me ardhë kërkesa. Te qiraja në objekte publike ka vështirësi në realizimin e të hyrave edhe nga ky pozicion për shkak se perveq këtyre kompanive reklamuese që i bëjnë ato, kemi edhe disa obligime që s’kemi mundur me i trashëgua që 20 vjet që janë borgje të këqija që vazhdimisht kemi pasur edhe vërejtje prej auditorit te qiraja pastaj tek objektet publike, tek taksat afariste që janë grumbullua disa borgje që kanë mbetur, tash kemi fillue edhe me përmbarues të merremi por sidoqoftë përpjekje janë botë demonstron se po bëhet planifikim i mirë. Në QKMF nuk e kemi harruar faktin që janë dy ndërrime nga gjysma e dytë e vitit 2018-të dhe në vitin 2019 janë dy ndërrime në Krushe dhe në Ratkoc, natyrisht se shtohen edhe shpenzimet, pastaj ju keni pae se ka ndriçim publik në Dejnë, ka disa pozicione që u rritë pozicioni i hargjimit të buxhetit edhe ne ndriçim publik pastaj është shume me rëndësi që ta vlerësojmë edhe një fakte se palestra sportive është përruar dhe paramendoni sa ka rritje të shpenzimeve edhe në komunali edhe në mallra dhe shërbime sepse ka aktivitete shume dhe ka mirëmbajtje dhe plot shpenzime të cilat nuk janë kon dikur pastaj tek mobilet kemi pjesën që lidhet me palestrën sportive prapë ka si ne administratë që janë bërë edhe objekte te reja që të gjitha lidhen tek rritja e

shpenzimeve te mobilet që i përmendi Fehmi Cena, tek ndihmat momentale unë ju siguroj që ka një listë të publikuar për herë të parë se kush janë përfitues te ndihmave momentale me emër e mbiemër, dikush na ka thënë se nuk keni të drejtë me publikua mirëpo ne i kemi thënë vetes se kemi të drejtë për shkak se 10 poenta i kemi humbur për shkak se nuk i kemi publikua edhe pse bien ndeshë me ligjin për mbrojtjen e privatësisë por është një organizate që i monitoron dhe ne kemi fitua dhe jemi rendit që veç Kamenica edhe dy apo tri komuna tjera i kanë publikua analitiken d.m.th. krejt kush ka marr të holla prej komunës se Rahovecit edhe nga qeto 50 000 listën në webaqen zyrtare që kemi këtu zyrtarin kompetent Azizini që mundet me na demantua, nëse nuk është kështu pra për herë të parë publikohet me emra dhe mbiemra dhe ai që ka qenë me gjendje keqe shëndetësore që ka marr shumën e 50 apo 100 euro e ka emrin të regjistruar d.m.th. ne e kemi marrë këtë guxim, nuk i sigurt a kemi bërë shkelje ligjore por disa komuna po e bëjnë edhe po përfitojnë projekte kapitale apo grande për shkak se po jep poenë shumë në qoftese po bëhet ajo analitika që këta që merren me financa e din ma mirë. Tek planifikimi i të hyrave, tatimi në tokë ka figurua por as sivjet nuk bëhet tatimi në tokë që është shtyrë për vitin 2021, unë kam besua që sivjet ka me fillua me u aplikua tatimi në tokë mirëpo është shtyrë për vitin 2021, që ka pasur të bëhet vitin e kaluar, sivjet është prit me u bo mirëpo është shtyje prapë edhe për një vite kështu që nuk është keq planifikim por janë ndoshta defektet që atyre që i aprovojnë ligjet, që i nxjerrin udhëzimet administrative, që i japin direktivat komunave se si me veprua ne tatimin në pronë edhe në tatimin në tokë. Pra mirë është që i kemi zvogëluar borgjet ndërsa për detaje se pse nuk janë paguar ato borgje për 2017-2018, nuk duhet të harroni që ne kemi edhe konteste ndoshta ka edhe borgj edhe te vitit 2018 që nuk mundesh me pagua por ndoshta ka të vitit 2016 që je i obliguar me pagua d.m.th. kemi situata të cilat i qartëson drejtorja e financave me thesarin pra operatorin ndoshta me gjykatat apo ndoshta ka diçka kontestuese etj. Që s'po dua të futem në detaje, që me siguri i jep drejtori Afrim Limani. Tek SISH-i, ndoshta me përrurimin e qendrës të objektit të emergjencës mundemi me pas me shumë motivacion, përkushtim dhe me shumë angazhim për me aplikua në mënyrë me të mirë SISH-in (Sigurimi informativ shëndetësor), që me siguri doktor Fehmiu e din më mirë se për çka e kam fjalën, në nuk është që s'kemi provua mirëpo nuk ka. Pse nuk janë rrit me shumë të hyrat në QKMF. Ju e dini që ky kuvendë ka marr vendime, ka ndryshua, ka plotësua rregullore, kemi liruar shume kategori prej taksave, ka plot raste sociale, veteranë, invalidë, familje të dëshmorëve që po ashtu ka edhe kategori tjera që unë po pajtohem që duhet me zgjerua bazën e financimit, nuk po dua me lan gjithë fajin se pse nuk po ndodhin këto të objektit të ri që ende po na mungon e që po shpresojmë me përrurua sa ma shpejtë por une mendoj që na duhet me bo bashkë diçka me zgjerua bazën e të hyrave se ka edhe prej atyre që s'janë të liruar, që ndoshta mjekët aty nuk i këqyrin disa gjëra edhe nuk i shtinë me pagua sikur puna ime hajt se është kryetar komune dhe nuk ja kërkojnë as qatë 1 euro për participim që kam vet këso raste, pra më mirë 37 000 se sa ka raste edhe me pak, ne i kemi planifikuar 50 000 mirëpo 37 000 janë mbledhur. Unë mendoj që munden me u mbledhë edhe me shumë ndoshta jo nga ai participimi 1% mirëpo mundet me u zgjerua baza e të hyrave në qendrën kryesore të mjekësisë familjare edhe njësitet e saj që i ka nëpër vendbanime. Tek servisimi i veturave edhe pse nuk e përmendi kerkush mirëpo raportin ne e prezantojmë, ju e vëreni se dikun ka rritje edhe dikun ka zvogëlime, ne gjithashtu bartim edhe borgje prej vitit në vite, normalisht që prej vitit të ardhshëm, ndonjëherë disa kerre servisohen sepse duhet të servisohen prapë se janë kerre të vjetra, ndonjëherë p.sh. vetura zyrtare kur të servisohet njëherë i duhet pas 2 apo 3 vjete me u servise prapë d.m.th. ne nuk mundemi me dit saktësisht, pastaj kemi rritje të shpenzimeve të karburanteve sepse u rrit edhe çmimi i karburanteve, ju e dini se kontratat nuk i bëjmë ne por i bënë Ministria e Administratës publike që atje centralizohen dhe ne vetëm i bëjmë kërkesat pra në disa vende shihni zbritje dhe ne disa pozicione kemi rritje dhe krejt varet se për çka, besoj që për këto është ne gjendje drejtori Afrim Limani me ju shpjegua deri në detaje. Tek buxheti i grave atje edhe unë jam pro këtij buxheti mirëpo nuk e di edhe për këtë i kam thënë drejtorit ma specifikisht me ndaje një

buxhete ose nen kode të veçantë edhe për rini edhe për gra, qe dikush me ka thënë se një komunë e k mbërri me bo mirëpo me gjasë e kanë fillua me herët, tash na nuk mundemi me i ndërrua kodet kur duam por mirë është me u buxhetue edhe rinia specifikisht edhe gratë edhe kategoritë e veçanta por nuk është që nuk ju kemi ndihmuar ne për ndonjë kërkesë që kanë pasur ose grupi joformal i grave ose të rinjtë por unë jam për me buxhetue spocifikisht me hap nën kodë ose me bo nën program për gratë, për rininë, nuk e di a do të mbërrimë me bo që edhe për këtë mundet me ju shpjegua ma konkretisht drejtori Afrim Limani. Faleminderit shume.

Afrim Limani – Disa pyetje i bëri Florida Bajraktari, vërejtje ne planifikim të të hyrave vetanake, ne kemi diskutuar edhe shumë herë që limitet i cakton Ministria Financave se sa duhet me qenë të hyrat vetanake të një organizate buxhetore për një vite fiskal, tani në rastin konkret edhe të Komunës tonë, Unë e thash edhe më herët, në e kemi adresua një kërkesë në Ministrinë e Financave, në mes të hapësirës të qarkores së parë dhe të dytë që me na i rritë të hyrat vetanake mirëpo kërkesën tonë nuk e kanë aprovuar edhe ka mbetur ashtu siç ishte. Pastaj tek të hyrat tatimore, vete Ministria e Financave i cakton limitet do të thotë komuna juaj aq do ta ketë tatimin në pronë dhe për këtë ne nuk jemi të lirë me bo planifikimin. Por konsideroj që edhe te kalimi i të hyrave është një ndryshim prej 150 000 afërsisht edhe sikur të ishte kjo shumë e planifikuar më shume për të hyra vetanake atëherë e kishim realizua objektivin, si do që të jetë është një inkasim i mirë i të hyrave vetanake duke ditur dhe duke bërë krahasimin me periudha tjera të vitit të kaluar psh vitin 2019 kemi ndryshimin 150 000 euro që konsideroj që është jashtëzakonisht e mirë për komunën tonë. Shpenzime të mëdha në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, vërtet që kemi shpenzim më të madhe por edhe të mallra dhe shërbimi i kemi pasur me të larta në krahasim me vitin 2018 edhe për këtë përqindja e shpenzimit të buxhetit për mallra dhe shërbime ka qenë më e madhe edhe realisht ne nuk kemi lënë asnjë obligim pa e krye pra në maksimum e kemi bërë shpenzimin në kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve, dikun përafërsisht kjo kategori është 99%. Faturat e vitit 2016 pse nuk janë ekzekutuar. Pra vet po pyetja po të bën me kuptua sepse vitit 2016-2017 edhe qeverisja e kaluar ka pasur afate të plotë kohor për me i ekzekutua këto mirëpo ajo për një arsye apo tjetër nuk i ka ekzekutua këto edhe në faktë ne nuk e kemi pasur edhe bazën ligjore për me i krye mirpo e ndiem si obligim me bartë një borgjë që figuron pra ne kemi mundua edhe mos me paraqit si borgjë mirëpo unë e thash qysh ne fillim se ky raportë është shumë transparent edhe ne e bartim, nëse krijohet hapësira baza ligjore edhe pse është viti 2016 ne mundemi me ekzekutua këto. Doktor Fehmi Cena i parashtroi disa pyetje si mos harmonizim, planifikim dhe realizim i të hyrave vetanake, pra kjo është bërë edhe si temë planifikimi por e thash edhe në paraqitjen e buxhetit se ka pasur disa vërejtje mos harmonizim mirëpo me planifikim të buxhetit të vitit 2020, ne i kemi eliminuar këto edhe besoj që viti 2020 do të shkojë mirë. Një pyetje tjetër ishte diferenca e madhe e shpenzimit të buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në mënyre analitike do të thotë mobiljet edhe te pajisjet. E vërtetë që të mobiljet ka një ndryshim të madhe të shpenzimeve të mjeteve mirëpo atë shpenzime kemi bërë kryekëput për palestrën sportive, pra na duke ditur që kemi një kontratë me një operator atëherë nuk e kemi hapë një tender të ri pra e kemi shfrytëzua kontratën ekzistuese dhe krejt furnizimin për palestër do të thotë karriket, tavolina që janë atje, e kemi shfrytëzua përmes kësaj kontratë edhe për këtë u rritë vlera e këtij kodi. Pastaj tek pajisjet tjera, edhe këtë ka një ndryshim të madhe në raport me vitin e kaluar të shpenzimit të buxhetit mirëpo arsyeja është sepse na në vërejtjet dhe rekomandimet e auditorit kombëtarë që na ka dhënë në keq klasifikime atëherë jemi detyruar që një pjesë të borgjit për projektin sinjalizimi horizontal dhe vertikal i mjeteve dhe ai projekte nuk figuron në listën e projekteve kapitale atëherë pjesën e borgjit e mbetur dikun 46 000 euro, ne e kemi paguar përmes këtij kodi projektin e sinjalizimit. Pastaj një pyetje tjetër ishte se pse nuk janë paguar këto borgjet të cilat janë paraqitur këtu në raporte do të thotë ne s’kemi pasur mjete buxhetore dhe kjo është arsyeja, por një pjesë e madhe e borgjit në komunalë që ekzistojnë aty nëse e keni vërejtje, janë faturat e vitit 2020 mirëpo ne i kemi protokollua

në vitin 2019 edhe ne bazë të protokollit i kemi vendosë si shpenzime. Unë e thash edhe ne fillim se raporti është shumë transparentë, në kemi mundur që këtë mos me ngarkue vitin 2019 mirëpo kemi veprua sipas ligjeve dhe rregullave financiarë.

Fehmi Cena – Për shëndetësi, unë kisha një pyetje për 50.000 euro që kanë qenë të parapara në subvencion, këto tjerat shumë mirë i keni shpjeguar mirëpo aty është shuma zero, pra dallimi është i madh pasi ska shënime, ne e dimë se shëndetësia ka dhënë ndihma që e ceku edhe kryetari se ka dhënë ndihma momentale në shumën 50,000 euro edhe qenka publikua edhe lista mirëpo ne këtu nuk figuron fare as si kategori buxhetore që është shpenzua kjo shumë, a mendon ti që duhet edhe një kodë buxhetore të shpenzimeve p.sh. për ndihma momentale, në mënyrë që ne me ditë, nëse ekziston një listë me emra dhe mbiemra, pse të mos ekzistojë këtu edhe një kod ndihma momentale kaq janë dhënë, së tash po mungon edhe subvencioni i shëndetësisë edhe kjo ndihma momentale nuk është transparente karshi buxhetit që ju e keni prezantuar.

Afrim Limani – Kërkoj falje doktor se unë e kam shkruar këtë pyetje edhe harrova të përgjigjem, në nuk mundemi me bo kodë të veçantë mirëpo këto ndihma momentale janë në kuadër të subvencioneve në shëndetësi, fakte që nuk figuron aty në raporte që edhe unë e vërejta një gabim teknik mirëpo pjesa e shpenzimeve të buxhetit në total është në kuadër të atij tabelari do të thotë që vetëm që nuk kemi mundur me specifiku për shëndetësi, pra ishte vetëm një gabim teknik dhe për këtë të falënderoj.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, atëherë edhe më që nuk ka të tjerë të lajmëruar për këtë pikë, kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për tejkalimin e të hyrave vetanake për vitin 2019.

Afrim Limani – Përshëndetje edhe njëherë, më ligjin e Financave publike dhe përgjegjësi konkretisht neni 35.3 aty shkruan qartë se nëse një organizatë buxhetore bën tejkalimin e të hyrave vetanake atëherë kuptohet që me vendim të kuvendit duhet të nxirret vendimi i kuvendit dhe pjesa e mbetur e të hyrave vetanake të shpërndahet në kuadër të projekteve të caktuara. Kështu që Komuna e Rahovecit planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë 1 168 768 euro, realizimi 1 308 518 euro do të thotë një ndryshim prej 135 750 euro, pra ky ndryshim ne e kemi orientua në projekte të caktuara duke marrë parasysh pjesën projekteve që janë më të ndjeshme edhe projektet të cilat i kemi borgje më shume por ka edhe projekte të cilat me një pjesë ndarëse të mjeteve mundemi me mbyllë edhe atë kontratë. Prandaj e kemi bo atë shpërndarje, e kemi menduar me bo shpërndarjen në këto projekte, ngrohja qendrore në shkollat e komunës së Rahovecit 36 000 euro, ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në komunën e Rahovecit 20 000 euro, ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe emergjencave 61 000 euro edhe ne fund investimi i zonave ekonomike në Opterushë 22 000 euro do të thotë krejt këto ne total bëjnë ndryshimin prej 135 750 euro. Kjo ishte vetëm pjesa e tejkalimit të planifikimit mirëpo ne kemi sigurisht në seancën e shkurtit e kemi edhe pjesën e mbetur të hyrave vetanake që teprica që një pjesë për një arsye të caktuar që nuk është bartur atëherë do të jetë edhe pikë tjetër e radhës ku do të i caktojmë shpërndarjen e të hyrave vetanake. Faleminderit

Ali Morina – Faleminderit kryesues, ne këtë vendim në pikën 1 thuhet: vendimi për tejkalimin e të hyrave vetanake për vitin 2019 dhe bartja e buxhetit të pashfrytëzuar nga viti 2019 në vitin 2020, në pikën 3 figuron vetëm shuma e pjesës së rritjes së të hyrave vetanake pra a kemi të bëjmë këtu vetëm me një gabim teknik dhe nëse nuk është gabim teknik atëherë pse nuk figuron edhe shuma e mjeteve të bartura të pashfrytëzuara. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit z. Morina, atëherë pasi nuk kemi tjerë të lajmëruar për këtë pikë, e qesim në votim pikën e pestë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i implementimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm sipas planit të veprimit për vitin 2019.

Afrim Limani – Përhëndetje edhe njëherë, zbatimi i rekomandimeve të auditorit kombëtar të cilën e kam marr një pikë të cilën e kam marr sugjerimin nga ana e kuvendit, qe unë si drejtori e Financave të them të drejtën nuk e kam ditë që duhet me dalë mirëpo si do që të jetë, në si drejtori e Financave por edhe ne përgjithësi si Komunë, momentin e pranimit të raportit të auditorit kombëtarë me të gjetura dhe rekomandime të tyre, në vazhdimisht jemi marrë edhe konsideroj që i kemi zbatuar disa nga rekomandimet por me së miri ato janë të paraqitura në këtë raporte unë si në totalë do të ju tregojë shifrat se sa, këtu i kemi gjithsej 21 rekomandime, te zbatuara janë 14, pjesërisht të zbatuara janë 5 ndërsa të pazbatuara janë 2. Këtu të pazbatuara të them të drejtën, një nga këto rekomandime është sepse komuna e jonë nuk ka qasje, është fjala dokumentacionin e personelit të zjarrfikësve pra kjo ndërlidhet me zjarrfikëset dhe komuna jonë nuk ka qasje këtu pasi të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për zjarrfikëset i bartë Ministria e Punëve të Brendshme, komuna bën vetëm ekzekutimin e buxhetit që është në dispozicion me ligjet ne fuqi por këto besoj që nga viti 2012 zjarrfikësit do të kalojnë në kompetenca të plota në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme, këto tjerat besoj që i kemi zbatuar sikurse që janë të prezentuara në këtë raporte mirëpo me se miri presim edhe opinionin e auditorit kombëtarë kur ti raporton pasqyrat financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2019-të.

Fahrie Lushi – I nderuar kryesues, i nderuar kryetar, te nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit. Pra i përmendi edhe drejtori se na kanë ardhë 21 rekomandime dhe disa sipas drejtorit që janë zbatuara mirëpo edhe nga mbledhja në KPF kam kërkuar apo sugjeruar që të thuhet se ndoshta të korrigjuara sepse të zbatuara këto janë rekomandime të gjetura dhe nuk është në kohën e tashme por e dimë se cilit vite i përkasin këto. Unë i kam marrë disa çështje apo disa prej rekomandimeve, me qe drejtori e shpjegojë atë të stafit të emergjencës do të vazhdojmë me çështjen C2 dosjet e paarzhonuara të personelit dhe këto janë nga 21 mostra mirëpo drejtori i arsimit është këtu dhe kërkoje një përgjigje sepse në KPF nuk me ka dhënë përgjigje dhe thuhet se janë nga 21 mostra të audituara, prej tyre 9 janë në drejtorinë e arsimit dhe 2 janë në drejtorinë e shëndetësisë, ku janë disa parregullsi dhe janë gjetur disa dosje të cilat nuk flitet për përvojën e punës, nuk është përshkrua as koha e pushimeve dhe kërkesa e tyre kështu që këto më se miri do të na shpjegojë drejtori i arsimit. Mandej është edhe çështja A4 parregullsi në azhurnimin e stafit për shërbime të veçanta ku kemi të bëjmë me nenin 12 pika 4 ligji për shërbime civile, emërimet me afat të caktuar edhe këtë e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së mirëpo edhe këtu duhet një sqarim tjetër sepse thuhet që këto emëime me afat të caktuar jepen normal me një afate më të shkurtër se 6 muaj dhe do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura marrëveshje për shërbime të veçanta dhe të cilat patjetër thuhet se do të i nënshtrohen ligjit për detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit pra edhe kjo është një kërkesë tjetër për të cilën dua sqarim. Pastaj është edhe çështja A5 mangësi në procesin e pagesave sipas marrëveshjes për bashkëfinancim. Në dy raste thuhet se pagesa për shërbime kontraktuale në vlerë prej 20 000 euro se komuna kishte ekzekutuar pagesë për të cilat nuk janë ofruar dëshmi se janë bashkërenditur aktivitetet sipas marrëveshjes duke filluar nga përzgjedhja e stafit e deri tek raportimi i detajuar i atyre aktiviteteve dhe përmbushjes së qëllimit të këtij projekti është çështja A5. Pastaj çështja rekomandimi A6 dobësi sistematike në menaxhimin e pagesave për investime. Në dy raste Komuna kishte ekzekutuar pagesa në mungesë të raportit për pranimin e punëve ku vlera në totalë e pagesave ishte 15 206 euro, shkaku i kësaj pra edhe këtu ka dobësi sistematike në menaxhimin të pagave dhe shkaku i kësaj dukurie ishte neglizhenca nga ana e stafit dhe përgjegjësi për të implementue ligjet dhe rregullat në fuqi, ku si pasojë kanë dështua kontrollet e brendshme. Pos të tjerash është e rëndësishme ta përmendim edhe çështja A7 punët e realizuara pas periudhës së skadimit të kontratës dhe vlefshmërisë të sigurimit të ekzekutimit pra po i përmendi të gjitha një nga një më që janë të gjetura edhe janë interesante dhe duhet të bartin atë fuqinë kredibile dhe të kihen parasysh për vitin e ardhshëm sepse janë të gjetura mjaft të rëndësishme dhe thuhet se pos të tjerash specifikon se kontrata është 3 vjeçare, vlera e se cilës

është 517 784 euro e nënshkruar me 22.12.2014 dhe do të duhej të përfundonte në dhjetor të vitit 2017 ndërsa këtu është ajo që komuna ka bërë shkëlqen dhe të përfundonte në dhjetor 2017 megjithatë në bazë të situacioneve gjatë vitit 2018 janë realizua dhe pagua 90 000 euro pas skadimit të kontratës po ashtu edhe vlefshmëria e sigurimit të ekzekutimit të projektit të kërkuar sipas kontratës kishte skaduar, pra është paguar kjo shume 90 000 euro dhe komuna nuk është lajmëruar te zyra e auditimit kombëtarë para se të bëjë këtë pagesë. Po ashtu edhe çështja C3 nënshkrimi i kontratave pa zotime të mjaftueshëm të mjeteve, besoj që gjithsecili prej nesh e ka në dijeni se me çka ka të bëjë kjo dhe i është sugjeruar kryetarit që të siguroj që zyra e prokurimit të ketë kontrolle të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve sepse edhe këtu është nënshkruar kontrata në vlerë prej 16 480 euro ndërsa zotimi i mjeteve ka qenë vetëm 15 000 euro.

Faleminderit

Kryetari – Faleminderit, së pari Fahrie Lushi nuk e ka kuptuar rendin e ditës hiq, është total jashtë rendit të ditës. Ne po flasim për planin e zbatimit të rekomandimeve të raportit të zyrës kombëtare të auditimit për vitin 2019. Pra ky raport i auditimit i zyrës kombëtare është paraqitur në kuvendin e komunës së Rahovecit edhe aty ke pasur rastin me i lexua të gjeturat, ju jeni jashtë rendit të ditës sepse ne po flasim tani për planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve që i ka nxjerrë zyra kombëtare e auditimit për vitin 2019 dhe faleminderit që na i ke lexuar bukur mirë të gjeturat. Prandaj ne kemi bërë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, dy janë rekomandime të pazbatueshme që nuk varen prej fuqisë ligjore të komunave që janë në përgjegjësi e që realisht është dilemë se ne kemi nënshkrua memorandum që janë të tanët mirëpo në fakt i menaxhon agjencioni i emergjencave në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme. Në vetëm ekzekutojmë paga për ata nga buxheti jonë ndërkaq ende nuk kalon pasi kalon në vitin 2021 dhe ky rekomandim që auditorët e dinë dhe kjo vërejtje është për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës aty ku ka njësi zjarrfikëse azhurnimi i të dhënave kur thotë aty rekomandimi i zbatuar, prandaj ato të gjetura pra ky planë i veprimit ka pas për qellim me i zbatua rekomandimet, me i shikua mundësitë me i zbatua rekomandimet prandaj këtu e ke ngatërrua çështjen. Rekomandimet duhet ta dini se nuk jemi këtu për me na i lexua të gjeturat, në i kemi prua cilat rekomandime që janë adresua plotësisht, cilat janë adresua pjesërisht dhe cilat nuk janë adresua fare nga 21-sosh. Urojmë, që ju duhet me thanë tani edhe nuk po tentojmë me ju mësuja, duhet me thanë që për vitin 2020 urojmë që komuna e Rahovecit të ketë sa me pakë rekomandime e të gjetura sa më pak edhe konkluzione sa me pak edhe rekomandime të përsëritura sa me pak. Përndryshe zyra kombëtare e auditimit vazhdimisht edhe ushtrisë japoneze me i hije do ti gjen diçka prandaj komuna e banë një planë të veprimit sipas ligjit për me i zbatua rekomandimet dhe ka Komitetin e auditimit të brendshëm, e ka Kuvendin e Komunës si monitorues, si korrigjues si opozitë le ta themi që kërkon llogari dhe janë plotë mekanizma të kontrollit që i kryen edhe unë urojmë që raporti i sivjetme i zyrës kombëtare të auditimit që vjen për vitin 2019-të ka me qenë më i mirë se sa raporti që e kemi pae për vitin 2018 e që përsëri ka dalë raport me opinion të pakualifikuar ose pamodifikuar me theksim të çështjes që do të thotë që mbi bazën e atij raporti ne kemi fituar Grandë, për shkak se raporti pavarësisht të gjeturave nuk e ka cenuar opinionin që ja ka dhënë komunës së Rahovecit zyra kombëtare e Auditimit por të gjetura ka me pas vazhdimisht, natyrisht se kontrollet e brendshme kanë me u shtua pra te gjitha këto që i i thash vetëm deshtë me tregua se nuk jeni në rend të ditës edhe mos na i lexo të gjeturat sepse e ke raportin e publikuar edhe e kemi shqyrtua raportin ne vitin 2019 pikërisht këtë raport, ne i kemi marrur vetëm të gjeturat edhe rekomandimet edhe sa janë zbatuar ato rekomandime. Faleminderit Fahrie, por po besoj që nuk e keni kuptua edhe po e shoh ndonjëherë që s'po e kuptoni.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, unë kam lexuar atë raporte të auditorit që i ka rekomandua komunës për pjesene 21 rekomandimeve edhe Komuna është marrë me atë çështje prej 21-ve rekomandimeve edhe i ka krye punët me 14 prej tyre edhe siç e sqaroj edhe kryetari dy të tjerat hynë zjarrfikëset dhe ato tjerat me radhë.

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, unë për atë arsye të cilën ndoshta kryetari doli me një entuziazëm krejt tjetër para gjithë neve, unë kërkoj që kryetari të jetë pak më modest në këto raste e jo të ja fyej idenë e tjetrit sepse edhe nga KPF ne të gjitha grupet që kemi qenë prezentë, kemi thënë se nuk mund të themi se janë të zbatuara ani pse këto janë futur në një planë veprimi dhe ne i mirëpresim dhe i urojmë që të mos ketë të gjetura të tilla në të ardhmen mirëpo çfarë të keqe pati ajo që unë e diskutova sot dhe thashë po i përmendë me të vetmin qëllim që herave të tjera të mos na përsëriten këto dhe urojë që komuna jonë gjithmonë të ketë një raporte të auditimit të pamodifikuar sepse e njoh mirë këtë pjesë mbase i kam ndjekur disa trajnime sa për ti sqaruar kryetarit që e fyen personin në fjalë mua pra dhe unë ndihem shume keq për kryetarin që përdori një gjuhë të tillë. Faleminderit shumë.

Kryetari – E para është se unë nuk ju kam fyer, unë vetëm të thashë se jeni jashtë rendit të ditës pra krejt diskutimi juaj ishte jashtë rendit të ditës, në qoftë se ti e merr fyerje këtë, ju mund ta merrni si të doni, ju lutem ju po flisni për vitin 2018 kurse raporti është prezantuar për vitin 2019. Edhe njëherë po ju përsëris se keni qenë jashtë rendit të ditës, ju mund ta merrni si të doni, nuk kam për qëllim me fye askënd sepse nuk e bëj këtë në askënd, ne qoftë se ti ke mbërri me kuptua ky nuk është faji i jem, duhet ta keni të qartë këtë, unë po të them si në këtë rast po ju tërheqë vëmendjen sepse nuk ka të bëjë me fyerje aspak, nëse ty te vjen keq për atë që ju thashë për një të vërtetë që mos të humbeni kohë sepse në 2018 këto janë shqyrtua krejt, ne mundemi me vërtetua me zyrën kombëtare të auditimit se a janë këto rekomandime të përsëritshme apo jo. Për ndryshe mos harro se ne zyrën kombëtare të auditimit i kemi pasur dy javë këtu në Komunë dhe po ju siguroj se ka me qenë më i mirë raporti edhe prapë kemi me fituar grandin për shkak se raporti ka me qenë edhe ma i mirë sepse tash ka më pak keq klasifikime që i përmendëm me herët edhe ne përditë po e perfeksionojnë punën më mirë, po e rrisim kontrollin me shume edhe në këtë kuptim e them se ju ishit jashtë rendit të ditës.

Fehmi Cena - U kyçem rreth kësaj pike edhe diskutimit që u bë mes Fahries dhe Kryetarit. Në fakt Fahria nuk ishte jashtë rendit të ditës sepse ne e kemi këtë pike te rendit të ditës, në mundemi pakës me u hutua rreth kësaj se edhe vet raporti ndonjëherë Kryetar dhe Kryesues dhe të nderuar kolegë, neve na huton mënyrën se si ai prezantohet, se ndoshta edhe vetë raporti nuk është i prezantuar mirë sepse fjala është për raport, sa është zbatuar, nëse e marrim këtë shtyllën statusi i rekomandimit- i zbatuar, pjesërisht i zbatuar dhe i pazbatuar do të krijon huti tek ne për shkak se nëse thoni i zbatuar p.sh. rekomandimi i parë, PVF-ja, tek keq klasifikimet nëse ju thoni i zbatuar ne e dimë se ajo është zbatuar pra është kryer ne vitin 2018 dhe nëse mendoni se është kryer ai dhe do të bëhet ndryshe tash në të ardhmen krejt e ka kuptimin tjetër p.sh. do të ishte ndoshta më mirë me thënë i zbatueshëm, se i zbatuar nuk është edhe ajo nuk është i zbatuar në bazë të rekomandimit të Auditorit por është i zbatuar në bazë të asaj që keni punuar ju ose marrim p.sh. rekomandimin numër 7, këtë e kemi shqyrtuar edhe ne Komitetin për Politike dhe Financa, marrëveshje për shërbime të veçanta që prej 9 punëtoreve që janë punësuar me këtë marrëveshje 6 i kanë tejkaluar ato kornizat ligjore prej 6 muajve në kontrata mbi vepër por tash ju e keni cekur i zbatuar pra ajo është zbatuar mirëpo në bazë të punës tuaj që është krye më herët, e si me kuptuar tash a është i zbatueshëm, a zotoji ju se nuk do të përsëritet se ai është bërë pra është krye edhe nuk mund të kthehet mbrapa edhe Fahria e ceku se i takon të kaluarës por merret sikur në të ardhmen do të jetë i zbatuar. Edhe në fund unë pajtohem plotësisht me kryetarin që tha urojmë edhe ne që në të ardhmen të kemi sa më pak rekomandime, në mënyrë që të mos ketë të gjetura që bien ndesh me ligjin se në këtë raport e kemi shqyrtuar edhe vitin e kaluar edhe e kemi parë se ka pasur të gjetura të rregullta që do të dëshironim që mos të përsëriten.

Kryetari – Edhe një sqarim, unë e kuptoj që në qoftes duhet me mbrojtje diçka ne po e mbrojmë bashke por unë qëndroj dhe jam tepër korrekt dhe po e përsëris se është raport periodik për zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe në qoftë se nuk e ke kuptua edhe ti Fehmi prape nuk është faji im. Pra gjithçka është i qartë dhe nuk ka konfuzion, a i zbatuar apo i zbatueshëm ndoshta është mirë Fahria me u

përgjigj sepse është gjuhëtare por i zbatuar sepse edhe auditorët i kemi pasur këtu dhe në qitë temë ,për shkak se ata për me qit ne këtë se a është zbatuar apo jo, prape janë ardhë auditorët në Nëntor dhe përsëri kanë me ardh tash edhe kanë me nejtë këtu mbi një muaj. Pra ne po e dimë se ku po i kemi problemet edhe me auditorët, tash ne jemi në prag të fazës dyte intensivë të auditimit për vitin 2019. Unë besoj që ka me mbete prape kjo e zjarrfikëseve edhe skanë qare pa e shkrua ata aty, te azhurnimi i të dhënave, të marrëveshjet për shërbime të veçanta prape i kemi sqaruar edhe ato prandaj e kemi shkruar i zbatuar e jo i zbatueshëm, pjesërisht i zbatuar sepse ne kemi rekomandim edhe për obligimet kontraktuale për shkak se nuk po kemi pare edhe s'po mundemi me i zbatua edhe prandaj e kemi bërë pjesërisht. Unë po mendoj që mirë që po diskutohet por këto të gjetura, këto rekomandime janë zbatuar edhe ai raport edhe pse ka kaluar ne kuvendë pra ajo zyre kombëtare na ka konsiderua me opinion Rahovecin të pamodifikuar edhe ne kemi fituar grand. Pra nuk e kanë cenua opinionin e auditorit, unë jam kundër këtyre të gjeturave dhe është mirë me pas këso të gjetura edhe këso rekomandime por uroj që në këtë vite të jemi më mirë edhe unë besoj që do të jemi më mirë por se si kemi me qenë prape auditori ka me na tregua për vitin 2019.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, kolegët i ceken disa çështje, është e vërtetë se ne raportin e Auditorit të Përgjithshëm e kemi shqyrtuar në vitin 2019 d.m.th. raportin për vitin 2018 pra janë dhënë rekomandimet në raport të auditimit, ju tash e keni shikuar sa janë zbatuar dhe sa nuk janë zbatuar dhe shumë në rregull është ajo punë por desha me cekë çështjen A9 lëshimet aritmetikore në paramasat e kontraktuara. Unë dua të them kështu që Zyra e Prokurimit po flasim tani për të ardhmen sepse kjo tani ka shkuar dhe nuk mundemi me kthyer prapa por po flasim për vitet që jemi edhe në vijim, nuk guxon me bo gabime aritmetikore për shkak se i dëmton ata që marrin pjesë në konkurrim pra në tenderë dhe unë e di që shpesh gabimet bëhen të qëllimshme prandaj është ajo zyre aty për me i kontrollua se në qoftes Rasim Fazliu ka bërë gabimisht ose me qellim për me fitua tenderin, ajo këtë punë e ka për me korrigjua d.m.th. krejt kjo shkon në funksion të asaj që me bisedua me të gjitha këto zyre edhe me zbatua ligjin si duhet edhe mos me lejua gabime aritmetikore. Ju faleminderit.

Kryesuesi – Faleminderit z.Fazliu, atëherë edhe me që nuk kemi tjerë të lajmëruar për pikën e gjashtë, kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019.

Kryetari – E keni përpara raportin, nuk ka shifra financiare, nuk ka të bëj me çështje shume profesionale për shkak se i ka financat, ka të bëj me realizime, ngecje, sfida, prioritete që në një mënyre po tjetrën jemi përpjekur prej Kryetarit edhe nga zyra e kryetarit me të gjitha njësitë që i ka, drejtoritë me raportua, thjesht me sjellë informacion si Kuvendë i Komunës për të gjitha ato që në thelb kanë ndodhur për një periudhe kohore Janar 2019 Dhjetor 2020 .Raporti që është i hapur për diskutim që po ashtu është edhe publikë pra edhe ky raport është publik, ne qoftë se ju keni diçka për të thënë mund ta thuani tani, e keni përpara materialin krejt edhe është publikuar gati ë një muaj.

Rasim Fazliu – Faleminderit Kryesues, e falënderoj kryetarin për prezantimin e të dhënave për vitin 2019 për këtë raport e të gjitha drejtorive edhe gjitha kabineteteve tjera. Pyetja ime është konkrete, me që kaluan disa kohë prej qeverisjes suaj që është, e kemi fjalën për repartin e dializës, kur mendoni se mundeni me shti në funksion atë dhe qytetaret me i marr shërbimet këtu afër pra në vendin e vet në Rahovec, kjo është pyetja e parë edhe në raport nuk është e cekur ashtu mirë dhe pyetja tjetër desha me thanë se a keni bërë plane që ndoshta kjo është për pikën tjetër të rendit të ditës, pra për çështjen e mbeturinave që me marr komuna mbi vete menaxhimin e mbeturinave, në mënyrë që me i rritë të hyrat vetanake edhe me përfitua komuna edhe me përfitua qytetaret për këtë punë, këto dy çështje i kisha adresua unë. Faleminderit

Kryetari – Reparti i hemodializes është nder iniciativat me te mira dhe veprimet me te mira që ka mundur me bo komuna në këtë aspekt pra në këtë fushëveprimtari, për shkak se numri i pacienteve që kanë nevojë për trajtimin më afër me marr shërbimin po rritet pra nuk është që po zvogëlohet, besoj që investimi ka ndodhur ju

e dini, pajisjet me moderne janë aty, në kemi vazhduar një komunikim nga qeveria e kaluar, kemi vazhduar me drejtorinë e spitalit rajonal të Prizrenit, kemi shkua edhe me tutje me shefin e SHSUK-së drejtorin Basri Sejdiu dhe fillimisht ne kemi parë se diçka duhet të ndodhë shpejt, edhe unë vet kam besuar që po ashtu edhe drejtori ka besuar po ashtu edhe plot qytetare. Ne na kanë dhanë rekomandime se çfarë kushte teknike duhet me plotsue, i kemi bërë edhe disa mjete çka i kanë kërkuar ata për nevojat e veta po ashtu kemi shtie edhe buxhete shtesë për me i lypë disa gjëra krejt të vogla por të domosdoshme për me u kon i gatshëm për funksionim. Ndërkohe ka lindur problemi, kohëve të fundit ose ne vitin 2019 se spitali rajonal i Prizrenit nuk guxon me marr përsipër pa një njësi satelite të transfuzionit të gjakut. Ne ju kemi adresua me shkresë edhe spitalit edhe SHSUK-së që me na prue një njësi satelite të transfuzionit të gjakut, pra per neve ai ishte hapur qysh moti për Rahovec mirëpo ata që kanë përgjegjësinë me bo, nuk guxojnë tash njesin e transfuzionit të gjakut qoftë satelite pra kalimtare me hap repartin e hemodializes. Prandaj e kemi qitë synim tash se kur të vini të plani i punës sepse ata neve na kanë premtua se diçka do të bëjmë edhe po presim tash përgjigje decitive edhe me shkrim, se SHSUK-ja apo Enti i transfuzionit kombëtar i gjakut duhet me vendos për një njësi satelite ne Rahovec. Pra nuk guxon me u hap sipas ekspertizës tyre apo qëndrimeve tyre nuk guxon të hapet hemodializa pa u sigurua se gjaku është afër pra vetëm këtu ka ngelur, asnjë problem tjetër as teknik as të pajisjeve e as të personelit nuk mungon kurrëgjë por vetëm transfuzioni i gjakut. Premtimet janë kon pozitive sepse drejtorja e spitalit rajonal na kanë than se ata duhet me u pajtua se duhet me prua qoftë edhe një përgjegjës të transfuzionit të gjakut me ato pajisjet e veta ndoshta ndonjë teknik mundemi gjet ndonjë zgjidhje prej spitalit të Prizrenit por duhet patjetër me u kon njësi satelite e transfuzionit të gjakut. me u miratua dhe ne atë moment kur ne e kemi përgjigjen konkrete për këtë punë, ata bashke me ne dhe ju e hapin vetë dhe e marrin përgjegjësinë vetë. Pra kjo është e gjitha, po të ishte drejtori i pranishëm ndoshta e kish shpjegua edhe ndonjë detaje tjetër se ka edhe komunikime me letra sepse i kam nënshkrua edhe vetë po ashtu ka edhe drejtori që i ka nënshkrua, tash ka ngelur te transfuzioni i gjakut. Te çështja e mbeturinave, Komuna jonë ka dy kompani që merren me grumbullimin e mbeturinave edhe që i dërgojnë në basenin e mbeturinave në Landovicë, njëra kompani është publike apo me vetëfinancim „Ekoregjioni ose Ambienti,„dhe një kompani është private për momentin që mundet të bëhet edhe ndonjë tjetër „Ekodrinia,„ që natyrisht operon sipas një pëlqimi nëpër disa vendbanime. Do të ishte mirë me pas kompani komunale për menaxhimin e mbeturinave edhe unë jam për, po ashtu do të ishte mirë me pas edhe me shume investime edhe ne menaxhim, trajtim, riciklim të cilat nuk i kemi. Unë jam që kjo deponia legale e që është miratuar edhe ne Kuvendë të Komunës me qenë me funksionale, me e mirëmbajtur edhe me u bo edhe ndonjë deponi tjetër legale qoftë edhe e përkohshme për shkak se kemi telashe edhe me inerte shumë, për shkak se nuk i bien ai prej Krushes Madhe apo Celines ne Drenovc e as ai në Kramovik apo në Oplotushë që janë pak me larg. Do të ishte mirë me gjete një mekanizëm ligjor me sjellë në Kuvend të Komunës në bazë të një ekspertize dhe me bo njëfarë projekti ku mundemi ne se paku edhe përkohësisht inertet me i bartë. Ne kemi inerte përgjatë lumit Drini i Bardhë po ashtu edhe përgjatë rrugëve të asfaltuara sigurisht që me pak se ne te kaluarën, sigurisht edhe për shkak të gjobave mandatorë, por mbeturina edhe amvisërisë fatkeqësisht kemi edhe ne po hargjojmë buxhete here me aksione vullnetare edhe po hargjojmë buxhete per ti larguar ato nga vendet jo të duhura edhe që po bëhen edhe deponi të egra e sidomos ku janë vendet më të thella sikur Drini i Bardhë që u bë një vend për të ardhur keq. Sikur të kishim mundësi ne me bo një projekte ku i kishim bërë disa deponi çdo 5 apo 6 km edhe pastaj ne me i orientua pastaj edhe bizneset individuale por edhe ato familjare me i orientua ne pozicione te caktuara që me i derdhe mbeturinat sidomos inertet, se për këto që janë të amvisërisë këto kanë një zgjidhje tjetër, për shkak se shkojnë njëherë përnjëherë ne deponim në Landovicë po ashtu edhe unë jam i pajtimit me gjete ndonjë vend sepse ka edhe donator pra ka të interesuar por nuk është se jam shumë i kënaqur me Ekoregjonin, për shkak se ata e kryejnë punën e vet por inspektorët tanë që as ata dh askush s'po munden me ndalë ende derdhjen e mbeturinave vend

e pa vend edhe pse kemi shpesh veprime për me i largua këto deponi por prapë po përsëriten, edhe pse gjoba mandatorë po japim bukur shpesh, ne ende s'kemi mbërri me thanë që ky vend është pa mbeturina, sigurisht që ka me pak mbeturina, ka me shume frikë nga përgjegjësia e atyre që hedhin mbeturina por përsëri ka mbeturina çdo kundë, edhe pse e kemi fitua grandin e performances për mjedise, pra janë largua deponitë e egra por përsëri kjo deponia për Drenovc një dit para vitit të ri e kemi pastruar dhe larguar mirëpo përsëri kanë fillua me hedhë në atë vende. Tash unë s'po e akuzoj askënd sepse për të vepruar duhet një veprim me efikas sepse edhe policia ka drejtë me shqiptua gjoba mandatorë sipas udhëzimit të ri por unë s'po mundem me than asgjë por e di që në fokus dhe në prioritet të lartë është sa me pak me pas mbeturina e mundësisht e hiq mbeturina në këtë vende.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, unë kisha një pyetje për kryetarin, megjithatë ky plan i punës është mjaft ambicioz dhe po me intereson tash për ju kryetar se çka do të bëni tash pasi është licencuar çështja e Parkut pasi ne i kemi ndarë vetëm 10,000 euro, cilat do të jenë veprimet tua pra angazhimet e tua për me aftësua atë në shkallë të aftësisë për me vepruar apo për me ju dhanë në dispozicion bizneseve sepse unë e pash edhe planin e punës që është ne rend te ditës.

Fehmi Cena – Unë mendoj se pari që edhe kjo pikë është një pikë me rëndësi e rendit të ditës pra raporti i punës së qeverisë lokale të vitit të kaluar edhe unë po mendoj që megjithatë delegatët i inkurajojë që të kyqen në diskutim sepse nëse ne edhe nëse kritikojmë diçka rreth asaj çka nuk është punuar, asgjë të keqe nuk ka por vetëm se ndikon pozitivisht te qeverisja lokale. Ajo çka është bërë mirë nuk ka diskutim se është mirë mirëpo sigurisht se nuk është qeveri perfektë dhe diçka nuk është bërë mirë. Edhe pse unë pajtohem që ky raport është kështu voluminoz edhe nuk është lehtë për ne kështu kur marrim me diskutua pra është voluminoz për shkak se është gjithëpërfshirës pasi keni përfshirë gjitha drejtoritë pra është forma tre mujore e kemi vërejt se keni prezantuar ndoshta u deshtë pak me thjeshtësuar jo në formën tre mujore ashtu gjerë e gjatë por pak me shkurtua vjetore sepse në këtë mënyrë kur përsëriten tre mujoret do të përsëriten edhe disa gjëra të njëjta brenda raportit. Pastaj në raport duhet të ketë edhe ato që nuk është punuar do të thotë karshi planifikimit që është bërë duhet të shprehen edhe ato që nuk janë bërë edhe jepen arsyetime pse nuk janë bërë, ne i kuptojmë besoj. Unë isha ndal pak te shëndetësia tek disa çështje si p.sh. projekti Caritas Kosova është një projekt shume i mirë, ne e kemi përkrahur edhe pse është goxha i kushtueshëm mirëpo është në interes të qytetareve, por unë mendoj që me një organizim më të mirë ky projekt do të i shërbente qytetareve edhe më mirë. Ekipa që duhet të formohet nga këta punëtorë, se gjithsej janë 48 punëtorë shëndetësor, që mund të formohet një ekip që do të jetë aktive dhe në mënyrë permanente në terenë, në dy ndërrime po ashtu edhe një autoambulancë me pas në dispozicion. Në fillim është punuar në këtë mënyrë por pastaj diçka sikur është ndërprerë, pjesërisht është punuar kështu që ne jemi detyruar psh si mjekë që punojmë aty pastaj përsëri me dal në terrene me marr një autoambulancë e cila është si emergjencë e kështu me radhë. Pra ka vende për një organizim pak me të mirë. Këto dy qendrat e mjekësisë familjare për ndërrimin e dytë që është hapur në Krushe të Madhe dhe ne Ratkoc në rregull është, mirëpo unë mendoj se ka nevojë të bëhet një sensibilizim më i mirë i qytetareve, në mënyrë që pacientet e atyre rrethëve me krye vizita shëndetësore në ato QMF-të sepse prapë kemi dyndjen e madhe të pacieneteve që vinë këtu ne Rahovec. Po ashtu ceket se ne te gjitha shkollat e komunës se Rahovecit janë mbajtur ligjërata për vetëdijesimin e popullatës kundër pickimit të rriqrave mirëpo komuna jonë ka nevojë edhe për ligjërata tjera me qellim të vetëdijesimit dhe kjo ndikon në shëndetësinë publike që ka nevojë ligjërata të mbahen edhe për duhan, alkool, për drogë sidomos me te rinjtë të punohet pak më shumë. Këto shërbimet që janë hapur specialisti i biokimisë klinike për laborator, ultrasonisë është diçka shumë mirë që janë aty mirëpo shërbimet ata mund t'i kryejnë nëse pajisen me pajisje medicinale p.sh. një ultrasoniegraf, një EHO që e kam cekur edhe me herët se është më se e nevojshme që QKMF-ja me i pas, në mënyrë që doktori i Rendgenit me krye punën tamam si duhet, me e shfrytëzuar më tepër edhe për këtë edhe është. Pastaj këtu

thotë që janë subvencionuar OJQ-të që kanë veprimtari sociale me shumë po më intereson këto me veprimtari shëndetësore, sa janë subvencionuar, sa bashkëpunojnë me shëndetësinë që është Handikosi, Ofamkosi, ne kur i kemi mbajtur në dëgjimet publike ata kanë prezantua dhe kanë kërkuar që të keni bashkëpunim më të madhe me shëndetësinë edhe ta kemi përkrahjen më të madhe prej komunës, nuk e di sa është ky bashkëpunim edhe kisha dashur dikush me u përgjigj në këtë drejtim. Rreth vaksinimit është bërë furnizimi me vaksina kundër gripit sezonal, vërejtja ime është sepse sivjet vaksinat kanë ardhur me vonesë pra kanë ardh në fund të nëntorit apo fillim të dhjetorit e që sot kemi vaksina aty që nuk mundemi me i përdorë për arsye se tash veç gripi ka fillua. Nuk e fajësoj drejtorinë komunale të shëndetësisë, fajtor për këtë është Ministria e Shëndetësisë e cila i ka dërgua me vonesë mirëpo unë mendoj se drejtori ka lidhje me Ministrinë dhe duhet t'iu jap një vërejtje atyre që herëve tjera furnizimi të bëhet me kohë pra furnizimi të bëhet në shtator eventualisht në fillim të tetorit. Tek DDD-ja nuk është realizua vitin që shkoj, pyetja ime është pse nuk është realizua sepse mendoj se ky është një projekt i rëndësishëm duke qenë se Rahoveci pra Komuna jonë hynë në grupin e komunave endemike sa i përket rriqrave dhe ne jemi të rrezikuar prej tyre dhe duhet patjetër DDD-ja me u krye brenda çdo viti në komunën tonë. Për repartin e Hemodializes ju e dhatë sqarimin, unë plotësisht e kam të qartë këtë çështje pra ashtu është siç keni thanë ju mirëpo nuk pashë asnjë fjalë rreth konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të raportit. Ne jemi Kujdesi Parësor dhe Kujdesi i Mjekësisë Familjare duhet ta gjejë veten për çdo vit dhe duhet të bëhet planifikimi i specialisteve për Mjekësi Familjare. Drejtoria komunale duhet me bo plan që çdo vite me dërgua dikënd në specializim pastaj punojmë në zoonime që pacientët të orientohen në rrethinën e vet, nëse ka kërkuar Krusha e Madhe me pas ndërrimin e dytë në vendin e tyre atëherë duhet me shkua edhe me u vizitua aty e jo me ardhë në Rahovec. Pak me herët e përmendet SISH-in duhet të punohet pak me tepër por sa me shpejtë SISH-i duhet të aktivizohet do të thotë sistemi i informimit shëndetësorë forma elektronike. Po ashtu prapë po e përmendi komisionin mjekësorë për patentë shofer, certifikata për patentë shofer ka mundësi me u bo edhe duhet të punohet në këtë drejtim pasi nuk është bërë, ka nevojë për furnizim me te mirë me pajisje medicinale për mjekë, më reagenca për laboratorë, kemi pasur raste që tash në dy javët e fundit të vitit të kaluar edhe dy javët e para të këtij muaji nuk ka pasur fare reagenca dhe analiza nuk janë bërë fare ne laboratorë, kështu që laboratori nuk e ka krye punën e vet, punëtorët kanë nejt aty kanë marr rroga. E kam cekur edhe me herët që pacientë me probleme të shëndetit mendor, kam kërkuar që të bëhet furnizimi i tyre me ilaçe sepse këta janë një kategori e veçantë e qytetareve. Gjatë vitit 2019 nuk janë siguruar barnat për këtë kategori, ata janë të detyruar në mënyrë të vazhdueshme me marr ilaçe dhe unë kisha kërkuar që për këtë vite të zgjidhet ky problem. Ne drejtorinë për Kulturë, ka premtuar një teatër amator të qytetit, nuk e di a është punuar diçka në këtë drejtim sepse Rahoveci ka nevojë edhe si komunë edhe si qytet edhe kemi folur gjithashtu për formimin e një komisioni i cili do të bën evidentimin e të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike, këtu nuk ka shënime që është bërë diçka e tillë, drejtoresha na ka prezantuar vitin që shkoj një liste me projekte, lista e vjetër është dhe aty ka pasur projekte që tani nuk janë edhe shume të tjera që nuk janë evidentuara. Unë kam kërkuar që të evidentohen ato projekte të gjitha ne nivele të Komunës, nuk e di se çka ka bërë drejtoria në këtë drejtim. Faleminderit

Kryetari – Zona ekonomike është lajmë i mirë që është licencuar, pardje është nënshkruar nga Ministri Shala licencimi i zonës ekonomike që është një vepër e nisur kaheerë pra një përpjekje e të gjithëve, shyqyr që u finalizua se kemi pasur vështirësi të mëdha deri në finalizim, pasi kishte shume dokumentacione, vendime, projekte dhe krejt jemi bërë gati, tash kemi fillua me planifikua edhe mjete financiare për me dëshmuar se edhe ne jemi të interesuar me funksionalizue dhe me aftësua edhe me ardhë bizneset e interesuara sipas procedurave që fitojnë të drejtën me ardh me u vendosë aty. Në këtë vite ne e mbyllim kontratën për rrethimin e zonës ndërkaq neve për licencim na u është kërkuar plani financiar se sa kushton zona, çka bën komuna, çka do t bën KIES-a agjencioni pra Ministria dhe donatoret potencial që janë të jashtëm që zakonisht i financojnë

parqet industriale. Plani jonë financiar për krejt vlera e zonës kushton 2 780 000 euro ndërsa ne marrim pjesë me 150 000 euro si Komunë. Ne po shpresojmë që veçse jemi dakordua edhe me Ministrinë atje ,e bëjmë një kërkesë te Kiesa që është agjencion i posaçëm për këtë punë, po shpresojmë që Kuvendi i ri Republikës së Kosovës, Komisioni për Buxhete që tash nuk mundet me u futë ne projektbuxhetin edhe pse nuk është aprovuar. Komisioni për buxhete ka me aprovua kërkesën e Rahovecit për parkun industrial me ndaje një vlerë të mjeteve financiare që ndihmon në funksionalizimin, pasi ne tash fokusin me të madhe e kemi pasi veç i kemi tejkalua këto aspekte ligjore. Presim me u lajmërua bizneset, sivjet do të ketë prapë aktivitete tjera edhe mos me na ndihmua kush, ne si komunë diçka do të bëjmë që ndoshta edhe me u vendos bizneset e para sipas kërkesave që mund ti kenë edhe natyrisht edhe sipas procedurave që do të zhvillohen këtu. Pra lajmi për licencimin e zonës është lajm i mirë edhe besoj që tash se paku mundem me thanë që legalisht i kemi rreth 35 hektarë edhe pse infrastruktura krejt nuk është rregulluar por tash e kemi të drejtën me hie edhe ne veprime tjera investive bashke me Ministrinë e tregtisë edhe me donatoret. DDD-ja(Deratizim,Dezisektim,Dezinfektim) ka dështuar për vitin 2019 për shkak se lënda ka kalua në organin shqyrtues të prokurimit publik dhe ka ngelur atje pra nuk është zhvilluar projekti, procedurat te ne janë krye, dikush u ankua pa shkua atje dhe tash po presim sivjet me implementue d.m.th. OSHP-ja kur e merr ata e dinë me mirë punën e vet sepse na asnjë lloj fuqie nuk e kemi sepse gjykata e tenderëve ne republikën e Kosovës sipas ligjit, po besoj që ata që janë me te informuar e dinë çka është d.m.th. projekti ka dështuar pra ska ndodhur prandaj edhe nuk e kemi përmend. Sivjet duhet me ndodh sepse ne kemi obligim me bo atë punë. OJQ-të shëndetësore, nuk ka OJQ që funksionon ne Rahovec edhe që është e funksionalizuar edhe që i ka letrat e që ka aplikuar e që nuk i kemi ndihmuar edhe shëndetësore edhe sociale. Vetëm një OJQ-je shëndetësore nuk i kemi ndihmuar, që është Ofakos për shkak se ka pasur probleme me dokumente, te gjithëve te tjera që kanë aplikuar me shume apo me pak dhe tash sa funksionon marrëdhënia me QKMF-në ajo është e vërtete që pajtohem plotësisht me Fehmi Cenën që duhet me u adresua se ky shqetësim sepse duhet me pas një marrëdhënie me te mirë pra një raporte partneriteti dhe te qëndrueshëm sepse për qatë punë i marrin ata qeto mjete edhe i zbatojnë do programe që gjithsesi ndikon në rritjen e kualitetit të shërbimeve të qendrës kryesore te mjekësisë familjare .OJQ-te sociale i kemi ndihmuar të gjitha, që ka disa edhe e ne ju kemi ndihmuar. Caritas Kosova pajtohem plotësisht që çdo kush kur e ka startin ka energji me shume që edhe Caritasi me gjasë ka marr punë në gjithë Kosovën tash dhe na duhet me qenë me kërkues me bo ata planifikim me te mirë e veprim ma të sinkronizuar edhe kualiteti i kësaj veprimtarie që e banë Caritas Kosova ne harmoni me komunën me QKMF-në me u kon edhe i nivelit me te lartë. Edhe unë sivjet ka me kërkua me rritë intensitetin e veprimeve të tyre edhe me qenë me te organizuar veprimet e tyre. Pra mu adresua nga kjo pikëpamje koncepti i mjekësisë familjare që unë pajtohem që veç mjekësi familjare kemi këtu edhe po përpiqemi me zbatua ndoshta pa e shkrua me zbatua atë çka është e mundshme në kapacitetet tona konceptin e mjekësisë familjare bile me i avancue nga ndërrimet e dyta në ndërrime të treta në dy qendrat të mëdha në dy qendrat e mjekësisë familjare në Ratkoc dhe ne Krushë të Madhe ndërsa QMF-të në Drenoc e Opterushë unë vet e kam potencuar publikisht por ne ende kemi nevojë për personel edhe doktor Fehmia e din se kemi nevojë për shtimin e personelit mjekësor, shtimin e stomatologeve po ashtu edhe të infermiereve në mënyre që me funksionue ndërrimet e treta në ato dy qendrat që janë ndërrimet e dyta ndërsa me u hapë ndërrimet e dyta edhe në Opterush,Drenoc,Çifllak dhe Fortesë. Furnizimet me pajisje, që është e vërtet se një pjesë e obligimeve i kryen komuna, me pajisje me reagenca por pjesën me te madhe zakonisht e kryen Ministria dhe kjo traditë mendoj që nëse ka buxhete komuna ndoshta duhet me shtua kapacitetin e veprimeve, me shume furnizime për qendrën kryesore të mjekësisë familjare. Te Teatri amator i qytetit, në teatër ligjërisht nuk kemi mundur me bo, unë jam zotua se duhet me bo, ka disa procedura ligjore që duhet me i përfill, duhet me pas vendim të kuvendit të Komunës, duhet me ua adresua kjo çështje në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

duhet me u ndaje buxhete prej Komunës se Rahovecit, duhet me u buxhetua për me tu lejua me bo shtimin e numrit të punëtorëve për teatër d.m.th. ne kemi bërë veprime që i ngjajnë tetarit mirëpo juridikisht nuk kemi mbërri me themelua ende teatër amator të qytetit. Përpjekja jonë për me bo teatrin ka me vazhdua edhe pse disa shfaqje teatrale kanë ndodhur dhe ne me SHL-Kosova dhe me disa artistë të Rahovecit jemi munduar me bo diçka pasi janë disa shfaqje por për teatër ka disa procedura që duhet të kryhen për me bo teatër profesional ose teatër të qytetit profesional apo amatorë. Pra ka shumë procedura që duhet të rregullohen, pasi nuk jemi Prizreni, Gjakova apo Gjiçani që kanë një traditë të hershme por jemi Rahoveci që mirë është me pasë edhe duhet me luftua me bo. Edhe të ligjëratat antidrogë, të ligjëratat për edukim në përgjithësi ka disa programe që aplikohen në shkollë, në qendrën kryesore të mjekësisë familjare, unë e kam pae njëherë Basri Lenjanin që ka mbajtur ligjëratë këtu në Hotel Park pra ato veprime edhe ju si QKMF duhet me i bo si profesionistë edhe ne duhet me ju ndihmua me ndonjë aktivitet edhe me i ftua edhe të tjerët të cilët munden me kontribuuua në këtë drejtim, neper shkollë aplikohen programe me Policinë në komunitet që janë programe antidrogë, kundër dukurive negative që zakonisht Policia i organizojnë me OJQ-të që vazhdojnë të bëjnë edhe sot, natyrisht unë pajtohem se duhet të rritet intensiteti i ligjërimit në funksion të edukimit,ndërgjegjësimit,sqarimit njerëzve për kërcënimet që munden me ju ardhë fëmijëve tanë,nxënësve,shkollave tona thjesht qytetareve në përgjithësi. Ne mundem me fol edhe për plotë tema tjera, raporti jam i vetëdijshëm se ka edhe të metat e veta që është i zgjeruar, pse është ndarë nëpër etapa tre mujore për shkak mu kon ma konkrete dhe jo për diçka me shumë që është e vërtet se ka marr me shume faqe sepse ska sektor që nuk është përfshije dhe po ashtu është e vërtetë që kemi prezent edhe Azizin këtu pasi ja 3 apo 4 faqe ja kam hequr prej raportit, secili e ka tash raportin e zgjeruar pra secili organ dhe secila drejtori, pra ne kemi hequr shumë për me bo pak me të thjesht edhe me te shkurtë raportin. Ne do të ju raportojmë edhe në periudhën gjashtë mujore edhe raporti financiar do të raportohet çdo 3 muaj sipas ligjit, pasqyrat financiare po ashtu ,jemi transparent për këtë edhe besoj që komuna ma transparente do të jemi në republikën e Kosovës do të shpallemi edhe për shkak të raportimit, nuk po dua me ja bo qefin vetës por kur n dëgjojmë lajme të mira duhet të jemi të kënaqur të gjithë.

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar për pikën e shtatë, kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Planit të punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020. Edhe për këtë pikë raporti i Kryetarit është i njëjtë atëherë kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private.

Afrimi Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar,nënkryetar,drejtorë dhe ju anëtare të kuvendit. Para jush, keni vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronë private në zonë kadastrale në Xërxë, bëhet fjalë për parcelën me numër 00558 që është pronë shtetërore me sipërfaqe të përgjithshme mbi 10 ari, prej kësaj parcele fillimisht kërkojë ndjesë për një gabim teknik në propozim vendim po ashtu kërkoj edhe prej sekretariatit të Komunës që këtë gabim teknik pra lëshim ta përmisojë pas vendimit të juaj në qoftë se ju vendosni për me vazhdua këtë dhe para se me dërgua ne Ministrinë e MAPL-së për ligjshmëri, bëhet fjalë për 163m2 dhe jo për 191m2,pra kërkoj edhe prej sekretariatit që pas miratimit të kësaj pike të përmirësohet ky gabim para se te dërgohet për ligjshmëri në MAPL pra bëhet fjalë për 163m2, që i merret pjesës publike shtetërore dhe i jepet në bashkëpronësi Bashkim-Lulzim dhe Shpejtim Sinani ndërsa prej parcelës private e cila është në bashkëpronësi të Bashkim Sinanit dhe Shpend Sinanit të merret sipërfaqja në të njëjtën sipërfaqe prej pjesës së përgjithshme prej 163m2.Qellimi i këtij këmbimi është hapja e rrugës publike e cila për momentin faktikisht atje në terrene është e kalueshme. Ftoje anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit të aprovojnë vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronë private. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, edhe unë jam për atë që sekretaria normal që para se me bo përmirësimin me kërkesën e drejtorit. Faleminderit shume, e qesim në votim pikën e nëntë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e Sheshit qendrorë të qytetit në Rahovec.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, behet fjalë për tri parcela që gjenden në zonën kadastrale në Rahovec. Sa i përket projektit për ndërtimin e sheshit qendror, ky projekt në të ardhmen ka me përfshije me shumë se tri parcela që janë mbi 8 parcela. Qëllimi i këtij vendimi për interes të përgjithshëm sepse pikërisht në këto tri parcela janë tri ish ndërmarrje publike e cila njëra ka qenë Podrima pra zyrat e Podrimës që është hoteli Plaza. Këto objekte, ne si institucion i kemi në fletë poseduese pasi këto janë pronat tona pra të komunës së Rahovecit mirëpo këto objekte pra ish ndërmarrje i kanë në listat e veta si asete, ata pretendojnë në objekte dhe jo në pronë dhe përderisa pretendimi i tyre është edhe në gjykatë ne nuk kemi mundur me prua këtë pikë para vitit 2019 sepse lënda është prej vitit 2014 në gjykatë për arsye se ligji për këmbim dhe për shpronësim ka ndryshua në vitin e kaluar dhe i ka jap disa kompetenca shtesë pra të drejta shtesë kryetarëve të komunave dhe ne i kemi marrë hiq me lagë se para dy ditëve edhe një njoftim prej AKK-së (Agjencioni të asociacionit të komunave të Kosovës) ku i kanë kërkuar kryetarëve të komunave ato prona ku janë në interesin e juaj që sipas ligjit fillimisht duhet me i shpallë me interes të përgjithshëm pastaj në qoftëse ne nuk e dimë se qysh donë me vendos gjykata me këto prona dhe nëse ata marrin vendim në favore të AKP-së atëherë AKP-ja i qet në likuidim mirëpo ne po dojmë që me qenë të gatshëm me planin B në tavolinë, ne qoftë se ata i fitojnë në gjykatë, në hyjmë edhe i blejmë me 20% këto objekte që mos me na i ble të tjerët edhe me ndertue shtëpi private e me jetua ne ato shtëpi, e na me i shfrytëzua me interes të përgjithshëm pra ky është qëllimi, për ndryshe parcela që ka me përfshije ky projekte janë mbi 8 parcela. Ftoje kuvendarët që pas shqyrtimit të aprovojnë propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm. Faleminderit

Fehmi Hoxha – Faleminderit shume, para se me u kyqë në diskutim vetëm kam një pyetje apo është bërë ndonjë gabim teknik dhe po dua një sqarim. Këtu ne materialin që kemi marrë ne në email pos këtyre tri parcelave që i tha edhe drejtori edhe që e falënderoj, është edhe një numër tjetër 70482793 në material, gjë që nuk përfshihet fare në vendim dhe pyetja tjetër është parcela 71510057 që është e para në propozim vendim 013150 thuhet vendi i quajtur Bavan- Ravan, si mundet me u kon Ravan kur këto të dyja janë në qytete do të thotë 01318/1 qytetë 01318/2 qytetë dhe 01315 Bavan-Ravan, a mos është ndonjë gabim atje që është bërë tek gjeodezia dhe kadastra si emërtim po e them kështu që para marrjes së vendimit këto duhet të jenë shumë precize, po ashtu e kemi dokument këndeje që kemi marrë edhe atë tjetrën që thash në fund 793 që është gabim po besoj. A ke mundësi drejtor aty e ke ortofoton me na tregua se cilat janë ato parcela këto tria edhe ku oshtë kjo 793.

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për tri parcela, kërkoj ndjesë pasi unë në dokumente e kam në rregull, po i përsërisë numrat që të regjistrohet në sekretariat, bëhet fjalë për parcelën 013150, bëhet fjalë për parcelën 01318/1 edhe bëhet fjalë për parcelën 01318/2 pra për këto 3 parcela ndërsa sa i përket pyetjes bëhet fjalë pikërisht për parcelën ku janë kon ish zyrat e ndërmarrjes Podrima ku tash operojnë një biznes privat i quajtur Hardhia pra bëhet fjalë për atë objekte pastaj bëhet fjalë për oborrin e Hotel Plazes që janë të ndara këto parcela d.m.th. ku është terrasa e hotelit edhe bëhet fjalë për objektin ku është hotel Plaza pra këto janë 3 parcela, ejo për parkingun e veturave edhe ajo është pjesë e komunës pasi janë të gjitha afër njëra tjetrës ndërsa sa i përket sipas librave kadastral kjo parcelë në atë kohë është quajtur hiq më larg para viteve të 50-ta kur është ndërtuar Podrima pasi kjo Ravan është thënje e ish pushtetit pasi ajo është populluar masandëj edhe qishtut ka mbetur edhe ne nuk guxojmë me ndryshua pasi në libra kadastral i thonë ashtu edhe pse këtyre dy parcelave tjera i thonë qytete, në nuk guxojmë me i përmisue edhe pse janë në gjuhën serbe, në vetëm i bartim

qysh janë ashtu në libra kadastralë edhe në certifikatën e pronës pra bëhet fjalë për këto 3 parcela.

Faleminderit

Mirjeta Krasniqi – I nderuari kryesues, siç e kuptova unë drejtorin tek kjo pikë bëhet fjalë për tokat parcelat janë fletë poseduese në kuvendin komunal mirëpo problemi qenka tek objektet që kanë qenë ndërmarrje shtetërore, a është ashtu siç e kuptova unë, Hoteli, terasa dhe objekti tjetër. AKP-ja ka mundësi pra të drejtë ligjore pra ato objekte që kanë qenë ndërmarrje shtetërore me i privatizue pra me i likuidua, pra është problemi veç me i ruajte ato objekte apo AKP-ja mundet me i marr edhe parcelën afër hotelit pra që mundeni me i sqarua këto mirë. Faleminderit

Fehmi Cena – Unë kërkoj sqarime nga drejtori në lidhje me këto dy parcela që janë në shfrytëzim, tash çka do të ndodhë me kontratën që ka “Moderne” në shfrytëzim deri në vitin 2029, a cenohet kjo kontratë, ku është interesi i palës pasi ky kuvend pra kjo komunë i ka dhënë në shfrytëzim. Ne tash nëse e përkrahim interesin e përgjithshëm, çka do të ndodhë me kontratën, a do të vazhdon ajo më tutje, cili është qëllimi më tutje se ne jemi të interesuar tek e fundit ajo kontratë nëse mundet me qëndrua ndërkaq me shpallë interes të përgjithshëm për me ruajte pronën komunale. Faleminderit

Rexhep Oruqi – Faleminderit kryesues, ne materialin e kemi përpara, i kemi 3 parcela që duhet me u përfshije në bazë të propozim vendimit dhe sipas gjitha gjasave të 3 parcelat i takojnë hotel Park Plazes gjegjësisht ndërmarrjes Moderne. Duhet me pas edhe për bazë përveç interesit publikë pak a shumë edhe interesin bizneseve private sepse aty janë duke marrë rrogë mbi 20 punëtorë por pikërisht kontratën e ka nënshkruar po ky kryetar z. Smajl Latifi me këtë kompani. Është krejt diçka tjetër pasi aty janë bërë shumë investime, nëse përfshin që ky sheshi i ri i qytetit krejt atë kompleksë ndoshta edhe me shumë siç tha drejtori i gjeodezisë që është faza e dytë që do të shkoj tutje aty do të bëhet një tollovi e madhe edhe të drejtën me ju thanë a ja vlen që pastaj me prishë hotelin që është një objekte relativisht i ri i pajisur mirë edhe qatë hotel e kemi ne në qytete edhe nëse është kjo që thotë kryetari, në po e shpallim interesin e përgjithshëm pikërisht që mos me lejua AKP-në me ndërhyjë. Unë sa e di kontesti është mes Komunës dhe AKP-së ajo pjesa e Podrimës ndërsa këtë pjesën këndeje ka hoteli nuk e di që ka pretendua AKP-ja sepse kjo është prone e komunës i gjithi dhe ata nuk mund të ndërhyjnë aty edhe nëse veç qitet në votim e që sigurisht ka me dal, qashtu blanko nuk e votojë, nëse nuk e lejmë një klauzolë që mos me dëmtua shfrytëzuesin aktual të objektit, unë personalisht nuk e votojë pasi në vendim thuhet se kontrata mbetet në fuqi deri përfundim, për ndryshe nuk jam për me dëmtua pasi ne duhet me ndihmua kapak edhe sektorët private pasi ata po na mbajnë, e këtu pikërisht po del se të 3 këto prona bilum edhe katër po del këtu në kontratë pasi ky personi që e ka marrë edhe është 1318 një parcel. 1318/2, 1315 edhe 1816 pra janë 4 parcela i ka kompania Moderne kurse ne i kemi 3 parcela të përfshira pra nëse nuk e përfshin klauzolën që të mos dëmtohet shfrytëzuesi aktualë pasi edhe ne gjykatë do të fitojë nëse vjen puna deri tek tek kontesti me komunën sepse ka investime edhe i ka faturat pra i ka të gjitha gjërat pasi tash me fjalë nuk mundemi me besua asgjë pasi shume here kemi pasur fjalë edhe nuk kanë shkuar ashtu gjërat tash qysh me i besua unë kryetarit se kjo ka me shkua kështu si është. Faleminderit

Kryetari – Faleminderit shume, ne po dojmë me mbrojte pronën tonë, po shprehem në gjuhen ushtarake nga ndonjë invazion i mundshëm i ndonjë institucioni tjetër ose agjencioni tjetër dhe asgjë me shumë. Në qoftë se hyjmë më thellë, unë ju siguroj edhe informacione të cilat nuk janë fjalë pra mundem me ju thanë se komuna e Rahovecit ju e dini se ka kontratë për shfrytëzim dhe mos e harroni kurrë as unë e as ju që ai është asetë i komunës se Rahovecit, e me dashtë komuna e Rahovecit e kuptohet që për me dashtë komuna e Rahovecit bashke me kuvendin e komunës kur e rrënon edhe hotelin edhe cilindo objekte tjetër pasi ajo është pronë e komunës se Rahovecit dhe unë e di vet se ma shumë me këtë temë se jam marr shume edhe ne mandatin e parë për punën e hotelit. Unë mundem me ju thanë sepse jemi drejtpërdrejt ne radio aktiv se hoteli edhe ata që janë aty në hotel nuk e kanë zbatua planin investiv por kjo nuk do të thotë që ne po dojmë me ndërpre kontratën,

planin investiv qysh e kanë paraparë planin e biznesit nuk e kanë zbatuar edhe me thanë të drejtën ne kemi shumë vërejtje në këtë punë por këtë pikë te rendit të ditës unë kam me qitë në kuvendë edhe kam me formua një komision edhe kemi me shkua se a e ka zbatua planin investiv në bazë të planit të biznesit. Tash unë po ju ftojë juve me aprovua një vendim që me mbrojte pronën e komunës, qe me u konsiderua që është pronë e komunës dhe ne e dimë që është por me u shpallë interes i përgjithshëm për nevoja të veçanta të komunës për shkak se ka pretendime në pronë se AKP-ja ka qitë në privatizim edhe pronat e hotelit jo hotelin por edhe pronat e hotelit pra parkingun, terasa pra tokën dhe kush nuk i beson kësaj hajdeni në zyrën e kryetarit edhe ju jap këto gjëra pasi nuk mundem të i sjellë të gjitha në kuvendë. Baca Rexhë, fjala është me mbrojte pronën dhe kurrkush nuk po donë që me rrënuja hotelin pra ndërtesës pasi është një ndërtesë e mirë dhe ne jemi të vetëdijshëm se biznesi duhet me u mbrojte dhe me u përkrah pavarësisht që jemi të pakënaqur për moszbatim të planit të biznesit, ato do të i shini në kuvend kur komisioni ju sjellë raportin e plotë për të gjitha detajet e zbatimit apo moszbatimit . Nuk jam i interesuar me revokua kontrata edhe pse ky kuvendë kur donë mundet me revokua dhe cilido operatorë kuptohet me arsye por nuk është çështja pasi nuk është ajo temë fare në këtë rast. Problemi ne po dojmë me mbrojte pronën duke e shpallur me vendim të kuvendit yonë me interes të veqantë. Unë po ta dija qysh ka me u dukë ky sheshi qendrorë atëherë u deshtë me u kon edhe shefi që kam nënshkruar memorandum nga UN-Habitati pasi edhe ajo se din se kane me u bo dëgjimet publike dhe plotë gjëra tjera edhe në fund konkurse ndërkombëtar i projektimit pra e keni parasysh se çka po ju them. Unë po kërkoj me aprovua vendimin për me mbrojte pronën tonë, pasurinë tonë, tokën tonë edhe çdo shpjegim që e jep edhe drejtori pasi unë mundem me than me shkua me marr padinë pasi e kam në zyre, çertikaten e plot dokumente tjera edhe me jetë deri vonë ne këtu duke i shqyrtua këto dokumente. Detyra jonë sot para vetit parashtrohet kjo detyre se a do të mbrojmë me vendim të kuvendit komunal tokën tonë. Faleminderit

Fehmi Hoxha – Faleminderit shume kryesues, e kjo është atë çfarë e tha kryetari edhe gjithë e kanë shumë kjo mirëpo prapë po kthehem unë me herët ju thash që është dashtë me marr një vendim për iniciimin e procedurave pasi bazohem se këto 3 parcelat në certifikate shkruan shfrytëzues Moderne pra në çertikatë është emri i Modernes pra në bazë të vendimit që ka sjellë ky kuvendë edhe kontratën që ka lidhë kryetari i autorizuar prej kuvendit pasi kishte të drejtë sepse ishte i autorizuar prej kuvendit. Unë propozoj që të marrim vendim këtu për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik, të triat këto parcela sipas propozimit të drejtorit gjeodezisë dhe Kadastrës, ku me vonë do të inkorporohet edhe stadiumi edhe parcela tjera që janë për rreth mirëpo të shpallet interesi i përgjithshëm ku parcela e hotel Park Plazes aktualisht Moderne që po e shfrytëzon pjese përbërëse e sheshit qendror të qytetit, ku të inkorporohet në kuadër të konceptit ideor projekti kryesor në të ardhmen që do të bëhet që Hoteli të jetë pjesë përbërëse e sheshit qendror të qytetit. Pra ne vendim të inkorporohet edhe kjo që hoteli të jetë pjesë përbërëse e sheshit edhe ne kuadër të konceptimit të projektit ideor dhe projektit kryesor. Faleminderit

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, nuk ka të bëj me sot që po diskutojmë me shesh, ne nuk po bëjmë projektin për shesh, krejt puna e këtij vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm me i ndihmua avokatit të komunës që me pasur një provë për me argumentua barrën e provës në gjykatë në qoftë se gjykata vendos ndryshe e ne sipas ligjit për këmbim dhe shpronësim po dojmë me pasur të gatshëm në qoftë se gjykata vendos në favor të AKP-së po paragjykoj, në si komunë dojmë me hije me ble me 20% dhe ajo i takon puntorëve, vlerësohet objekti, po shpresoj që nuk vendoset kështu ne jemi në këtë fazë, sa i përket kontratës veç një shembull Biznesi i Hotel Park Plazes e ka me qera edhe parcelën ku është autoparking, e që nuk është sot me këto 3 parcela por ajo parcelë para disa vite u shpallë zone me interes të përgjithshëm dhe ajo është zonë me interes të përgjithshëm dhe ai po e shfrytëzon dhe nuk po bëjmë fjalë sot për punën e biznesit pasi ku me marr me i bo edhe ja dy hotele aty, ne po dojmë veç me i pas gati që në gjykatë me pas provën tonë edhe

me i pas gati për me hie me i ble që mos me na i marr dikush tjetër në çastin kur hynë në likuidim.

Faleminderit

Fehmi Hoxha – Vendimi që sot merret shpallja me interes të përgjithshëm publik pronat për ndërtimin e sheshit qendror të qytetit në Rahovec, nuk kanë me than që ne s'po dojmë me ndërtua sheshin, unë po e them që po dojmë me ndërtua sheshin mirëpo në kuadër të këtij vendimi ne po dojmë me ndërtua sheshe mirëpo edhe po dojmë me mbrojte edhe pronën tonë që është e atakuar prej agjencioneve të ndryshme shtetërore. Pra duhet me prua këtë vendim që e thashë që hoteli të jetë pjesë përbërëse e sheshit të ri që do të ndërtohet në Rahovec, këto parcelat janë pjesë përbërëse të sheshit, a kështu me shpallë interes të përgjithshme ku kishim pas edhe me madhe edhe si kuvendë edhe si kryetar i komunës, drejtori është deshtë me parape kompletë ato 8 parcela edhe me inkorporua komplet këto janë vetëm në mënyre parcale atëherë mendimi është shume me i fuqishëm se ky sepse tani këtu futemi në lajthitje, përgatitni komplet 8 parcelat edhe po votojmë sheshin edhe ne kuadër të sheshit të jetë pjesë përbërëse edhe hoteli se kurrkush nuk po donë me rrezua hotelin sepse ka shumë investime prandaj ky vendim ose një klauzole apo një pikë të jetë hoteli ekzistues dhe do të jetë pjesë përbërëse e sheshit të ri që do të ndërtohet. Faleminderit

Kryetari – Ne për me marr një vendim të kuvendit komunal për me mbrojte prona duhet me ja vënë emrin se pse po shpallë zonë me interes të përgjithshëm dhe këto i specifikon ligji. Pra përpara ky kuvend i komunës në përbërjet e kaluara ka vendosur për 53 hektarë edhe nuk ja kanë vënë emrin edhe krejt i kanë privatizua. Ne duhet të ja vëmë emrin dhe ne këtë po e quajmë „Ndërtimi i sheshit qendrorë,,po e marr si ilustrim, Hoteli mundet me u rinovua, permisue por me u rrënuar nuk kanë sepse ata që marrin pjesë në dëgjime publike me siguri nuk do të lejojnë që mos të preket hoteli pra mundet me u rregullua ky hotele por me u prishë nuk ka nevojë sepse është objekt i ri. Pra konkursi i projektimit nuk shpallet pa i dëgjua disa

inxhinierë,qytetarë,shfrytëzuesi që është aty ,punëtorët që marrin aty d.m.th. krejt kanë me u bo dhe aty dhe aty tash ai që edhe udhëheq këtë procese që hoteli te mos preket mirëpo dukesh mundet me than që duhet me rrezua ky hotel. Tash prapë ai konkursi para me u bo që është në bashkëpunim me komunën, se pari ne i këqyrim kriteret dhe pastaj shpallet, pasi është konkurse ndërkombëtar. Në në vendim nuk mundemi ta specifikojmë se nuk shkruhet në vendim se ne nuk e dimë njëherë se çka ka me ndodhë por vetëm vendimi po na duhet sepse ja kemi vënë emrin për shkak të ligjit që na thotë se duhet patjetër me ja vënë emrin se nuk mund të mbroresh askund sepse nuk guxon me u kon materiali i thatë p.sh. po me duhen 50 hektar pa e ditur destinimin e tyre, pasi na i kanë marrë pronat Fehmi Hoxha dhe ju e dini mirë se na i kanë marrë krejt gati. Do ditë me vinë njoftime se dolën këto asete apo këto prona per shkak se nuk ju kemi vënë emrat dhe sikur të ja kishim vënë emrin edhe Oltit atje po ju siguroj që kurrë nuk ish privatizua sepse kur ja kemi vënë emrin ishte tepër vonë sepse skemi pasur projekt konkret edhe ajo është privatizua d.m.th. ky proces ka fillua me herët 4-5 cikle të privatizimit deri sa dikush e ka marr, pra unë jam për me ja vënë emrin, tani na ka ardh puna me UN-Habitati me bo një marrëveshje edhe ja kemi vënë emrin sheshi qendrorë e ky sheshi qendrorë ndoshta me së paku ka me qenë sheshe kushtimisht në atë kuptimin, normalisht objektet e mira nuk preken, ato munden me u pasurua por nuk preken, nuk mund të cenohet kontrata me operatorin që e kemi pra me shfrytëzuesin pa ju sjellë juve një informacion se pse ja kemi ndërpre dikujt kontratën, e për këtë vendos kuvendi i komunës, për shkëputje të kontratës nuk vendos gjykata sepse ne jemi marrë vesh se kur e kemi nënshkrua kontratën, së në qoftes nuk respektohet plani i biznesit ka edhe shkëputje të njëanshme të kontratës por në fund në qoftëse ka konteste vendos gjykata. Nuk është çështja me i marr dikujt që është duke punuar diçka, çështja është me i dhanë komunës se Rahovecit një adutë që po i mungon pra është vendimi i kuvendit të komunës për me mbrojte se Parkingun që është aty i hotel Parkit qe e kemi shpalle ska kush që hin aty sepse kuvendi i komunës ka vendosur pronën e vet me mbrojte me ligje edhe është rregull, e tash ne po kërkojmë edhe këto tjerat me i

mbrojte për shkak se ka pretendime pra pretendimet që i kanë bo ata të tjerët dhe ne dojmë me i mbrojte me vendim të kuvendit kaq po kërkojmë ne tash. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit kryetar për sqarimet, atëherë besoj që kryetari i dha të gjitha sqarimet që po kërkohej vetëm pjesa mbrojtëse e pronës komunale që e kemi. Te nderuar kuvendarë, e qesim në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i raportit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2019.

Nazife Hundozi – I nderuar kryesues, raporti i kryetarit të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Në periudhën kohore nga Janari deri në Dhjetor të vitit 2019 Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe ka mbajtur 15 takime nga të cilat shumica janë kryesuar nga kryetari i këshillit të fshatit Hoçë e Madhe nga z.Bojan Pavloviç. Në fillim të vitit është bërë strategjia e punës të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin aktual. Kanë filluar aktivitet në përpilimin e planit konservativ mbrojtje e veçantë. Organizimi i takimeve nga ana e këshillit të fshatit Hoxhë e Madhe me anëtarët ,me përfaqësuesit komunal, takimet janë mbajtur në hapësirat e drejtorisë për urbanizëm. Vizitat e anëtareve të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe në Ministrinë e linjave. Gjate qershorit në Prizren është mbajtur takimi i përbashkët të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe këshillit të qytetit në Prizren në hapësirat e OSBE-së. Në takim kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë se Kulturës, Ministrisë së Planifikimit hapësinor, anëtarët e organizatave joqeveritare. Në shtator në organizimin e OSBE-së anëtarët e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe kanë marrë pjesë në seminarin dy ditorë në Tivatë dhe Kotorrë të Malit të zi. Tema e seminarit ishte shkëmbimi i praktikave me te mira në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në panelin e diskutimit përveç anëtareve të Këshillit kanë marr pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Ministrisë për Ambiente dhe Planifikim hapësinor, përfaqësues të Këshillit të qendrës historike të Prizrenit, përfaqësues të drejtorisë për Urbanizëm të komunës se Rahovecit dhe Prizrenit. Shqyrtimi i kërkesës se dërguar nga drejtoria për punë inspektuese me numër 1188/2019,Drejtoria për Punë inspektuese ka kërkuar nga Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe të kërkojë nga pronaret e parcelave të cilët kanë lejuar iniciimin e procedurave të ndërtimit, për ndërtimin e objekteve të karakterit të banimit dhe disa objekteve përcjellëse për nevojat e kishës.

Kryesuesi - Faleminderit zj. Nazife. Ne të gjithë e kemi përpara edhe raportin të cilën e kemi pasur materialin. Faleminderit për prezantimin. Nëse dikush ka diçka nga kuvendarët atëherë mund ta thuani. Faleminderit shume, a ka dikush diçka, nëse jo, kuvendare të nderuar, ju falënderoj shumë për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës. Faleminderit shume të gjithëve!

01 Nr.44/2020
Rahovec, 28.02.2020

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

K R Y E S U E S I

Afrim Dina

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs	
	Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police Drejtoria Rajonale e Policisë/ Regionalna Policijska Direkcija / Regional Police Directorate Regjioni Gjakovë Stacioni Policor Rahovec	

MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

PËR: Z Smajl LATIFI
ZA: Kryetar i Komunës - Rahovec
TO:

Data:
Datum: 08/01/2020
Date:

PËRMES: Drejtpërdrejt
PREKO:
THROUGH:

Nr. i Referencës:
Br. Referencije: 04/1-08R- /2020
Reference No:

PREJ: Kapiten Fazli MORINA
OD: Komandant i Stacionit Policor – Gjakovë
FROM: DRP - Gjakovë

LËNDA: Raport vjetor i gjendjes së sigurisë 2019
PREDMET: (Përmbledhje)
SUBJECT:

I nderuar Kryetar,

Situata e sigurisë në Komunën e Rahovecit gjatë vitit 2019 ka qenë e qetë dhe stabile përkundër rasteve që janë raportuar gjatë vitit.

Raport përmbledhës i punës vjetore të Stacionit Policor Rahovec për vitin 2019 dhe objektivat për vitin 2020

1. Rastet e iniciuara pranë Stacionit Policor në Rahovec gjatë vitit 2019 duke përfshirë veprat penale dhe incidentet:

Gjatë vitit 2018 në Stacionin Policor Rahovec janë iniciuar gjithsej **524 raste** (13 raste janë transferuar ne **DRP & DPP**), duke përfshirë këtu **374 vepra penale** dhe **150 incidente**.

Gjatë vitit 2019 në Stacionin Policor Rahovec janë iniciuar gjithsej **547 raste** (24 raste janë transferuar ne **DRP & DPP**), duke përfshirë këtu **426 vepra penale** dhe **121 incidente**.

Numri i përgjithshëm i rasteve për vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 tregon **ngritje për 4.39 % apo 23 raste më shumë**, derisa **veprat penale** për vitin që po raportohet tregojnë **ngritje 13.90%**, **incidente** kanë shënuar **rënie 19.33%**.

1.1 Veprat Penale

Sipas të dhënave nga Sektori i Hetimeve të Stacionit Policor Rahovec, gjatë vitit 2019 janë iniciuar **547 vepra penale (24 raste të transferuar)** derisa për vitin 2018 ishin iniciuar **524 vepra penale (13 raste të transferuar)**.

Nga kjo rezulton se në vitin 2019, në krahasim me vitin 2018 janë iniciuar 4.39 % më shumë vepra penale.

Gjatë vitit 2019 janë iniciuar 213 vepra penale kundër pasurisë, kurse në vitin 2018 janë iniciuar 197 vepra të tilla penale.

Nga kjo rezulton se veprat sipas klasifikimit të cekur si më lart në krahasim me vitin 2018, në vitin 2019 kanë shënuar ngritje për rreth 8.12 %.

Duke qenë se në vitin 2018 numri i rasteve të **vjedhjeve** është **35 raste**, kurse në vitin 2019 ishte **43 raste**, ka shënuar **ngritje për 22.86 %**.

Sa i përket **vjedhjeve të rënda**, në vitin 2018 janë iniciuar 95 raste, kurse në vitin 2019 ishin 69 raste, që do të thotë se është një **rënie për 27.37 %**.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit: kanë shënuar ngritje për 12.84 % apo 14 më shumë krahasuar me vitin 2018,

Gjatë vitit 2019 kanë shënuar ngritje veprat penale: Kanosjet, Ngacmimet, Sulmet, kurse dhe Lëndimet e Lehta dhe të Rënda Trupore kanë shënuar rënie, Gjatë kësaj periudhe është regjistruar një rast i **Vrasjes**.

Statistikat tregojnë se zbulueshmëria e veprave penale për vitin 2019 është **58.6 %** deri me tani ndërsa mbetet të punohet ende në zbulimin e tyre.

Emrat e Veprave Penale si Kodit Penal	Viti 2018	Viti 2019	% krahasuese
VP kundër Rendit Kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës	0	0	
VP kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndër	0	0	
VP kundër jetës dhe trupit	109	123	12.84 % ngritje
VP kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	1	1	
VP kundër të drejtave të votimit	0	2	
VP kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës	0	0	
VP kundër integritetit seksual	1	4	3 më shumë
VP kundër martesës dhe familjes	39	34	12.84 rënie
VP kundër shëndetit publik	1	1	
VP të narkotikëve	1	3	2 më shumë
Krimi i organizuar	0	0	
VP kundër ekonomisë	12	4	66.67% rënie
VP kundër shërbimeve komunale	0	0	
VP kundër pasurisë	197	213	8.12% ngritje
VP kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore	4	7	3 më shumë
VP kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	9	8	1 më pak
VP të armëve	22	16	27.27% rënie
VP kundër sigurisë së trafikut publik	3	1	2 më pak
VP kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike	6	1	83.33 % rënie
VP kundër rendit publik	7	8	14.29 % ngritje
Korrupsioni zyrtarë dhe VP kundër detyrës zyrtare	1	0	

1.2 Incidentet

Statistikat tregojnë se gjatë vitit 2019 në Stacionin Policor Rahovec janë iniciuar gjithsej 121 incidente ndërsa gjatë vitit 2018 ishin iniciuar 150 incidente.

Statistikat tregojnë se zbulueshmëria të incidentet për vitin 2019 është rreth **96.3 %**.

INCIDENTE	Viti 2018	Viti 2019	%
PRQP	23	11	52% rënie
Vetëvrasje	4	0	
Tentim vetëvrasje	9	3	66.67% rënie
Aksidentet me dëme materiale	85	77	18.95% rënie
Tjera	23	22	1 më pak
Gjithsej incidente dhe aksidente	150	121	19.33% rënie

2. Të dhëna rreth aktiviteteve operative

Planet operative të realizuara gjatë vitit 2019:

“Rrjeta”, “Sezona verore”, “Java e sigurisë në trafik”, “Shtimi i masave të sigurisë rreth objekteve shkollorë”, “Sezona dimërore”. “Shtimi masave të sigurisë ndaj akteve terroriste”,

“Gatishmëria Vepruese”, “Stop Drogave në shkolla”, “Stop Fajdeve”, etj.

	Viti 2018	Viti 2019	%
Plane operative nga Stacioni dhe njësitet policore	96	135	39 më shumë
Protesta	4	1	003 më pak
Asistime gjykatave	6	9	003 më shumë
Asistime KEDS-it	5	2	003 më pak
Asistime AKP-së	1	0	
Asistime KK-së	19	20	001 më shumë
Patrullime me veturë	1376	1252	124 më pak
Patrullime këmbë	821	816	005 më pak
Pika kontrolli të automjeteve	2445	2055	390 më pak
Armë të konfiskuara	26	20	004 më pak
Municion i konfiskuar	292	54	228 më pak

Arrestimet 2018, Sipas autorizimeve janë arrestuar 149 persona, 58 në mbajtje deri në 48 orë,

Arrestimet 2019, Sipas autorizimeve janë arrestuar 189 persona, 97 në mbajtje deri në 48 orë.

Vizitat në vendbanimet e banuar nga serbët:

Në lagje veriore të qytetit të Rahovecit, fshatin Hoçë e Madhe dhe Zoçishtë, gjatë vitit 2019 janë regjistruar 47 vizita me 11500 vizitor nga vende të ndryshme.

Të tjera:

Gjatë vitit 2019, Stacioni Policor Rahovec i përfaqësuar nga Komandanti (apo i deleguari i tij) ka marrë pjesë në shtatë (07) takime të KKSb-së.

Gjatë vitit 2019 kemi (08) raste të përdorimit të forcës, (06) ankesa të qytetarit dhe (09) raste të hetuara në nivel lokal,

Masat disiplinore:

- 01 suspendim të përkohshëm,
- 01 vërejtje me shkrim,
- 02 vërejtje me gojë,
- 10 Shpallur të pafajshëm,

3. Prioritetet dhe planifikimi për vitin 2020

Situata e përgjithshme e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së SP Rahovec do të realizohet përmes aktiviteteve kryesore si:

- Identifikimi i dukurive negative,
- Informatat inteligjente,
- Planet përkatëse operative,
- Marrja e masave për sigurinë në shkolla dhe sigurinë në trafik,
- Planifikimi i ngjarjeve karakteristike për periudhë të caktuar etj.

Prioritetet dhe planifikimi për vitin 2020

Realizimi i punës sipas metodologjisë së re përmes aktiviteteve si :

- Bashkëpunimi me qytetarë, institucione, organizata të ndryshme etj; pjesëmarrja në takimet e forumeve të sigurisë; realizimi i punës sektoriale etj.
- Parandalimi dhe rënia e krimit.
- Performanca profesionale e punës sipas rregullave dhe procedurave në fuqi përmes trajnimeve të brendshme, inspektimeve të rregullta të punës, takimet e rregullta me stafin etj.

Datë: 13.01.2020

Përmbledhur nga: Rr Sedat Shehu # 7115



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

01 Nr. 02/20
Rahovec, 20.02.2020

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më
28 shkurt 2020 (e premte) me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.
Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës të Republikës së Shqipërisë;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Civita të Republikës së Italisë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Frascineto të Republikës së Italisë;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Memorandum mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimoreve "Shtëpia e Sigurt" për periudhën 3 (Tre) vjeçare 2020 -2022;
7. Shqyrtimi i Planit të prokurimit për vitin 2020;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të vendimit të datës 16.02.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Draft Rregullores për Taksa Komunale;
10. Raporti vjetor i Komandantit të stacionit policor për vitin 2019 - Rahovec.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



DRAFT

RREGULLORE NR. 51/2020

PËR

TAKSA KOMUNALE

DRAFT

DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE

Kuvendi Komunal i Komunës së Rahivecit

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), të nenit....., të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 005/2013 në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2020 Kuvendi i Komunës së Rahovecit, miraton,

RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Rahovecit, lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga taksa dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1. **Taksë komunale** – nënkupton shumën fikse dhe e pakthyeshme e pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:
 - 1.1.1. lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;
 - 1.1.2. shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;
 - 1.1.3. ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;
 - 1.1.4. pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;
 - 1.1.5. ndërtimit, rrënimt të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe
 - 1.1.6. shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.
 - 1.2. **Taksë qendrore** – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat mblidhen nga Komuna;
 - 1.3. **Vit fiskal** - nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) dhjetor të të njëjtit vit;

- 1.4. **Gjobë** – nënkupton sanksionin kundërvajtës që i shqiptohet personave juridik dhe fizik për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje
- 1.5. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;
- 1.6. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;
- 1.7. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;
- 1.8. **Pano reklamuese** – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, i vendosur në një objekt statik apo lëvizës;
- 1.9. **Shoqëri Tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

KAPITULLI II

KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë Rregullore tjetër komunale.
2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen marrë parasysh parimin e jo diskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohej që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).
2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhër-pagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës.
3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.
5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimiit
6. Pagesat e bëra nëpërmjet kioskave elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës çdo tre muaj.

Neni 6

Lirimet nga taksat komunale

1. Të gjitha kategoritë e liruar nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Për çdo lloj lirim nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
3. Për çdo lloj lirim nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
4. Nëse ndonjë procedurë, ku kërkohet pagesa e taksave komunale, është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa.

KAPITULLI III

DREJTORIA PER ADMINISTRATE

TAKSA KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE ZYRTARE

Neni 7

Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa	Ekzistuese
1.	Certifikata e lindjes	1 €	
2.	Ekstrakti i lindjes	1 €	
3.	Certifikata e shtetësisë	1 €	2€
4.	Certifikata e martesës	1 €	
5.	Certifikata e vendbanimit apo e vendqëndrimit	2 €	
6.	Certifikata e gjendjes martesore	1 €	5€
7.	Certifikata e vdekjes	1 €	
8.	Certifikata e bashkësisë familjare	2 €	5€
9.	Akti i vdekjes	5 €	
10.	Deklaratë për mbajtës të familjes	10 € ekzis	
11.	Vërtetim për afërsinë familjare	1 €	
12.	Vërtetim mbi mjetet e jetesës	2 €	
13.	Vërtetim për mbajtjen e prindërve	2 €	
14.	Vërtetim mbi marrëdhëniet familjare	1 €	
15.	Vërtetim që personi është në jetë	1 €	
16.	Vërtetim që personi nuk është banor i komunës	1 €	
17.	Vërtetimi mbi konfirmimin e identitetit	1 €	
18.	Vërtetim për lajmërim apo ç'lajmërimin e vendbanimit	2 €	
19.	Vërtetim që personi nuk është banor i komunës	1 €	
20.	Vërtetimi që personi nuk është regjistruar në regjistrat civil	1 €	

21.	Vërtetimi që personi nuk është në marrëdhënie pune	1 €	
22	Vërtetimi për gjendjen ekonomike	1 €	
23	Vërtetim mbi kombësinë	1€	
24	Vërtetim i arkivës	1€	
25	Procesverbal i atësisë dhe i amësisë	Ekzis 10€	Propo 5€
26	Kopja e certifikatave dhe vërtetimeve të lëshuara më parë	0.50 €	Prop 1

2. Paga sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të certifikatës apo dokumenteve zyrtare. 2.1. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të merret certifikata apo dokumenti zyrtar.

3. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni Komuna lëshon dëshminë përkatëse dhe ky vërtetim është i vlefshëm brenda gjithë vitit fiskal, kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet pas pagesës së taksës.

Neni 8

Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje janë të liruara kategoritë si në vijim:

- 1.1. Veteranët e luftës - bashkëshortja dhe fëmijet deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
- 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së - bashkëshortja dhe fëmijet deri në moshën 18 vjeçare; (dëshmi kartela valide)
- 1.3. Familjarët e dëshmorëve - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi kartela valide)
- 1.4. Familjarët e të zhdukurve të luftës - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi nga organi kompetent)
- 1.5. Familjarët e viktimave civile (martirëve) - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi nga organi kompetent)
- 1.6. Personat e verbër;
- 1.7. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik (me aftësi të kufizuar);
- 1.8. Përfituesit e skemave sociale (dëshmi kartoni social me afat);
- 1.9. Pensionistet, shoqata dhe Sindikata e Pensionisteve; (dëshmi librezë e anëtarësisë);
- 1.10. Studentët - (studentat mbi moshën 25 vjeçare, dëshmi vërtetimi i semestrit);
- 1.11. Ish të burgosurit politik;
- 1.13. Viktimat e dhunës seksuale të luftës;
- 1.14. Familjet strehuese; (**Propozim**);

Neni 9

Detyrimi lidhur me të dhënat

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me certifikatat e parapara nga nën paragrafi 1.1 deri te nën paragrafi 1.8 të paragrafit 1 të nenit 7 kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor.

2. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me vërtetimet e parapara nga nën paragrafi 1.9 deri te nën paragrafi 1.26 të nenit 7 kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

KAPITULLI IV TAKSAT KOMUNALE ADMINISTRATIVE

Neni 10

Lartësia dhe pagesa e taksave komunale administrative

1. Të gjithë personat që pranojnë shërbime të caktuara komunale nga Komuna të paraparë në këtë nen, paguajnë taksë komunale administrative, si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa	Ekzist
1	Parashtrimi i kërkesave	1€	
1.	Kurorëzimi brenda objektit të komunës, brenda orarit të punës	10 €	10e
2.	Kurorëzimi brenda objektit të komunës, jashtë orarit të punës	20 €	20E
3.	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, brenda orarit të punës	25 €	
4.	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, jashtë orarit të punës	50 €	50E
5	Kurorëzimi me shtetas/se të huaj	50 €	50E
5.	Korrigjimi emrit personal (gërmëzimi)	3 €	
6.	Ndryshimi i emrit dhe mbiemrit personal	5 €	20€
7.	Ndërrimi i mbiemrit pas anulimit të martesës	5 €	
8.	Anulimi i dyfishtë i regjistrimit në gjendjen civile	5 €	5E
9.	Konfirmimi i deklaratës me dy dëshmitarë	2 €	
11.	Pajisje me dokumente nga arkiva (për një faqe)	0.50 €	
13.	Konfirmimi i vërtetësisë së nënshkrimit	1 €	
14.	Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A4)	0.15 €	
15.	Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A3)	0.25 €	
20.	Lëshimi i certifikatës së përdorimit	20 €	
21.	Lëshimi i pëlqimit urbanistik dhe dokumenteve tjera urbanistike	10 €	
22.	Lëshimit të pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën emergjencës	15 €	

2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të shërbimit komunal dhe pa dëshmi të pagesës nuk ofrohet shërbimi.
3. Kërkesat në emër të këshillave (kryetarëve) të fshatrave dhe lagjeve urbane lirohen nga pagesa e taksës administrative nga pika 1 e paragrafit 1 të këtij neni.

KAPITULLI V DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Neni. 11

Taksa mbi shërbimet shëndetësore sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – Mbledhja dhe Shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore.

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Egzaminimi mjekësor i mjekut të përgjithshëm në punkt, QMF ose në QKMF pa analiza laboratorike dhe pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00 € Ekzistuese 1 €
2.	Ekzaminimi specialistik në QKM/QKMF me udhëzim të mjekut të familjes	2.00 € Ekzistuese 1 €
3.	Ekzaminimi specialistik në QKMF/QMF pa udhëzim të mjekut të familjes	5.00 € Ekzistuese 4 €
4.	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00 € Ekzistuese 6 €
5.	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.00 €
6.	Ultrazëri standard	2.00 € Ekzistuese 2 €
7.	Radiografia	2.00 € Ekzistuese 2€
8.	EKG	0.50 € Ekzistuese 0.50 €
9.	Analizat laboratorike-hemogrami dhe urina	1.0 € Ekzistuese 1 €
10.	Analizat laboratorike (komplet)	3.00 € Ekzistuese 3 €
11.	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve	1.0 € Ekzistuese 1 €
12.	Audiograma	1.0 € Ekzistuese 1 €
13.	Shpërlarja e veshit	1.0 € Ekzistuese 1 €
14.	Dhënia e injeksionit intramuskulor në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.0 € Ekzistuese 1 €
15.	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.0 € Ekzistuese 1 €
16.	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00 € Ekzistuese 3 €
17.	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.0 €

		Ekzistuese 1 €
18.	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve	18.00 € Propozim 20 €
19.	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore për punësim	18.00 € Ekzistuese 18 €
19.	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00 € Ekzistuese 18 €
20.	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00 € Ekzistuese 5 €
21.	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive – për një orë	25.00 € Ekzistuese (10) €
22.	Certifikata për adoptim të fëmijëve	50euro

1. Shërbimet stomatologjike të nivelit parësor

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Vizita e pare stomatologjike	1.0 € Ekzistuese 1€
2.	RTG i dhëmbit	1.50 € Ekzistuese 1.50 €
3.	Mbështetje e përhershme me amalgamë	4.00 € Propozim 2 €
4.	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00 € Propozim 3 €
5.	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 € Propozim 4 €
6.	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00 € Propozim 5 €
7.	Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë kompozitë)	6.00 € Propozim 5€
8.	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë apo kompozitë)	6.00 € Propozim 5 €
9.	Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë apo kompozitë)	6.00 € Propozim 5 €
10.	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00 € Propozim 5 €
11.	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00 € Ekzistuese 6 €
12.	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.0 € Egzistuese 1 €
13.	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.0 € Ekzistuese 1 €
14.	Vulosja e fisurave	1.0 € Ekzistuese 1 €

15.	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.0 € Ekzistuese 1 €
16.	Mënjanimi i depozitimeve të (forta heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00 € Ekzistuese 3 €
17.	Kieretazha e xhepave paradonta (një dhëmbë)	1.0 € Ekzistuese 1 €
18.	Nxjerrja e dhëmbit	1.50 € Propozim 1
19.	Incizimi infra dhe ekstra oral	1.50 € Ekzistuese 1.50 euro
20.	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.0 € Ekzistuese 1 euro
21.	Riparimi i protezës(ngjitja)	1.50 € Ekzistuese 1.50 euro
22.		

Neni 13

Lirimet nga pagesa e shërbimeve shëndetësore

1. Nga pagesa e shërbimeve shëndetësore sipas nenit 12 të kësaj Rregulloreje janë të liruara kategoritë si në vijim:
 - 1.1. Veteranët e luftës - bashkëshortja dhe fëmijet deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së - bashkëshortja dhe fëmijet deri në moshën 18 vjeçare; (dëshmi kartela valide)
 - 1.3. Familjarët e dëshmorëve - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi kartela valide)
 - 1.4. Familjarët e të zhdukurve të luftës - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi nga organi kompetent)
 - 1.5. Familjarët e viktimave civile (martirëve) - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi nga organi kompetent)
 - 1.6. Personat e verbër;
 - 1.7. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik (me aftësi të kufizuar);
 - 1.8. Përfituesit e skemave sociale (dëshmi kartoni social me afat);
 - 1.9. Pensionistet, shoqata dhe Sindikata e Pensionisteve; (dëshmi librezë e anëtarësisë);
 - 1.10. Studentët - (studentat mbi moshën 25 vjeçare, dëshmi vërtetimi i semestrit);
 - 1.11. Ish të burgosurit politik;
 - 1.13. Viktimat e dhunës seksuale të luftës;
 - 1.14. Familjet strehuese dhe fëmijët që janë të strehuar. (**Propozim**);

Neni 14

Taksat për shërbimet Sociale (QPS)

1	Vërtetim për humbjen e shtetësisë	5€- Propozim 20€
---	-----------------------------------	-------------------------

2	Vërtetim për fitimin e shtetësisë së Kosovës	5€- Propozim 10€
3	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit për armëmbajtje	3€- Propozim 20€
4	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit për punësim	Propozim 10 euro
5	Pëlqim për martesë para moshës madhore	5€- Propozim 10€
6	Caktimi i emrit personal	3€- Propozim 10€
7	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve	5€
8	Vërtetim që pala nuk është në përkujdesjen e kujdestarit të përkohshëm ligjore	5€
9	Vendim për caktimin e kujdestarit për raste të veçanta	10 euro
10	Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijë, prindërit e të cilëve jetojnë ndaras jashtë shtetit	5€
11	Anamneza sociale, (konstatim i gjendjes faktike) dhe shërbimet tjera	3€ Propozim 5€
12	Vërtetim që nuk është përfitues i ndihmës sociale	3€ ekzistuese 5

KAPITULLI VI DREJTORIA PËR ARSIM

Neni 15

1. Taksa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2011 për Participim të Vijuesve të Arsimit dhe Aftësimit për të Rritur

Nr.	Kategoria	Taksa	Ekzist
1.	Për regjistrim të vitit - për një klasë	100 €	
2.	Për praktikë profesionale	50 €	
3.	Provimi diferencial	10 €	
4.	Për provimet përfundimtare të klasës – certifikata	30 €	
5.	Për diplomë të përfundimit të shkollimit	20 €	
6.	Qëndrimi ditor i fëmijës në qerdhe për 1 muaj	Prop 40 €	30 €
7.	Qëndrimi gjysmëditor i fëmijës në qerdhe për 1 muaj	Prop 20 €	15 €
8.	Pagesa për diplomat duplikat		1 €
9.	Pagesa për dëftesa duplikat		0.50 €

2. Çdo person që shfrytëzon objektet komunale komerciale apo për qëllime tjera, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 1.1. Shfrytëzimi i sallave të sportit për qëllime komerciale në shkollë – dhjetë euro (10 €/h) për një orë;
 - 1.2. Shfrytëzimi i sallave të sportit për qëllime jo komerciale në shkollë – dhjetë euro (10 €/h) për një orë;
3. Përfshirë nga paragrafi 1 i këtij neni, shfrytëzimi i objekteve komunale për qëllime edukative, arsimore, shkencore dhe për qëllim të ngjashme sociale është i liruar nga pagesa.
4. Pagesa e taksës komunal për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale sipas paragrafit një (1) të këtij neni bëhet para marrjes në shfrytëzim të objektit.

KAPITULLI VII DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Neni 16
Lartësia dhe pagesa e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik cili është banor i Komunës dhe ka ne pronësi mjet motorik dhe çdo person juridik që ka seli në Komunë dhe ka në pronësi mjet motorik, paguan taksën vjetore mbi pronësinë e mjetit motorik, si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa	Ekzist	prop
1.	Motoçikletë	10€	00€	10 €
2.	Automobil për udhëtarë deri në 3.5 ton	20 €	10€	
3.	Automobil për udhëtar mbi 3.5 ton	25 €	20€	
4.	Kamionet deri në 3.5 ton	25 €	10€	
5.	Kamionet mbi në 3.5 ton	30 €	20 €	
6.	Kombibus dhe autobusë për transportim të udhëtarëve deri në 30 ulëse	30 €	20 €	
7.	Autobusë për transportim të udhëtarëve mbi 30 ulëse	35 €	20 €	

2. Personat e përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni, taksën e paguajnë para regjistrimit të mjetit motorik sipas legjisalcionit në fuqi.

Neni 17
Lirimet nga taksa komunale mbi mjetet motorike

1. Nga pagesa e takës komunale mbi mjetet motorike janë të liruar mjetet motorike në pronësi të:
 - 1.1. institucioneve publike të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësitë diplomatike, përfshirë edhe stafin e huaj;
 - 1.3. Kryqit të Kuq të Kosovës;
 - 1.4. Veteranet e UCK-se;
 - 1.5. Invalidet e UCK-se; dhe
 - 1.6. Familjet e Deshmoreve, prindrit, bashkeshortja dhe femijet;
 - 1.7. Mjete motorike tjera me si rimorkojo, mekanizmat motorik bujqesore lirohen nga taksa komunale

KAPITULLI VIII
DREJTORIA PER EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZEM

Neni 18
Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

Nr.	Emertimi	Ekzist	prop
1.	Vendimi mbi ndërrimin e pronarit, emrit te biznesit (lokali i njejtë)	20€	
2.	Vendimi për vazhdimin e orarit në hotel, restaurant dhe sallonet e dasmave për 1 natë	30€	
3.	Vendimi për leje pune në ditet e festave per 1 ditë	20€	
4.	Leje të posaçme të ndërmarrjeve ndërtimore/në rastet e	20€	

	jashtëzakonshme për shkak të natyrës së punëve deri në ora 23h (1 ditë)		
5.	Të gjitha veprimtaritë për oraret e zgjatura të çfarëdo veprimtarie për 1 dite	20€	
6.	Vendim për leje pune në ditët e festave për (1 vit)	100 €	
7.	Vendimi për vazhdimin e orarit të punës në hotel, restaurant dhe sallonet e dasmave për një (1) muaj, vetëm për dasma dhe ahengje familjare	600 €	
8.	Dhënia e vërtetimit, dëshmi për kontributin e sigurimit pensional, invalidor, për bizneset e regjistruara para luftës	1€	

Neni 19
CMIMI FILLESTAR I DHËNIES SË PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM
(ANKAND PUBLIK)

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop nga DEZHT
1.	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim - lokaleve afariste (Zona e parë) – me qera (çmimi fillestar)	2€/m ² mujore	4€/m ² qira mujore
2.	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të depove të Matrexit në Xërxe me qera (Çmimi fillestar)	0.50€/m ² mujore	0.60€/m ² mujore
3.	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të depove të Matrexit në Xërxe – hapësira e jashtme – me qera (Çmimi fillestar)	0.10€/m ² mujore	0.20€/m ² mujore
4.	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim - lokaleve afariste (Palestra Sportive) me qera - (Çmimi fillestar)	0.00	4€/m ² qira mujore
4.	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të tregjeve (Qytet) me qera - Çmimi fillestar	0.20€/m ² mujore	0.20€/m ² mujore
5.	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të tregjeve me qera (Fshat) - Çmimi fillestar	0.10€/m ² mujore	0.10€/m ² mujore

Neni 20
Taksa për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës – Zona Ekonomike – Parku
Industrial – Opterushë

Nr	Emërtimi	Taksa e propozuar nga DEZHT	Propozimi Kuvendi
1	Sipërfaqja nga 1 deri në 2000 m ²	0,08€	
2	Sipërfaqja nga 2000 deri në 5000 m ²	0,06€	
3	Sipërfaqja nga 5000 deri në 10,000 m ²	0,05€	
4	Sipërfaqja nga 10,000 deri në 20,000 m ²	0,03€	

Neni 21

ÇMIMET FILLESTARE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS KOMUNALE (ME ANKAND PUBLIK), TAKSA MUJORE

1. Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale nëpër vendbanime dhe vise tjera rurale të komunës së Rahovecit është si në vijim:
 - 1.1. Çmimi i qerasë mujore për zonën e parë që përfshin pronat komunale që shtrihen përgjatë rrugëve magjistrale është 0.20€/m²;
 - 1.2. Çmimi i qerasë mujore për zonën e dytë që përfshin pronat komunale në periferi të rrugëve magjistrale është 0.10€/m²;
 - 1.3. Çmimi i qerasë mujore për zonën e tretë që përfshinë pronat komunale kodrinore – malore është 0.05€/m²;
 - 1.4. Nese toka komunale shfrytëzohet për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe deri ne 15 m², qiraja mujore për tokë do të jetë 30€, kurse mbi 15 m² për çdo m² paguhet nga 1€.
2. Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale me qëllim të vendosjes apo ndërtimit të objekteve të përkohshme për aktivitete biznesore është si në vijim:
 - 2.1. Çmimi i qerasë mujore për zonën e parë është ----- 0.50€/m²;
 - 2.2. Çmimi i qerasë mujore për zonën e dytë është ----- 0.30€/m²;
 - 2.3. Çmimi i qerasë mujore për zonën e tretë është ----- 0.20€/m²;
3. Qiraja duhet paguar në baza mujore dhe pagesa duhet të kryhet në bazë të kontratës.

Neni 22

Minierat dhe guroret

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet brenda Komunës, paguan taksë vjetore komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, për aktivitet ekonomike të zhvilluar si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa	ekzist
0811	Gurthyerja e gurit ornamental dhe ndërtimor, gëlqeres, gipsit, shkumësit dhe rrasave	300 €	500 €
0812	Operimi i puseve të zhavorrit dhe rërës; miniera e argjilave dhe kaolinit	300 €	500 €
0899	Minierat dhe gurëthyesit tjerë p.k.t.	300 €	Propozi m 500€
SEKTORI C - INDUSTRIA PËRPUNUESE			
1061	Prodhiimi i produkteve të miellit të drithit	80 €	Ekz200€
1729	Prodhiimi i artikujve të tjerë prej letre dhe kartuçi	100 €	Ekz200€
1813	Shërbimet e përgatitjes për shtyp dhe botim	60 €	50€
2361	Prodhiimi i produkteve të betonit për qëllime të ndërtimtarisë	250 €	Ekz 0€ Prop 500€
2363	Prodhiimi i betonit të përzier të gatshëm	250 €	500€
3312	Riparimi dhe mirëmbajtja e makinerisë	100 €	Prop 100€
3513	Distribuiimi i rrymës	500 €	2000€
3522	Distribuiimi i lëndëve të gazit përmes stacioneve shpërndarës	400 €	Prop 100€
3600	Grumbullimi i ujit, trajtimi dhe furnizimi	200 €	300€
3700	Kanalizimi	200 €	Ekz 150€ Prop 250€
3811	Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme	200 €	Prop 100€
3812	Grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme	300 €	Prop 100€
3831	Çmontimi i mbeturinave të metala	250 €	Prop 100€
4110	Zhvillimi i projekteve ndërtimore	300 €	Prop 100€
4120	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore	400 €	Ekz 150€ Prop 200€
4211	Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave	400 €	Prop 300€
4311	Demolimi i objekteve	300 €	Prop 100€
4321	Instalimi elektrik	350 €	Prop 200€
4331	Suvatimi	200 €	100€
4334	Lyerja dhe lustrimi	200 €	Prop 100€
4511	Shitja e veturave dhe mjeteve të lehta motorike	250 €	Prop 150€
4519	Shitja e mjeteve tjera motorike	200 €	Prop 100€
4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike	200 €	100€
4531	Shitja me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve motorike	300 €	Prop 200€
4532	Shitja me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve motorike	200 €	Prop 100€
4631	Shitja me shumicë e frutave dhe perimeve	200 €	Prop 100€
4632	Shitja me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit	300 €	propo 150€
4641	Shitja me shumicë e tekstileve	150 €	Prop 100€
4643	Shitja me shumicë e aparateve elektrike shtëpiake	180 €	Propo 200€
4645	Shitja me shumicë e parfumeve dhe kozmetikës	200 €	Prop 100€
4661	Shitja me shumicë e makinerisë bujqësore, pajisjeve dhe furnizimeve	300 €	200€
4671	Shitja me shumicë e produkteve të ngurta, lëngat dhe lëndëve djegëse të gazta etj	250 €	300€

4673	Shitja me shumicë e drurit, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve sanitare	250 €	200€
4675	Shitja me shumicë e produkteve kimike	300 €	100€
4677	Shitja me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve	200 €	100€
4722	Shitja me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në shitore të specializuar	100 €	150€
4730	Shitja me pakicë e karburanteve motorike në shitore të specializuara	200 €	250€
4741	Shitja me pakicë e kompjuterëve, njësive periferike dhe softuerëve në shitore të specializuara	100 €	100€
4742	Shitja me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit në shitore të specializuara	100 €	Prop 100
4752	Shitja me pakicë e artikujve metalik, bojërave dhe qelqit në shitore të specializuara	100 €	Prop i ri 100
4753	Shitja me pakicë e qilimave, tapicerisë së murit dhe materialit të dysHEMEVE në shitore të specializuara.	100 €	Prop i ri 100euro
4754	Shitja me pakicë e elektrike shtëpiake në shitore të specializuara	100 €	200€
4759	Shitja me pakicë e mobileve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve tjerë shtëpiak në shitore të specializuara	100 €	300€
4771	Shitja me pakicë e rrobave në shitore të specializuara	80 €	100€
4773	Farmacisti shpërndarës në shitore të specializuara (Barnatoret)	150 €	150€
4776	Shitja me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificial, kafshëve përkëdhelëse dhe ushqimi i tyre në shitore të specializuara	70 €	Prop 100€
4777	Shitja me pakicë e orëve dhe argjendarisë në shitore të specializuara	70 €	Prop 100€
4939	Transporti tjetër tokësor i pasagjerëve.	100 €	50€
4941	Transporti i mallrave përmes rrugëve	100 €	50€
5210	Magazinimi dhe deponimi	100 €	Prop 100e
5229	Aktivitetet tjera përkrahëse të transportit	100 €	100€
5310	Aktivitetet postare sipas obligimit të shërbimit universal	100 €	300€
5510	Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm	150 €	200€
5590	Akomodimi tjetër	100 €	300€
5610	Restorante dhe aktivitetet tjera shërbyese të ushqimit	150 €	150€
5621	Aktivitetet e furnizimit të rastësishëm të ushqimit	100 €	300€
6020	Aktivitetet e programimit dhe transmetimit televiziv	250 €	200€
6110	Aktivitetet e telekomunikimit kabllor	250 €	1000€
6312	Web portalet	300 €	Prop i ri 150 euro?
6419	Ndërmjetësime tjera monetare	600 €	Propozi m 150€
6492	Ndihma tjera kreditore financiare	600 €	500€
6499	Aktivitetet tjera shërbyese financiare, përveç financimit të sigurimit dhe pensional p.k.t.	500 €	1000€
6511	Sigurimi jetësor	600 €	500€
6512	Sigurimi jo- jetësor	600 €	Prop 500€
6910	Aktivitetet ligjore (te shikohet nese jane liru me kuvend)	200 €	Prop 100€
6920	Aktivitetet e kontabilitetit, mbajtjes së librave dhe të auditimit; konsultim mbi taksat	200 €	Prop 100€

7111	Aktivitetet arkitektuale	200 €	Prop 100€
7112	Aktivitetet inxhinerike dhe të konsultimit teknik	200 €	100€
7120	Testimi dhe analiza teknike	200 €	500€
7430	Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit	200 €	100€
7510	Aktivitetet veterinarë	150 €	50€
7711	Qiradhënia dhe lizingu i veturave dhe automjeteve të lehta motorike	300 €	Prop 100€
7712	Qiradhënia dhe lizingu i kamionëve	350 €	Prop 100€
7911	Aktivitetet e agjencionit turistik	200 €	Prop 100€
8010	Aktivitetet e sigurimit privat	250 €	Prop 100€
8121	Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave	150 €	Prop 100€
8553	Aktivitetet e auto shkollave	300 €	100€
8610	Aktivitetet spitalore	500 €	200€
8623	Aktivitetet e praktikës dentale	400 €	150€
8690	Aktivitete tjera të shëndetit njerëzor	400 €	100€
9602	Sallonet e floktarisë dhe trajtimet tjera të bukurisë	200 €	Prop 100€
9604	Aktivitetet e mirëqenies fizike	200 €	50€

2. Komuna i dërgon faturat për pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste shoqërive tregtare më së largu deri më tridhjetenjë (31) mars të vitit aktual. Nëse Komuna nuk ka arritur të dorëzojë faturën brenda këtij afati, obligohen shoqëritë tregtare ta kërkojnë faturën nga Komuna.
3. Shoqëritë tregtare e paguajnë taksën vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste deri më pesëmbëdhjetë (15) dhjetor të vitit aktual fiskal.
4. Taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohet në bazë të aktivitetit të regjistruar në ARBK.

Neni 23

Pagesa e pjesshme e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Në goftë se shoqëria tregtare është shuar gjatë vitit fiskal, pagesën e taksës komunave e bën si në vijim:
 - 1.1. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data një (1) janar deri më datën tridhjetenjë (31) mars të vitit fiskal, paguan tridhjetë (30 %) për qind të vlerës së taksës;
 - 1.2. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data (31) mars deri më datën tridhjetenjë (31) gusht të vitit fiskal, paguan shtatëdhjetë (70 %) për qind të vlerës së taksës; dhe
 - 1.3. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data (31) gusht deri në datën tridhjetë (30) nëntor të vitit fiskal, paguan nëntëdhjetë (90 %) për qind të vlerës së taksës; dhe
 - 1.4. Nëse shoqëria tregtare është shuar pas datës tridhjetë (30) nëntor të vitit fiskal, paguan taksën e plotë.
2. Shoqëritë tregtare të regjistruar në territorin e komunës që kryejnë veprimtari në dy (2) apo më shumë njësi, për çdo njësi tjetër paguajnë vlerën prej pesëdhjetat (50%) për qind të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
3. Shoqëritë tregtare që gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive dhe nuk kanë ushtruar veprimtari, lirohen me dëshmi të pasqyrës financiare nga (ATK).
4. Me qëllim të zbatimit të paragrafëve 1 deri në 3 të këtij neni, përfaqësuesit e shoqërive tregtare duhet t'i ofrojnë Komunës dëshmi përkatëse nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe/apo nga institucionet tjera përkatëse.

5. Shoqëritë tregtare që janë të regjistruara jashtë territorit të komunës, për çdo njësi që vepron në territorin e Komunës paguajnë vlerën e plotë të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Neni 24

Lirimet nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh datën e regjistrimit/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

2. Nga pagesat e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste janë të liruar kategoritë si në vijim:

2.1. Bashkësitë fetare, në ushtrimin e aktivitetit ekonomik për vetë qëndrueshmëri financiare; dhe

2.2. Organizatat jo qeveritare të angazhuar në aktivitet ekonomik me qëllim të mbështetjes së aktivitetit të saj jofitimprurës.

2.3. Përrjashtohen nga pika 2.2 organizatat jo qeveritare të cilat lëshojnë kredi me kamata fitimprurese (institucionet mikro financiare);

KAPITULLI IX

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Neni 25

Taksa komunale lejet për ndërtim dhe rrënim

1. Çdo person i cili synon të bëjë ndërtim apo rrënim të objekteve, paguan takës komunale për pajisjen me leje ndërtim apo për rrënim, si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop
1.	Leje ndërtimi për punët ndërtimore që maten me metër në katror (m ²) për kategorinë I – dhe II, (1.70) euro për një metër në katror (€/m ²);	1.70€/m ²	
2.	Leje ndërtimi për punët ndërtimore që nuk maten me metër në katror (m ²) për kategorinë I - (shëno shumën) euro për një metër në katror (€/m ²); (të diskutohet)		Nuk aplikohet
3.	Leje ndërtimi për punët ndërtimore që nuk maten me metër në katror (m ²) për kategorinë II (shëno shumën) euro për një metër në katror (€/m ²); (të diskutohet)		Nuk aplikohet
4.	Leje rrënimi	5€	
5	Vendim për vazhdimin e lejes së ndërtimit	10€	
6	Leje për shfrytëzimin e tokës ndërtimore (vendosja e objekteve te përkoshme	10€	
7	Miratimi i vendimeve dhe pelqimeve	5€	
8	Vërtetimet urbanistike (lloi i destinimit të tokës- industrial)		100€
9	Vërtetimet urbanistike (lloi i destinimit të tokës- bujqësore)		20€
10	Taksa ndërtimore për ndërtimin e shtallave		1€ /m ² ose 60% e vlerës së taksës

			bazë
11	Ndërtimi i objekteve banesore kolektive mbi tri banesa	70% prej vlerës së taksës bazë	
12	Ndërtimi i bodrumit	40 % e vlerës së taksës bazë	
13	Ndërtimi i nënkuilit për banim	60% e vlerës së taksës bazë	
14	Për objektet që ndërtohen në themelet e mëparshme (ekzistuese) dhe me sipërfaqe të njëjtë	40% e vlerës së taksës bazë	
15	Hapësirat e lira të shfrytëzuara	20% e vlerës së taksës bazë	
16	Hapësirat e mbuluara të shfrytëzuara	40% e vlerës së taksës bazë	
17	Ballkonet, terasat dhe loxhat	40% e vlerës së taksës bazë	

2. Taksa për dhënien e lejes mjedisore sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Komunale Mjedisore,

Nr.	Leja mjedisore	Taksa
1.	Leja mjedisore komunale për projektet në vlerë investive deri në 25.000 €	50.00 €
2.	Leja mjedisore komunale për projektet në vlerë investive mbi 25.000 €	0.2% e vlerës së projektit

3. Lista e aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale:

- 3.1. Autoserviset;
- 3.2. Autolarjet;
- 3.3. Stacionet e karburanteve të benzinës me kapacitet 50 m³;
- 3.4. Pikë shitjet e gasit (GLN) deri ne 5 m³;
- 3.5. Sharre për lëndë drunore;
- 3.6. Fabrikë për përpunimin e drurit, mobileri, etj., deri ne 1000 m³/vit;
- 3.7. Fabrika për përpunimin dhe ambalazhimin e ujit natyral, me kapacitet deri ne 1 m³/ditë;
- 3.8. Fabrika për prodhimin e lëngjeve të frutave, pije freskuese, pije alkoolike me kapacitet deri në 1 m³/dite;
- 3.9. Furra për prodhimin e bukës dhe produkteve tjera nga mielli;
- 3.10. Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza dhe rehabilitimi i tij në gjatësi deri ne 5 km;
- 3.11. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit ekzistues, në gjatësi deri ne 5 km;
- 3.12. Riparimi i rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km);
- 3.13. **Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tij deri në 1000 l/ditë;**
- 3.14. Fabrika për prodhimin e vajrave bimore, etj., me kapacitet 500 kg/ditë;
- 3.15. Thertore me kapacitet deri në 3 gjedha/ditë;
- 3.16. Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve me kapacitet deri në 100 kg/ditë;
- 3.17. Prodhimi i gelqeres (shuarja) deri në 100 ton/vit;
- 3.18. Prodhimi i betonit dhe elemnteve parafabrikate, pllakave, etj., me kapacitet deri në 50 m³/ditë;
- 3.19. Magazina e lubrifikantëve të ambalazhuara në vend prodhim;
- 3.20. Qendra per grumbullimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi, për komunat të cilat kanë më pak se 60 000 banorë;
- 3.21. Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjashëm, pa proces kimik (qepje, ngjitje, montim, etj.);
- 3.22. Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë me kapacitet deri në 500 kg/ditë;
- 3.23. Rritja artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300 m³;
- 3.24. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit me sipërfaqe totale – objekti deri në 200 m³;
- 3.25. Ndërtimi i objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimeve (hoteliere, tregtare, komerciale, afariste, etj.) me sipërfaqe bazë ndërtimi më të madhe se 600 m³;
- 3.26. Veprimtaria e prodhimit të kompostit me sasi totale përpunimi deri 100 m³ ose 40 ton/vit;
- 3.27. Depoja për plehëra kimik dhe pesticide, me kapacitet magazinues deri ne 10 ton;
- 3.28. Objektet shërbyese për ushqime të shpejta;
- 3.29. Vendet ku deponohen më pak se 10 ton mbeturina inerte;
- 3.30. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e plastikës, me kapacitet deri në 100 ton/vit;
- 3.31. Impiantet për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtime të imëta dhe të mëdha që kanë më pak se 3000 shpend, 150 derra, 30 gjedha, 300 bagëti të imëta;
- 3.32. Pajisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë me fuqinë instaluese deri në 100 KW/h;
- 3.33. Sistemi solar dhe sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/avullit deri në 100KW/orë.

Neni 26

Lirim nga taksat komunale të ndërtimit dhe rrënimit (të diskutohet)

1. Nga pagesa e taksës së ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit janë të liruar kategoritë ndërtimore si në vijim:

- 1.1. ndërtimet të cilat financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
- 1.2. ndërtimet të cilat financohen përmes donacioneve apo grantëve për interes të publikut në pajtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike;
- 1.3. ndërtimet për banim individual për përfituesit e skemës së ndihmës sociale;
- 1.4. rindërtimet e ndërtimeve të shkatkuara si rezultat i luftës, trazirave shoqërore ose forcës madhore; dhe
- 1.5. ndërtimet e objekteve fetare dhe të objekteve që kanë karakter social.

Neni 27

Taksa komunale për ndikim në infrastrukturë (diskutim - nuk aplikohet ne komunat e vogla) propozim nga urbanizmi

1. Çdo person që ndërton një ndërtesë të re apo rehabiliton substancialisht një ndërtesë ekzistuese, me anë të cilës krijohet ndikimi të drejtpërdrejtë në infrastrukturën komunale dhe ky veprim kërkon krijimin, përmirësimin, riparimin apo zgjerimin e kësaj infrastrukture, paguan taksë komunale për ndikim në infrastrukturë.

2. Taksa komunale për ndikim në infrastrukturë përcaktohet bazuar në listën e shpenzimeve për llojet e ndryshme të infrastrukturës, si në vijim:

- 2.1. (kjo listë përcaktohet nga Komuna)
- 2.2.
- 2.3.

3. Llogaritja e taksës komunale për ndikim në infrastrukturë bëhet në sipërfaqe bruto në metër në katror (m²) të objektit, sipas dokumentacionit teknik – projektit kryesor, për të cilin është dhënë miratimi dhe në bazë të cilit lejohet ndërtimi.

4. Pas vlerësimeve të bëra, Komuna lidh marrëveshje me shkrim me aplikuesin e lejes ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës.

Neni 28 (diskutim - nuk aplikohet sipas Urbanizmit)

Taksa komunale për rritjen e densitetit

1. Çdo person që ndërton një ndërtesë të re apo rehabiliton substancialisht një ndërtesë ekzistuese dhe kur kjo shkakton rritjen e numrit të njësiave banuese në Komunë, paguan taksë komunale për rritjen e densitetit, vlerë prej (shëno shumën) euro për kokë banori (€/kokë banori).

Neni 29 (diskutim - nuk aplikohet sipas urbanizmit)

Pagesat e taksave komunale të ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit

1. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënimit, dhe rritjes së densitetit bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. MMPH Nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe

shqyrtimin e kërkesave për kushtet ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të ndërtimore, apo çdo legjilacion pasues.

2. Pagesa e taksave komunale të ndikimit në infrastrukturë në vlerë deri në vlerë dyzet mijë euro (40.000 €) paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e aprovimit të kërkesës së lejes përkatëse dhe asnjë veprim për ndërtim dhe rrënim nuk mund të realizohet pa pagesën e kësaj takse komunale.

3. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit, shuma e të cilave tejkalojnë shumën prej dyzet mijë euro (40.000 €) mund të paguhet në tre (3) këste për një periudhë 12 mujore, duke filluar nga data e marrjes së lejes së ndërtimit, si në vijim:

- 3.1. kësti i parë - pagesa prej dyzetë për qind (40 %) të taksës;
- 3.2. kësti i dytë - pagesa prej tridhjetë për qind (30%) të taksës; dhe
- 3.3. kësti i tretë - pagesa prej tridhjetë për qind (30%) të taksës.

4. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit, shuma e të cilave tejkalon shumën prej njëqind mijë euro (100.000 €) mund të paguhet në katër (4) këste për një periudhë 24 mujore, duke filluar nga data e marrjes së lejes së ndërtimit, si në vijim:

- 4.1. kësti i parë - pagesa prej tridhjetë për qind (30 %) të taksës;
- 4.2. kësti i dytë - pagesa prej njëzet e pesë për qind (25%) të taksës;
- 4.2. kësti i tretë - pagesa prej njëzet e pesë për qind (25%) të taksës; dhe
- 4.3. kësti i katërt - pagesa prej njëzetë për qind (20%) të taksës.

5. Për zbatimin e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, Komuna lidh marrëveshjes të veçantë me aplikuesin e lejes ndërtimore para autoritetit noterial ku përcaktohen që pagesa e kështit të parë të bëhet brenda një (1) muaji nga data e lidhjes së marrëveshjes dhe aplikuesi i lejes ndërtimore siguron një garancionin bankar për Komunën, për pagesën e kësteve tjera.

6. Në rast të mos pagesës së kështit të parë sipas marrëveshjes së lidhur në bazë të paragrafit 4 të këtij neni, aplikuesi i lejes:

- 6.1 Komuna nuk ia lëshon aplikuesit lejen ndërtimore apo të rrënit; ose
- 6.2. Komuna realizon shumën e tërësishme të papaguar nga aplikuesi nëpërmjet garancionit bankar dhe më pas e lëshon lejen ndërtimore apo të rrënit.

KAPITULLI X

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Neni 30

1. Taksat e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të përcaktuara sipas udhëzimeve Administrative, për Tarifat e Produkteve Kadastrale të Ofruara nga Zyrtat Kadastrale Komunale dhe Tarifat për Shërbimet e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuara.

Nr.	Kategoria	Taksa
A) NDËRRIMI I KULTURAVE TË PARCELAVE		
1	Përgatitja e raportit për ndërrimin e kulturës së një parcele pa matje	10 €

	gjeodezike	
I) PUNËT E VEÇANTA GJEODEZIKE		
39	Bartja - piketimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual	1.00 € për m ²
40	Bartja – piketimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist	1.50€ për m ²
41	Identifikimi i njësive kadastrale në zyrë	10 €
42	Identifikimi i njësive kadastrale në terren	30 €
43	Konsulta profesionale	10€ për një orë
J) DHËNIA E INFORMATAVE NGA SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKAVE TË KOSOVËS NGA ZKK		
44	Vërtetimet e ndryshme	3 €
45	Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	4 €
46	Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	20 €
47	Kopja e planit	4 €
48	Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi)	4 €
49	Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor)	5 €
50	Historiati për një njësi kadastrale	20 €
K) BAZAGJEODEZIKE		
51	Pikat trigonometrike: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	5 €
52	Pikat lidhëse: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	4 €
53	Pikat poligonale: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	3 €
54	Pikë e nivelimit: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	5 €
55	Pikat në linjë: Koordinatat Y, X, H	2 €
56	Pikat e detajit Y, X,	1 €
L) TË DHËNAT NË FORMËN DIGJITALE		
57	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) deri në 1 ha-sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	10 €
58	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 1 ha deri 2 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	20 €
59	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 2 ha deri 5 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	40 €
60	Parcela në format digjital (shpfile,dwg, gml, ili) mbi 5 ha- (sipas kërkesës së palës, pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	60 €
61	5. Ndërtesa në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	5 €
62	6. CD—kompakt disku	0.50 €
63	7. Kontrollimi dhe rregjistrimi në rregjistër të të dhënave nga tereni – për njësi kadastrale	20€

2. Taksat për shërbimet pronësore sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 08/2014 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyrat Kadastrale Komunale

Nr.	Shërbimi	Taksa
A) Regjistrimi i pronës, posedimit në bazë të transaksioneve (shitblerjes), përfshirë edhe dhurimin e pronës së paluajtshme ku dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit		
1.	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000 €	20.00 €
2.	Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € e deri në 30.000 €	30.00 €
3.	Për vlerën e transaksionit prej 30.000 € e deri në 50.000 €	35.00 €
4.	Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € e deri në 100.000 €	50.00 €
5.	Për vlerën e transaksionit prej 100.000 € e deri në 150.000 €	80.00 €
6.	Për vlerën e transaksionit prej 150.000 € e deri në 200.000 €	110.00 €
7.	Për vlerën e transaksionit prej 200.000 € e deri në 250.000 €	140.00 €
8.	Për vlerën e transaksionit prej 250.000 € e deri në 300.000 €	170.00 €
9.	Për vlerën e transaksionit prej 300.000 € e deri në 350.000 €	200.00 €
10.	Për vlerën e transaksionit prej 350.000 € e deri në 400.000 €	230.00 €
11.	Për vlerën e transaksionit prej 400.000 € e deri në 450.000 €	260.00 €
12.	Për vlerën e transaksionit prej 450.000 € e deri në 500.000 €	290.00 €
13.	Për vlerën e transaksionit mbi 500.000 €	300.00 €
14.	Për transaksionet e pa vlerësueshme tjera	70.00 €
15.	Për transaksionet e pa vlerësueshme për dhurimin e pronës së paluajtshme ku dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit	80.00 €
B) Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit mbi dhuratën ku dhuratëmarrësi është anëtar i familjes ose pasardhësi i dhuratëdhënësit		
16.	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000 €	6.00 €
17.	Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € e deri në 30.000 €	9.00 €
18.	Për vlerën e transaksionit prej 30.000 € e deri në 50.000 €	10.50 €
19.	Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € e deri në 100.000 €	15.00 €
20.	Për vlerën e transaksionit prej 100.000 € e deri në 150.000 €	24.00 €
21.	Për vlerën e transaksionit prej 150.000 € e deri në 200.000 €	33.00 €
22.	Për vlerën e transaksionit prej 200.000 € e deri në 250.000 €	42.00 €
23.	Për vlerën e transaksionit prej 250.000 € e deri në 300.000 €	51.00 €
24.	Për vlerën e transaksionit prej 300.000 € e deri në 350.000 €	60.00 €
25.	Për vlerën e transaksionit prej 350.000 € e deri në 400.000 €	69.00 €
26.	Për vlerën e transaksionit prej 400.000 € e deri në 450.000 €	78.00 €
	Për vlerën e transaksionit prej 450.000 € e deri në 500.000 €	90.00 €
27.	Për vlerën e transaksionit mbi 500.000 €	87.00 €
28.	Për transaksionet e pa vlerësueshme	50.00 €

C) Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë – posedimit		
29.	Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrativ apo gjyqësor	50.00 €
D) Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi		
30.	Regjistrimi i pronësisë, i posedimit në bashkëpronësi për aktin juridik me të cilin është vendosur bashkëpronësia	20.00 €
31.	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi për secilin person që bëhet pronar – posedues.	20.00 €
32.	Regjistrimi i pronës së përbashkët të bashkëshortëve për aktin juridik me të cilin është vendosur prona e përbashkët	20.00 €
33.	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët me pjesët e veçanta	100.00 €
E) Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare		
34.	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të trashëgimisë - për çdo trashëgimtar	10.00 €
35.	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare - për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar, posedues	10.00 €
F) Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme		
36.	Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme - për secilin pronar – posedues.	20.00 €
G) Regjistrimi i hipotekave		
37.	Kërkesë (kredia) në vlerë deri në 10000 €	10.00 €
38.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 10000 € e deri në 30.000 €	20.00 €
39.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 30.000 € e deri në 50.000 €	30.00 €
40.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 50.000 € e deri në 100.000 €	80.00 €
41.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 100.000 € e deri në 200.000 €	110.00 €
42.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 200.000 € e deri në 300.000 €	140.00 €
43.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 300.000 € e deri në 400.000 €	170.00 €
44.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 400.000 € e deri në 500.000 €	200.00 €
45.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 500.000 € e deri në 600.000 €	230.00 €
46.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 600.000 € e deri në 700.000 €	260.00 €
47.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 700.000 € e deri në 800.000 €	290.00 €
48.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 800.000 € e deri në 900.000 €	320.00 €
49.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 900.000 € e deri në 1000.000 €	350.00 €
50.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 1000.000 € e deri në 1.100.000 €	380.00 €
51.	Kërkesë (kredia) në vlerë prej mbi 1.100.000	400.00 €
H) Ndryshimi dhe fshirja e hipotekës		
52.	Ndryshimi i hipotekës së regjistruar	30.00 €
53.	Fshirja e hipotekës në regjistrin e të drejtave	10.00 €
I) Regjistrimi i servituteve		
54.	Regjistrimi i servituteve në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme	50.00 €
55.	Fshirjen e servitutit nga regjistri i të drejtave	20.00 €
J) Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit		
56.	Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 10	50.00 €

	vite	
57.	Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit –qira mbajtje me kohë zgjatje prej 10 deri në 25 vite	150.00 €
58.	Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 99 vite	500.00 €
59.	Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 10 vite	10.00 €
60.	Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit –qira mbajtje me kohë zgjatje prej 10 deri në 25 vite	30.00 €
61.	Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 99 vite	100.00 €
K) Regjistrimi i barërave dhe ngarkesave tjera		
62.	Regjistrimi i barrës në tatimin mbi pronën e paluajtshme	20.00 €
63.	Regjistrimi i barrës tatimore	30.00 €
64.	Regjistrimi i masës së sigurisë (masa e përkohshme) që procedura gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr më kërkesë private të palës	50.00 €
J) Korrigjimi i të Dhënave në regjistër		
65.	Korrigjimi i të dhënave nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër sipas dokumentacionit të dorëzuar nga pala	20.00 €
L) Regjistrimi i të drejtave tjera		
66.	Regjistrimi i të drejtave, ngarkesave, barrës pronësore të tjera mbi pronën e paluajtshme	40.00 €

KAPITULLI XI DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Neni 31

Taksa komunale për ndërhyrje në infrastrukturën komunale

- Çdo person që ndërhyr në infrastrukturën komunale sipas veprimeve të përcaktuara në këtë nën obligohet ta kthejë atë infrastrukturë në gjendjen të mëparshëm dhe paguajë taksë si në vijim:

Nr.	Emërtimi	Ekzist	Prop
1.	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar prej (0-10) m ²	90€	
2.	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar prej (10-20) m	70	
3.	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar prej (20-50) m ²	60	
4.	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar mbi (50) m ²	50	
5.	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të kubëzuar prej (0-10) m ²	40	
6.	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të kubëzuar prej (10-50) m ²	60	

7	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të kubëzuar mbi (50) m ²	100	
8	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të pa asfaltuar apo pa kubëzuar me zhavor makadam deri (50) m	3	
9	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të pa asfaltuar apo pa kubëzuar me zhavor makadam mbi (50) m ²	3	
10	Groposja (shpuarje) e rrugës, trotuareve etj.	5	

2. Taksa sipas paragrafit një (1) të këtij neni paguhet para ndërhyrjes në infrastrukturën komunale.

3. Leje pune për auto-taxi, leje pune për kombibus-taxi dhe vërtetimi i orarit të udhëtimeve për autobus dhe minibusë

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop
1.	Leje pune për auto-taxi tarifa – vjetore	35€	
2.	Vazhdimi i lejes për auto-taxi, tarifa vjetore	30€	
3.	Leje pune për kombibus-taxi, tarifa vjetore	50€	
4.	Vazhdimi i lejes për kombibus-taxi, tarifa vjetore	45€	
5	Leje pune dhe vërtetimi i rendit të udhëtimeve për autobusa dhe minibus vajtje ardhje, tarifa vjetore	1€	

Neni 32

Taksa mbi vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese mbi 2m² në pronën e tij private apo të marrë në shfrytëzim apo me qira, paguan taksë vjetore, si në vijim:

1.1. Për panot reklamuese nga zero metër në katror (0m²) deri në katër metër në katror (4m²) - (Ekzistuese 150 euro)

1.2. Për panot reklamuese nga katër metër në katror (4m²) deri në gjashtë metër në katror (6m²) - (Ekzistuese 75 euro)

1.3. Për panot reklamuese nga gjashtë metër në katror (6m²) deri në tetë metër në katror (8m²) - (Propozim 80€)

1.4. Për panot reklamuese nga tetë metër në katror (8m²) deri në dhjetë metër në katror (10m²) - ; (Propozim 100 euro)

1.5. Për panot reklamuese nga dhjetë metër në katror (10m²) deri në pesëmbëdhjetë metër në katror (15m²) - (Propozim 150 euro) dhe

1.6. Për panot mbi pesëmbëdhjetë metër në katror (15m²) - (Propozim 200 euro);

2. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese në hapësirën publike, paguan taksë mujore si në vijim:

2.1. Për panot reklama (Lampost) të vendosura nëpër shtyllat e ndriçimit publik deri në (1m²) - (Propozim 2€/cop).

2.2 Për panot reklama të ndryshme afariste në hapësirën tokësore me sipërfaqe deri në (4m²)-(Ekzistuese 150.€).

2.3. Për panot reklama të ndryshme afariste (Bilborda dhe Citylight) në hapësirën tokësore me sipërfaqe më të madhe se (4m²)-(Ekzistuese 150.€).

2.4 Për panot reklama të ndryshme afariste (Bilborda dhe Citylight) në hapësirën tokësore me sipërfaqe deri në (2m²) dhe më të vogël se (12m²) Taksa vjetore (Ekzistuese 75.€) për copë.

- 2.5. Vendosja e transparentëve reklamuese për m² (Ekzistuese 15.€/m²).
- 2.6. Vendosja e shpalljeve dhe publikimeve të përkohshme, në muret dhe objektet tjera Taksa vjetore (Ekzistuese 25.€). (propozim i drejtorisë)
3. Llogaritja e taksës sipas paragrafit 2 të këtij neni bëhet duke shumëzuar totalin e madhësisë së panos reklamuese me taksën komunale mujore.
4. Çdo shoqëri tregtare obligohet që të njoftojë Komunën për vendosjen një panoje sipas dispozitave të këtij neni, përveç atyre të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, brenda gjashtëdhjetë (60) dite nga data e vendosjes, duke specifikuar llojin dhe madhësinë e panos së vendosur.
5. Pagesa e taksës komunale për vendosjen e panove sipas këtij neni bëhet si në vijim:
- 5.1. Për panot e vendosura sipas paragrafit 1 të këtij neni, pagesa vjetore bëhet deri më datën tridhjetë (30) shtator të vitit aktual; dhe
- 5.2. Për panot e vendosura sipas paragrafit 2 të këtij neni, pagesa bëhet para datës së vendosjes së panos.

Neni 33

Taksa komunale mbi parkimin e automjeteve

1. Çdo person që shfrytëzon hapësirat komunale të destinuara për parkim të veturave, paguan taksë komunale sipas dispozitave të këtij neni.
2. Taksa komunale për parkimin e automjeteve paguhet si taksë mujore ose si taksë për shfrytëzimin e përkohshëm me orë qëndrimi të veturës.
3. Taksa komunale mujore për parkimin e automjeteve është si në vijim:
- 3.1. Për personat juridik në Zonën I (ekzistuese 35 euro);
- 3.2. Për personat fizik në Zonën I – (propozim 30 euro);
- 3.3. Për personat juridik në Zonën II – njëzet e pesë euro (25 €);
- 3.4. Për personat fizik në Zonën II – pesëmbëdhjetë euro (15 €);
4. Taksa komunale për parkim të përkohshëm për qëllim të ngarkimit apo shkarkimit të mallrave është dhjetë (10 €) në muaj. (nuk ka ekzistuar);
5. Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të parkingut komunal është si në vijim:
- 5.1. Për personat juridik në Zonën I – pesëdhjetë cent (0.50 €) në orë; (Propozim)
- 5.2. Për personat fizik në Zonën I – dyzetë cent (0.40 €) në orë; (Propozim)
- 5.3. Për personat juridik në Zonën II – dyzetë cent (0.40 €) në orë;
- 5.4. Për personat fizik në Zonën II – tridhjetë cent (0.30 €) në orë;
6. Pagesa sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni bëhet në baza mujore apo në baza disamujore, pas marrjes së pëlqimit nga organi përkatës komunal. Pagesa sipas paragrafit 5 të këtij neni bëhet pas marrjes së shërbimit.

Neni 34

Taksa komunale për vendosjen e përkohshme të objekteve të ndryshme në hapësirat publike

1. Çdo person që vendos objekte të ndryshme në hapësirat publike, paguan taksë komunale si në vijim:
- 1.1. Vendosja e kiosqeve (barakave) ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare për rajonin e ngushtë të qytetit të Rahovecit taksa vjetore (Ekzistuese 10.€).
- 1.2. Vendosja e kiosqeve (barakave) ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare jashtë rajonit të ngushtë të qytetit të Rahovecit taksa vjetore (Ekzistuese 8.€).

- 1.3. Vendosja e garazheve ose objekteve tjera me material të fortë, për veprimtari ekonomike taksa vjetore (Ekzistuese 80.€).
- 1.4. Vendosja e garazheve ose objekteve tjera montazhe-demontazhë, për veprimtari ekonomike taksa vjetore (Ekzistuese 60.€).
- 1.5. Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në sipërfaqen e hapur publike deri (20/m²), në të cilën nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim së paku per 3 (tre) muaj - tarifa mujore ; (Ekzistuese 2.5 euro)
- 1.6. Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në sipërfaqen e hapur publike mbi (20/m²), në të cilën nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim së paku per 3 (tre) muaj - tarifa mujore ; (Ekzistuese 2. euro)
- 1.7. Vendosja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në sipërfaqen e hapur publike në të cilën nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim së paku për 3 (tre) muaj - tarifa mujore ; (Ekzistuese 2. euro) m²
- 1.8 Vndosja e standeve të hapura lëvizëse promovuese për veprimtari ekonomike në zonat e banimit - tarifa ditore ; (Ekzistuese 5. Euro/m2)
- 1.9. Vndosja e standeve të hapura lëvizëse promovuese për veprimtari ekonomike jashtë zonave të banimit - tarifa ditore ; (Ekzistuese 0,50. euro) m²
- 1.10. Vndosja e pajisjeve për akullore, pomfrit dhe të ngjashme për veprimtari tregtare tarifa ditore ; (Ekzistuese 0.10€/m2.)
- 1.11. Vndosja e automjetit lëvizës (dyqani mobil) për shitjen e ushqimit të shpejtë etj. tarifa ditore (Ekzistuese 0.10€/m2.)
- 1.12. Vndosja e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm – tetë euro për një metër në katror për (8 €/m²) në muaj;
- 1.13. Vndosja e tezgave para lokalit apo dyqanit tarifa ditore ; (Ekzistuese 0.10/m2.)
- 1.14. Vndosjen e lojërave të fëmijëve Luna parke etj. tarifa ditore (Ekzistuese 0.20/m2.)
- 1.15. Vndosja e gjeneratorëve statik tarifa mujore ; (Ekzistuese 2.5 euro) m²
- 1.16. Vndosja e veturave për qëllime komerciale – njëzetë euro (20 €) në muaj.
- 1.17. Vndosja e lojërave argëtuese – njëzetë euro (20 €) në muaj.
- 1.18. Vndosja e kablllove të ndryshme në hapësirë për qëllime komerciale private – njëqind euro (100 €), si pagesë e njëhershme;
- 1.19. Vndosja e kablllove të ndryshme nën tokë për qëllime komerciale private – treqind euro (300 €), si pagesë e njëhershme;
- 1.20. Shfrytëzimi i aseteve komunale nëntoksore (gypave për vndosjen e kablllove) tarifa vjetore (Egzistuese 0.20/m2.)
- 1.21. Vndosja e ormanëve (kutija, trafo, njësor –MDF)apo pajisjeve tjera shpërndarës tarifa vjetore (Ekzistuese 150 €/m2.)
- 1.22. Vndosja e foltoreve telefonike – dyqindpesëdhjetë euro (250 €) në vit;
- 1.26. Vndosja e antenave PTK, IPKO, Kujtesa, RTK, KTV, RTV 21 etj, telekomunikuese tarifa vjetore (Ekzistuese 1000 €) për një antenë.
- 1.27. Shfrytëzuesit e antenave PTK, IPKO, Kujtesa, RTK, KTV, RTV 21 në hapësirën publike mbi 100 m2 (pranë vendit ku vndosjen antena) tarifa vjetore (Ekzistuese 0.10/m2.)
- 1.28. Vndosja e bankomatëve nga institucionet financiare – dyqindpesëdhjetë euro (250 €) në vit;

Taksa komunale për qëndrimin e veturave të përjashtuara nga komunikacioni në parkingun e Komunës (Ekziston rregullore e veçantë për Automerimangë)

1. Çdo person, të cilit i qëndron vetura në parkingun e komunës si pasojë e përjashtimit nga komunikacioni, paguan taksë si në vijim:

1.1. Automjetet, motoçikletë dhe traktor – një euro e gjysmë (1.5 €) për një ditë;

1.2. Mjetet tjera deri në tre tonë e gjysmë (3.5 t) - tre euro (3 €) për një ditë; dhe

1.3. Mjetet mbi tre tonë e gjysmë (3.5 t) - pesë euro (5 €) për një ditë;

2. Lartësia e taksës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet pesëdhjetë për qind (50 %), pas kalimit të nëntëdhjetë (90) ditëve të qëndrimit të veturës në parkingun e komunës.

3. Pagesa e taksës së përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni bëhet para marrjes së veturës nga parkingu i Komunës dhe vetura nuk mund merret pa pagesën e taksës.

Neni 36

**Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare
(Nuk ka egzistuar)**

1. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e rrugëve sekondare të Komunës, paguan taksat si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa	Prop
1.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik deri në gjashtë (6) orë	5 €	20
2.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë	10 €	50
3.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë	20 €	80
4.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik mbi njëzet e katër orë (24) – për çdo ditë;	20 €	40
5.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik deri në gjashtë (6) orë	15 €	30
6.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë	30 €	60
7.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë	50 €	100
8.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik mbi njëzet e katër ore (24) - për çdo ditë;	50 €	50
9.	Bllokimi i pjesshëm i rrugëve sekondare për qëllime të ndërtimit – në ditë	10 €	20

2. Pagesa e taksës sipas paragrafit një (1) të këtij neni paguhet para bllokimit të rrugës sekondare.

Neni 37

Taksa komunale për shfrytëzimin afatgjatë dhe afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale

Të gjithë personat që marrin në shfrytëzim pronën komunalë është përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, varësisht nga lloji i pronës së paluajtshme dhe

klasifikimi, paguajnë taksën komunale mujor apo vjetore të shfrytëzimit, sipas kontratës përkatëse të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.

KAPITULLI XII DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 39

Taksa komunale për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore

1. Çdo person që kërkon të bëjë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, paguan taksë komunale si në vijim:

Nr	Emërtimi	Ekzistues	Prop
1	Për tokat bujqësore të klasës 1 deri 4	1€/m ²	
2	Për tokat bujqësore të klasës 5 deri 6	0.75€/m ²	
3	Për tokat bujqësore të klasës 7 deri 8	0.50€/m ²	

2. Për ndërrimin e përkohshëm të tokës bujqësore, personat paguajnë vetëm njëzetë për qind (20%) të vlerës së paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Taksa e paraparë në paragrafin një (1) dhe dy (2) të këtij neni paguhet para ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore dhe ky ndërrim nuk mund të realizohet pa e paguar këtë taksë.

4. Taksa në drejtorinë për Bujqësi:

	Ekzistues	Prop
Vlerësim i dëmeve në bujqësi nga komisioni	10,00 €	
Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e tokave pyjore për qëllime bujqësore	25,00 €	
Dhënia e vërtetimit për shitjen e prodhimeve bujqësore vetanake	2,00 €	
Vërtetimi për dëshmi që është prodhues bujqësor	2,00 €	
Parashtrimi i ankesave nga palët	2,00 €	
Lëshimi i Certifikatës së Regjistrimit të Fermerit (NIF)	1,00 €	

5. Dhënia e tokës komunale me qira, për qëllime bujqësore

Nr	Emërtimi	Vlera pa ujitje	Vlera me ujitje
1	Kategoria e tokës / Klasa I-II	Ekzistuese 3.5 €/ari - / propozim 2.0€	Ekzistuese 5.0 €/ari- / propozim 3.0€
2	Kategoria e tokës / Klasa III-IV	Ekzistuese 3.0 €/ari - / propozim 2.0€	Ekzistuese 4.0 €/ari - / propozim 2.5€
3	Kategoria e tokës / Klasa V-VI	Ekzistuese 2.0 €/ari - / propozim 1.0€	Ekzistuese 3.0 €/ari - / propozim 1.0€
4	Kategoria e tokës / Klasa VII-VII	Ekzistuese 1.0 €/ari - / propozim 0.5€	Ekzistuese 2.0 €/ari - / propozim 1.0€

Neni 40

Taksa komunale për shfrytëzimin afatgjatë dhe afatshkurter të pronës së paluajtshme komunale

Të gjithë personat që marrin në shfrytëzim pronën komunalë ë përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, varësisht nga lloji i pronës së paluajtshme dhe klasifikimi, paguajnë taksën komunale mujor apo vjetore të shfrytëzimit, sipas kontratës përkatëse të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.

KAPITULLI XIII DREJTORIA PËR INSPEKTIM

Neni 41

1. Taksat komunale të drejtorisë për Inspektim në Komunën e Rahovecit janë si vijon:

Nr.	Kategoria	Ekzistuse	Prop
1	Inspektime të ndryshme me kërkesë të personave fizik	10 €	
2	Inspektime të ndryshme me kërkesë të personave juridik	20 €	
3	Kërkesa për pëlqim pune	15 €	
4	Kërkesa për asgjësim mallërash	15 €	
5	Kërkesa për dalje në terren për PTK dhe KEDS	100 €	
6	Kërkesa për dalje në terren për KRU Gjakova, Ambienti (Ekoregjioni), etj	50 €	
7	Kontroll të therreve të gjedheve (inspektor veterinar) në therretore të licencuara nga AUV për krerë	5 €	
8	Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën e higjienes dhe sanitarisë	15€	

Neni 42

Taksa komunale për rrënimin e objekteve pa leje

1. Për çdo ndërtim pa leje i cili duhet të rrënohet sipas legjislacionit në fuqi, pronari i objektit paguan taksë komunale për rrënim 2€/m².
2. Taksa e parapare në paragrafin një (1) të këtij neni paguhet më së largu tre (3) ditë para datës së përfundimit të rrënit.

KAPITULLI XIV DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 42

Taksat Komunale në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport

1. Taksat komunale për shfrytëzimin e sallave, stadioneve (terreneve sportive), teknikës, biletat dhe antarësimi në bibliotekë janë si vijon:

Nr.	Kategoria	Ekzistuse	Prop
1	Dhënia në shfrytëzim e sallës së madhe në Shtëpinë e Kulturës	50€	

2	Dhënia në shfytëzim e hapësirës së galerisë	20€	
3	Shfrytëzimi i sistemit të zërimit jashtë objektit	50€	100€
4	Shfrytëzimi i sallës së madhe për shfaqjet e ndryshme me pagesë	20% e biletave	
5	Shfrytëzimi i terreneve sportive për klubet jashtë komunës pagesa	50% e biletave	30% e biletave
6	Dhënia e skenës mobile për 1 ditë	300€	200€
7	Anëtarësimi në bibliotekë për leximin e librave për 1 vit	1€	
8	Subjektet politike	Të liruara	50€

2. Hapësira sportive mund të shfrytëzohet pa pagesë nga klubet jashtë komunës së Rahovecit për stërvitje deri në 2 (dy) orë.
3. Lirohen nga pagesa e taksave komunale të cekura në nenin 42 këto subjekte si në vijim:
 - 3.1. Tubimet me karakter përkujtimore publik;
 - 3.2. Tubimet e organizuara nga Komuna e Rahovecit;
 - 3.3. Aktivitetet e drejtorisë për DKRS;
 - 3.4. Shoqatat e personave me aftësi të kufizuara (pika 1, 2 dhe 7);
 - 3.5. Shoqata e të burgosurve politik (pika 1, 2 dhe 3);
 - 3.6. Personat shfrytëzues të skemes sociale (pika 7);
 - 3.7. Organizatat/Shoqatat e dala nga Lufta;
 - 3.8. Organizatat Joqeveritare me karakter kulturor, rinor, sportiv dhe edukativo-arsimor;

Neni 44

Taksa komunale për mbajtjen e kafshëve shtëpiake

(Te diskutohet)

1. Çdo person që mban kafshë shtëpiake për qëllime rekreative në territorin e Komunës paguan taksë vjetore komunale si në vijim:
 - 1.1. Për kafshët e sterilizuar – dhjetë euro (10 €) në muaj; dhe
 - 1.2. Për kafshët jo të sterilizuar – njëzetë euro (20 €) në muaj.
2. Pagesa e taksës për mbajtjen e kafshëve shtëpiake bëhet deri më tridhjetë e një (31) mars të vitit aktual, për vitin paraprak.
3. Nëse personi ka hequr dorë nga mbajtja e kafshëve shtëpiake brenda vitit, ai paguan vetëm pesëdhjetë (50%) të taksës së paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

KAPITULLI IX

GJOBAT LIDHUR ME TAKSAT KOMUNALE

Neni 45

Gjobat lidhur me mos paraqitjen e lindjes dhe vdekjes

1. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e lindjes kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €).
2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e vdekjes së personit brenda Republikës së Kosovës,

apo brenda gjashtë (60) ditëve për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej tetëdhjetë euro (80 €).

3. Çdo drejtues i spitalit, burgu, institucionit të riedukimit dhe institucioneve tjera përkatëse, i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda (5) ditëve nga data e vdekjes së ndodhur në institucionet e tyre, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë prej shtatëdhjetë euro (70 €).

Neni 46

Gjjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin

1. Çdo person fizik që ka vendbanim apo vendqëndrim në Komunë dhe i cili nuk i ndërmarr verimet e paraparë në këtë paragraf, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej tetëdhjetë (80 €):

5.1. nuk e lajmëron ndryshimin vendbanimin dhe vendqëndrimin brenda territorit të komunës, brenda tetë (8) ditëve nga ky ndryshim;

5.2. nuk e lajmëron largimin nga Republika Kosova, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë; dhe

5.3. nuk e lajmëron kthimin në Republikën e Kosovë, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 47

Gjjobat lidhur me mos pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €).

2. Çdo shoqëri tregtare që nuk vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (100 €).

Neni 48

Gjjobat lidhur mos pagesën e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik i cili nuk e paguan taksën komunale për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej dhjetë euro (20 €).

2. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, e cila nuk e paguan taksën vetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej tridhjetë (40 €) euro.

3. Çdo shoqëri tregtare apo person tjetër juridik i cili nuk vepron si biznes individual, që nuk e paguan taksën vjetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej njëqind euro (100 €).

Neni 49

Gjobat për mos pagesën e taksës komunale për ndërrhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërrhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje sipas afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. për personin fizik – njëqind euro (100 €);
- 1.2. për personi fizik që ushtron biznes individual – dyqind euro (200 €); dhe
- 1.3. për personin juridik – treqind euro (300 €).

Neni 50

Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri i cili nuk paguan takës komunale mbi vendosjen e panove reklamuese e cila kalon vlerën prej njëqind euro (100 €) sipas afateve të përcaktuar nga kjo Rregullore kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. Shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – pesëdhjetë euro (50 €); dhe
- 1.2. Shoqëritë tregtare tjera – njëqind euro (100 €) euro.

Neni 51

Gjobat lidhur me taksat komunale për vendosjen e objekteve të në hapësirat publike

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, e cila kalon vlerën mbi njëqind euro (100 €), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. Individët dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – pesëdhjetë euro (50 €); dhe
- 1.2. Shoqëritë tregtare tjera – njëqind euro (100€).

Neni 52

Gjobat për mos pagesë taksës komunale për bllokimin e rrugëve sekondare

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për bllokimin e rrugëve sekondare sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. Personat fizik dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – tridhjetë euro (30 €); dhe
- 1.2. Personat juridik – njëqind euro (100 €).

Neni 53

Gjobat mbi mos pagesën e taksës komunale për mbajtjen e kafshëve shtëpiake

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën mbi mbajtjen e kafshëve shtëpiake sipas afatit të përcaktuar me këtë Rregullore konsiderohet se ka kryer kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. Për personin fizik – njëzetë euro (20 €); dhe
- 1.2. Për personin juridik – njëqind euro (100€).

Neni 54

Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatorë

1. Gjobat të përcaktuara me këtë Rregullore paguhën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre, por jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e shqiptimit të tyre.
2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, i dënuari lirohet nga pagimi i pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Presoni ndaj të cilit shqiptohet gjobë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje ka të drejtën e ankesës, sipas afateve dhe procedurave të parapara në legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtëse zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet.

KAPITULLI X

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 55

Taksat Qendrore

1. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguar nga niveli qendror dhe mbledh taksë të përcaktuar nga ky nivel, si në vijim.
 - 1.1. Taksa për ofrimin e shërbimeve kadastrale të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.XX/2019 (numri i saktë shënohet pas miratimit të këtij akti) për Tarifatat e Produkteve Kadastrale të Ofruara nga Zyrat Kadastrale Komunale dhe Tarifatat për Shërbimet e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuara (është në proces të konsultimit), apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.2. Taksa për ofrimin e shërbimeve kadastrale të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 08/ 2014 për Tarifatat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyrat Kadastrale Komunale;
 - 1.3. Taksa për dhënien e lejes mjedisore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Komunale Mjedisore, apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.4. Taksa për shërbimet shëndetësore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – Mbledhja dhe Shfrytëzimi i Mjeteve nga Bashkë Pagesat e Shfrytëzuesve të Shërbimeve Shëndetësore dhe të Hyrave Vetanake të Institucioneve Shëndetësore apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.5. Taksa për qasje në dokumente publike të përcaktuara sipas Rregullores Nr. 02/2012/MF për Tarifatat në Qasje në Dokumente Publike, apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.6. Taksa për vijim dhe përfundim të arsimit dhe aftësimit për të rritur të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2011 për Partecipim të Vijuesve të Arsimit dhe Aftësimit për të Rritur, apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.7. Taksa për shërbimet e ofruara për regjistrim të bizneseve, të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 11/2018 për Përcaktimin dhe Taksat për Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, apo çdo legjislacioni pasues;

1.8. Taksa për lëshimin e dokumentacion arsimor duplikatë, të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ 03/2013 – Lëshimi i Dokumenteve Duplikatë nga Institucionet Edukativo – Arsimore dhe Universitare, apo çdo legjislacion pasues; dhe

1.9. Taksa për shfrytëzimin e kullosave të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ MA-NR për Shfrytëzimin e Kullosave.

2. Çdo akt normativ tjetër i Qeverisë së Republikës së Kosovës apo ndonjë agjencie të pavarur që miratohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje që parasheh taksa qendrore, zbatohet nga Komuna, pa pasur nevojë që kjo Rregullore të ndryshojë.

Neni 56 Shtojcat

1. Në shtojcën e kësaj Rregulloreje janë të bashkëngjitura:

1.1. Shtojca Nr. 1 ku janë listuar në formë tabelare të gjitha taksat komunale të përcaktuara sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje; dhe

1.2. Shtojca Nr. 2 ku janë listuar në formë tabelare të gjitha taksat qendrore të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 57 Transparenca në taksat komunale

Kuvendi Komunal përditëson Shtojcën Nr. 2 të kësaj Rregulloreje me një vendim dhe të publikon atë, kurdo që Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjë agjenci e pavarur ndryshon taksat ekzistuese qendrore apo përcakton ndonjë taksë tjetër.

Neni 58 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (shëno emrin e Rregullores që duhet shfuqizuar).

Neni 59 Publikimi

Kjo Rregullore publikohet në ueb faqen elektronike të Komunës dhe të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 60 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më _____.

UDHËZUES SHPJEGUES PËR MODEL RREGULLOREN PËR TAKSA KOMUNALE

1. Hyre

Model Rregullorja për Taksat Komunale e hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës ka për qëllim që të krijojë një model të përafërt për Komunitetet e Republikës së Kosovës, për trajtimin e taksave komunale. Nëpërmjet kësaj *Model Rregulloreje*, synohet të sigurohet një qasje më të harmonizuar për Komunitetet në përcaktimin e këtyre taksave, duke rregulluar më qartë këto taksa, duke përcaktuar gjëra për mos pagesën e taksave komunale, duke rritur transparencën në unifikimin e të gjitha llojeve taksave që mbledhet nga komuna në një dokument të vetëm, si dhe duke përmirësuar cilësinë e draftimit të këtyre Rregulloreve, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi

dhe standardin përkatës të hartimit të akteve normative. Në anën tjetër, kjo *Model Rregullore* nëpërmjet një kornize të gjerë të krijuar dhe shpjegimeve të dhënë në këtë Udhëzues, e ka në konsideratë edhe ruajtjen e specifikave të Komunave të Republikës së Kosovës në trajtimin e taksave komunale.

Qëllimi i kësaj *Model Rregulloreje* nuk është vetëm t'i përmbledh taksat ekzistuese në një dokument të vetëm. Përtej kësaj, synimi është që të bëhet një filtrim ligjor sa i përket legjislacionit në fuqi dhe të ofrojë edhe perspektiva të reja për Komunitetet e Republikës së Kosovës për mundësinë e vënies së taksave të reja komunale, marrë legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe përvojat më të mira ndërkombëtare.

Kjo *Model Rregullore* përbëhet gjithsej nga dhjetë kapituj. Në dy kapitujt e parë janë trajtuar dispozitat e natyrës së përgjithshme lidhur me taksat. Në gjashtë kapitujt vijues janë përcaktuar taksat komunale, sipas kategorizimit të bazuar kryesisht në Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (këtu e tutje: LFPL) marrë parasysh edhe ndryshimet e fundit që kanë ndodhur në legjislacionin në fuqi që nga miratimi i këtij Ligji. Në kapitullin e nëntë të kësaj Rregulloreje janë përcaktuar gjohat komunale, që shqiptohen për mos zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje. Kapitulli i fundit trajton dispozitat përfundimtare të kësaj Rregulloreje dhe transparencën për qytetarët lidhur me taksat komunale dhe taksat qendrore.

2. Metodologjia dhe terminologjia

Me qëllim të hartimit të kësaj *Model Rregulloreje*, janë analizuar Rregulloret komunale përkatëse për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, si dhe Rregulloret tjera komunale që janë ndërlidhur me këtë fushë. Në anën tjetër, janë marrë konsideratë edhe ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, për të siguruar harmonizimin e dispozitave të kësaj *Model Rregulloreje* me legjislacionin horizontal. Metodologjia e shkrimit ligjor të kësaj *Model Rregulloreje* është e bazuar në Rregulloren (MAPL) Nr. 01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve Komunale. Si burim plotësues është marrë në konsideratë edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet Hartimit të Akteve Normative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ashtu siç parasheh edhe neni 11 të Rregullores Nr. 01/2017 të MAPL-së.

Sa i përket terminologjisë së shfrytëzuar nga Komunitetet e Republikës së Kosovës në titullin e këtyre Rregulloreve komunale, emërtimi i këtyre akteve normative kryesisht është titulluar si "*Rregullore për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale*". Në zbatim të këtyre nocioneve, vërejmë se termi "**taksë**", si term ligjor dhe akademik, kryesisht është sinonim i termit tatim. Tatimi, në kuptimin e saj ekonomik i cili është reflektuar edhe në legjislacionin tonë në fuqi, është një kontribut i detyrueshëm dhe i pakthyeshëm që i paguhet arkës së shtetit nga të ardhurat, nga posedimi i pronës së paluajtshme apo ndonjë kategorie tjetër ligjore; ose i vënë si kosto shtesë në mallra, shërbime dhe transaksione. Një përkufizim të përafërt njih edhe LFPL në definimin e termit taksë. Në anën tjetër, termi "**tarifë**" në literaturën ekonomike si dhe në dokumentet ndërkombëtare më shumë shfrytëzohet për të definuar një pagesë e vënë për të mirat apo shërbimet në rast të importimit nga një shtet tjetër, nga autoritetet doganore, në rast të kalimit të kufirit. Kjo është e reflektuar në shumë dokumente ndërkombëtare si Marrëveshje e Përgjithshme mbi Tarifa dhe Tregti, Traktati e Lisbonës, si dhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Në kontekstin e legjislacionit tonë, një përkufizim të tillë njih edhe Kodi Doganor dhe i Akcizave të Republikës së Kosovës, por ka edhe raste të përdorimit të këtij termi nëpër akte nënligjore, në kuptim të lartësisë së një obligimi. Në anën tjetër, ndër rastet e rralla kur ky term përdoret si tarifë komunale është shembulli i Republikës Jugafrikane, për të identifikuar disa tarifa komunale lidhur me pagesat e shërbimeve publike. Krahasa këtyre termeve, termi "**ngarkesë**", si i tillë nuk është një term që përdoret në literaturën dhe kjo zakonisht

përkthehet edhe si tatim apo taksë. Por, në fjalorin e gjuhës shqipe ka një kuptim të gjerë dhe nuk është një ters që ka një trajtim të veçantë ekonomik. Si rrjedhojë, marrë parasysh terminologjinë e përdorur edhe në dispozitat LFPP-së, termi më i përshtatshëm për titullimin e këtyre akteve normative do të ishte “Rregullore për Taksat Komunale”, ku do të rregulloheshin taksat komunale dhe gjobat lidhur me ato, titull i cili është adoptuar në këtë *Model Rregullore*.

Model Rregullorja është e ndarë dhe e sistematizuar në bazë të fushëveprimit të taksave komunale, që burojnë nga LFPL dhe legjislacioni tjetër në fuqi. Në praktikën e Komunave të Republikës së Kosovës, në hartimin e këtyre akteve normative, sistematizimi ka qenë zakonisht bazuar në drejtoritë përkatëse të komunave. Por, marrë parasysh dallimin në numrin dhe emërtimet e drejtorive nëpër Komunitet të Republikës së Kosovës si dhe mundësinë e ristrukturimit të komunave, hartimi i kësaj *Model Rregulloreje* në bazë të fushëveprimit të taksave është vlerësuar që ofron një zgjidhje më afatgjate. Por, në përpunimin e mëtejshëm të kësaj *Model Rregulloreje*, Komunitetet mund të përcaktojnë obligime për drejtoritë përkatëse në secilin nen apo kapitull.

3. Baza ligjore

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Kuvendet Komunale të Republikës së Kosovës kanë të drejtë të miratojnë akte të ndryshme, përfshirë këtu edhe rregullore komunale, brenda fushës së kompetencave të tyre, në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës. Konform kësaj, bazuar në LFPL, Komunitetet kanë në diskrecion të caktojnë taksat si në vijim:

- Taksë komunale për lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste për shoqëritë tregtare, varësisht nga specifikat e shoqërisë tregtare por gjithnjë në mënyrë proporcionale dhe jo diskriminuese;
- Taksë komunale për ushtrimin e shërbimeve profesionale nga shoqëritë tregtare që kërkojnë leje për këtë veprimtari, për profesionet si kontabilistë, avokatë, mjek, stomatolog dhe profesione të tjera;
- Taksë për automjetet për personat fizik që janë banorë të komunës dhe shoqëritë tregtare dhe ndërmarrjet tjera që janë të vendosura në selinë e komunës, e cila caktohet varësisht nga fuqia motorike e mjetit dhe/apo lloji i tij;
- Taksë administrative komunale për shërbimet që u ofrohen personave, përfshirë këtu edhe inspektimet e ndërtimeve, konform koston së ofrimit të shërbimeve;
- Taksat për lejet e ndërtimit dhe rrënimit të ndërtesave dhe strukturave tjera, bazuar në madhësinë e sipërfaqes;
- Taksë për parkimin e mjeteve në pronën komunale;
- Taksë për shfrytëzimin e pronës komunale për rekreacion;
- Taksë për gjueti apo peshkim brenda kufijve të komunës;
- Taksë për marketing ose ekspozita tjera në pronën komunale;
- Taksë për ceremonitë ose funksionet që ushtrojnë zyrtarët komunal;
- Taksa për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare – për lëshimin e dokumenteve origjinale, kopjes së këtyre dokumenteve, marrë parasysh koston e shërbimit;
- Tarifa për infrastrukturën komunale, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës komunale; dhe
- Taksa tjera që përcaktohen me legjislacionin komunal.

Krahas LFPL, edhe Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe akti nënligjor që ka derivuar nga ky Ligj, ka specifikuar më tej taksat ndërtimore. Në anën tjetër, nga miratimi i FPL kanë kaluar mbi një dekadë dhe ndërkohë janë miratuar ligje tjera që rregullojnë çështje të ndryshme që ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me fushëveprimin e taksave komunale. Këto specifika, që

janë marrë parasysh në hartimin e kësaj *Model Rregulloreje*, duhet të merren parasysh gjatë hartimit të Rregulloreve Komunale për Taksat Komunale, si në vijim:

- Sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, procedura administrative për palën është pa pagesë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj. Edhe në rast të një përcaktimi të tillë, ajo nuk duhet të jetë më e lartë se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e asaj procedure administrative dhe organi publik duhet të ketë parasysh gjendjen ekonomike të palës për të bërë lirime;
- Sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, lejet dhe licencat mund të përcaktohen vetëm me ligj;
- Sipas dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Kuvendi Komunal mund të përcaktojë veprimet që janë kundërvajtje dhe të caktojë gjoba (sanksione kundërvajtëse) brenda kufijve të caktuar në këtë Ligj dhe zhvillon procedurën e kundërvajtjes; dhe
- Sipas nenit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi çdo person është i mbrojtur nga diskriminimi, ndër tjerash, edhe në bazë të shtetësisë dhe parasheh që çdo person duhet të ketë trajtim të drejtë dhe të barabartë edhe para të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë.

4. Lirimet nga taksa komunale

Gjatë hartimit të kësaj *Model Rregulloreje* janë shqyrtuar edhe kategoritë që duhet të jenë të liruara nga këto taksa komunale. Legjislacioni në fuqi ka papërcaktuar lirime në pagesën e taksave, tatimeve dhe detyrimeve doganore për kategoritë e caktuara. Këto lirime nuk janë unike dhe pjesërisht janë të vlefshme për taksat komunale, si në vijim:

1. Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172, përcakton që familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK janë të liruara nga taksat administrative (neni 8, paragrafi 1.8) dhe invalidët e luftës janë të liruara nga taksat administrative (neni 9, paragrafi 1.13);
2. Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, parasheh që kjo kategori janë të liruara nga çdo lloj takse të drejtpërdrejtë (nenit 6); dhe
3. Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, parasheh që kjo kategori lirohen nga taksat për dokumentet personale dhe certifikatat të gjendjes civile (neni 10, paragrafi 3);

Krahas këtyre lirimeve që domosdo duhet të jenë pjesë e Rregulloreve për Taksa Komunale, komunat mund të parashohin edhe lirime të veçanta, varësisht nga lloji i taksës komunale për kategoritë e caktuara siç mund të jenë për veteranët e luftës, personat me aftësi të kufizuar, ish të burgosurit dhe të përndjekurit politik, organizatat jo qeveritare, bashkësitë fetare, organizatat tjera të veçanta. Një qasje e tillë është reflektuar edhe në *Model Rregulloren*, ku varësisht nga lloji i takës komunale janë paraparë lirime të veçanta.

5. Taksat komunale për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

Këto taksa bazohen në nenin 16 të LFPL sipas të cilës Komunat e Republikës së Kosovës kanë në diskrecion të vendosin taksë për:

- a) certifikatave ose dokumenteve të tjerë si certifikata e lindjes, kurorëzimit, shkurorëzimit, gjendjes ekonomike, sociale dhe certifikata të ngjashme; dhe
- b) kopje të këtyre certifikatave dhe dokumenteve origjinalë, përfshirë edhe kopjet e dokumenteve zyrtare të cilat duhet të vihen në dispozicion të publikut sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Bazuar në këtë dispozitë në njërin anë, dhe legjislacionin në fuqi për gjendjen civile dhe praktikën e Komunave të Republikës së Kosovës në hartimin e Rregulloreve për Taksa, është vërejtur që Komunitat në Republikën e Kosovës lëshojnë dy lloje të këtyre dokumenteve:

- a) dokumente që Komunita ka evidenca të saktë dhe vërtetësia e së cilës mund të konstatohet nga regjistrat përkatëse të gjendjen civile; dhe
- b) dokumente që Komunita nuk ka evidencë të saktë dhe konfirmohet një raport shoqëror për nevojat e personave.

Për qëllim të *Model Rregullores* dokumentet e kategorisë së parë janë emërtuar si “certifikata” dhe ato të kategorisë së dytë si “vërtetime”. Po ashtu, për të pasur informata të sigurta për këto kategori, kjo *Model Rregullore* ka paraparë dispozita që kërkon prej personave përditësimin dhe dhënien e informatave me kohë për certifikatat, dhe dhënien e informatave të sakta për vërtetimet. Pra, sipas kësaj *Model Rregulloreje*, lëshimi i vërtetimeve duhet të bazohet këto dokumente në deklaratat dhe faktet e ofruara nga personat që e kërkojnë dokumentin, dhe Komunitat duhet të kenë përgjegjësi të kufizuar në lidhje me këtë.

Dokumentet e paraparë në këtë pjesë të Projekt Rregullores duhet të ofrohen pa bërë dallime në lartësinë e taksës bazuar në statusin e personit, shtetësinë e dytë apo në përkatësinë etnike. Po ashtu, ashtu siç kërkon edhe paragrafi 2 i nenit 16 të LFPL-së, kostoja e dhënies së këtyre dokumenteve nuk duhet të kalojë koston për sigurimin e atij dokumenti. Në anën tjetër, kopja e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare të ofruara bazuar në nenin 16 të LFPL duhet të ketë një trajtim të veçantë, meqë kjo nuk konsiston në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare, meqë këto konsiderohen si dokumente zyrtare personale dhe qasja në këto dokumente është e kufizuar vetëm në personin apo në autorizuarin e tij, për shkak të privatësisë së të dhënave.

Procedura e pajisjes dhe pagesat lidhur me pagesat e taksave për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk i krijon ndonjë raport kontraktuar që mund të parashihen edhe gjopa. Por, marrë parasysh legjislacionin në fuqi lidhur me lajmërimin e lindjeve, vdekjeve, ndryshime të vendbanimit dhe vendqëndrimit, në këtë *Model Rregullore* janë paraparë disa gjopa për këto shkelje.

6. Taksat Administrative Komunale

Neni 13 i LFPL-së ka paraparë mundësinë e përcaktimit të një takse administrative nga Komunitat e Republikës së Kosovës, lidhur me shërbimet që i ofrojnë Komunitat e Republikës së Kosovës personave përkatës. Kjo dispozitë ligjore kërkon që kjo taksa të përcaktohet duke marrë parasysh koston për ofrimin e shërbimeve, bazuar në punën dhe materialet e shpenzuara. Edhe pse në praktikën e Komunave të Republikës së Kosovës kjo taksa kryesisht është trajtuar në një grup me taksën për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyre, ajo ka natyrë tjetër, ashtu siç parashihet edhe paragrafi 3 i nenit 3 të LFPL-së. Për qëllim të kësaj *Model Rregulloreje*, trajtimi i kësaj takes është në bërë në një kapitull të veçantë.

Lidhur me përcaktimin këtyre taksave, përveç dispozitave të LFPL duhet të kihet parasysh edhe legjislacioni përkatës në fuqi që rregullon marrëdhëniet shoqërore në këtë fushë. Kështu, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka paraparë që procedura administrative të jetë pa pagesë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj. Në këtë kontekst, dispozitat e LFPL-së kanë bërë një përcaktim ndryshe, por ky përcaktim ndërlidhet vetëm me shërbimet e ofruara dhe synon të mbulojë vetëm koston e shkaktuar. Rrjedhimisht, nuk mund të vendoset një taksa e tillë për ankesat apo kërkesat e ushtruara, për pjesëmarrjen në procedurë rekrutimi apo për çdo procedurë ku nuk krijohet kosto administrative për Komunitat, dhe duhet të përcaktohet vetëm për shërbimet e ofruara, në mënyrë proporcionale. Shembull i mirë për këtë taksa e reflektuar në shumë Rregullore në fuqi është taksa mbi inspektimet e realizuara me kërkesën e personave fizik apo juridik apo taksa për procedurën e kurorëzimit të realizuar jashtë orarit të punës apo jashtë objekteve komunale, meqë në këto raste shkaktohen shpenzime shtesë për administratën. Marrë parasysh këtë parim, kjo

Model Rregullore nuk ka inkadruar një sërë taksash të tilla të përcaktuara në Rregulloret e ndryshme të Komunave të Republikës së Kosovës.

Në përcaktimin e kësaj takse po ashtu duhet të merret parasysh edhe Ligji Nr. 06/L-010 për Noterinë, ligji i cili noterëve u ka përcaktuar disa kompetenca të cilat veç janë reflektuar në shumë Rregullore Komunale për Taksa, siç janë vërtetimi i nënshkrimit, vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinal, vërtetimi i datës, vërtetimi që personi është i gjallë dhe të ngjashme. Marrë parasysh që akoma kemi Komuna ku mungon shërbimi noterial, kjo *Model Rregullore* ka paraparë taksa për shërbime të tilla. Megjithatë, komunat të cilat në territorin e tyre kanë shërbim noterial rekomandohet që të mos ofrojnë këtë shërbim dhe, rrjedhimisht, të mos caktojnë taksa në këtë drejtim.

Një Ligj tjetër që duhet të merret parasysh në përcaktimin e kësaj takse është edhe Ligji Nr. 05/L - 021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ndër tjerash ndalon edhe diskriminimin në bazë të shtetësisë. Andaj, të gjitha taksat duhet të jenë të njëjta dhe nuk duhet përcaktuar taksa më të larta shtetasve të huaj, përveç nëse ka ndonjë justifikim tjetër ligjor për këtë veprim.

Marrë parasysh natyrën e taksës komunale administrative, *Model Rregullorja* nuk ka paraparë ndonjë dispozitë ndëshkimore për këto taksa.

7. Taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

Neni 10 i LFPL ka njohur diskrecionin e Komunave të Republikës së Kosovës për të përcaktuar taksë vjetore komunale për marrjen dhe mbajtjen e lejes për shoqëritë tregtare, për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Sipas kësaj dispozite Komunat e Republikës së Kosovës duhet të caktojnë lartësi të ndryshme të taksave për veprimtaritë e ndryshme dhe nuk duhet të jetë diskriminuese bazuar në numrin e punëtorëve, vëllimin e veprimtarisë, përmasat e hapësirave, lokacionin dhe profitin të realizuar nga shoqëritë tregtare. Kjo taksë mund të caktohet në secilin lokacion ku ushtrohet një veprimtari afariste si dhe mund të caktohet edhe çdo njësie të shoqërisë tregtare që ushtron veprimtari afariste. Një rregullim të ngjashëm LFPL njeh edhe për taksën për marrjen dhe mbajtjen e lejes për ushtrimin e shërbimeve profesionale.

Në anën tjetër, me miratimin e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, fushëveprimi i dispozitave të LFPL-së duhet të kuptohen në frymën e këtij legjislacioni. Fillimisht, me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave është paraparë që lejet dhe licencat të mund të parashihen vetëm me ligj dhe, së fundi, Ligji për Shoqëritë Tregtare nuk ka paraparë sistem të lejeve për regjistrimin e shoqërive tregtar, që do të ngarkonte Komunat e Republikës së Kosovës. Përkrahim nga kjo bëjnë ligjet e veçanta që kanë paraparë licenca të veçanta, organe që bëjnë licencimin dhe mjetet ku derdhen ato mjete (shembull është licencimi i avokatëve bëhet nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe mjetet janë të hyrat e kësaj organizate). Andaj, neni 10 i LFPL-së duhet të kufizohet vetëm në taksën për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, duke konsideruar të mirëqenë lejen e tyre, marrë parasysh edhe që ARBK shoqëritë tregtare i regjistron nëpërmjet Komunave të Republikës së Kosovës. Marrë parasysh këtë argumentim, në këtë *Model Rregullore* janë përcaktuar vetëm taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste, por jo edhe për ushtrimin e shërbimeve profesionale, meqë shërbimet profesional të përcaktuara në nenin 11 të LFPL-së kanë një taksë tjetër të licencimit të përcaktuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

Marrë parasysh zhvillimet në vitet e fundit në politikat e avancimit të ambientit të të bërit biznes që është reflektuar edhe në legjislacionin në fuqi, kjo taksë ka filluar të konsiderohet si jo e përshtatshme. Me qëllim të ofrimit të një ambienti më të favorshëm për biznes, disa Komuna kanë larguar këtë taksë dhe një numër i madh i Komunave zbatojnë vetëm për një pjesë të biznesit. Njashtu, marrë parasysh edhe efektivitetin e regjimit tatimor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, rekomandohet fuqishëm mos caktimi i taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Megjithatë, për Komunat që akoma e zbatojnë këtë lloj të taksës komunale, kjo *Model Rregullore* ka paraparë një kapitull.

Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.11/2013 për Implementimin e Standardit për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike në Versionin NAVE-rev.2, e cila në nenin 3, paragrafi 1, parasheh që të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës që kanë të bëjnë me regjistrimin e subjekteve ekonomike apo formave të ndryshme të organizimit shoqëror për qëllime të klasifikimit në bazë të veprimtarive ekonomike do të përdorin standardet ndërkombëtare NACE - Rev. 2., kjo *Model Rregullore* ka bërë një klasifikim të tillë të subjekteve afariste. Nga gjithsej rreth 700 aktiviteteve ekonomike të përcaktuar sipas standardit NACE, nëpërmjet regjistrimit të ARBK-së është konstatuar se në Republikën e Kosovës janë themeluar shoqëri tregtare që ushtrojnë 674 forma të veprimtarisë ekonomike, si veprimtari kryesore. Në këtë *Model Rregullore* janë reflektuar të gjitha këto aktivitete dhe janë përcaktuar taksat përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë afariste, përjashtuar aktivitete të lojërave të fatit që janë ndaluar me Ligjin Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit. Në zbërthimin e mëtejshëm të kësaj liste, Komunat mund të largojnë tërësisht këtë kapitull apo mund të kufizojnë veprimtaritë që dëshirojnë të taksojnë, sipas politikave të tyre.

Po ashtu, *Model Rregullorja* ka paraparë edhe një sistem dinamik të pagesave të taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, kategoritë e lira dhe gjobat për mos pagesën brenda afatit të kësaj takse.

8. Taksat komunale mbi Mjetet Motorike

Neni 12 i LFPL i jep kompetencë Komunave të Republikës së Kosovës që të përcaktojë një taksë vjetore për pronësinë e automjetit të vetëm personave fizik që janë banorët e Komunës përkatëse dhe shoqërive tregtare që kanë seli në atë Komunë. Kjo taksë, sipas kësaj dispozite, kërkohet që të përcaktohet në bazë të fuqisë motorike të automjetit apo llojit të automjetit dhe sugjerohet që nga kjo taksë të lirohen veturat e shërbimeve emergjente, të transportit të personave me aftësi të kufizuar dhe për qëllime tjera domethënëse shoqërore ose publike.

Marrë parasysh këtë dispozitë të LFPL dhe për dallim nga shumë Rregullore komunale të janë në fuqi, *Model Rregullore* ka përcaktuar 8 lloje të taksave komunale për mjetet motorike, duke u bazuar në fuqinë motorike dhe llojin e veturës. Po ashtu, në këtë pjesë janë rregulluar mënyrën e pagesë së kësaj takse dhe janë përcaktuar një gamë të gjerë të kategorive që përjashtohen nga pagesa e kësaj takse. Për mos pagesën me afat të kësaj takse, *Model Rregullorja* parasheh shqiptimin e gjobave.

Nëpërmjet kësaj takse, Komunat e Republikës së Kosovës mund të realizojnë edhe politika për mbrojtjen e ambientit, duke i përjashtuar nga pagesa apo përcaktuar pagesa më të ulëta për automjetet që punojnë me karburante më mjedisore.

9. Taksat Komunale Ndërtimore dhe Infrastrukturore

Sipas nenit 14 të LFPL-së Komunat mund të kërkojnë nga një preson që dëshiron të ndërtojë apo të rrënojë një ndërtesë që të pajiset me leje për këtë dhe të paguaj taksë për këtë leje, në bazë të sipërfaqes së ndërtesës. Në specifikim të mëtejshëm, Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim, në nenin 19 ka përcaktuar komunat lëshojnë leje ndërtimore për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, pra për ndërtimet me rrezikshmëri të ulët dhe ndërtime me rrezikshmëri të mesme. Sipas nenit 22 të këtij Ligji, taksa e lejes ndërtimore përcaktohet nga organi kompetent (pra nga komuna për kategorinë I dhe II) në konsultim me Ministrinë, dhe kjo taksë duhet të jetë vjetore. Po ashtu, sipas nenit 23 të këtij Ligji, Komuna mund të vlerësojë një ngarkesë për aplikuesin për të rimbursuar koston e krijimit, përmirësimit, zgjerimit apo riparimit të infrastrukturës komunale vetëm aty ku është e autorizuar për të bërë këtë sipas nenit 17 të LFPL.

Në zbërthimin e dispozitave të Ligjit për Ndërtim, është miratuar Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifatat për

Rregullimin e Infrastrukturës, ku është përcaktuar decidivisht që kjo kategori përfshin taksën mbi lejen e ndërtimit, rrënimin, taksën mbi ndikimin në infrastrukturë dhe taksën komunale për ndikimin në densitet. Këto taksa janë reflektuar në *Model Rregullore*. Por, meqë kalkulimi i taksave sipas këtij Udhëzimit Administrativ bazohet në kriteret, metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara në këtë akt nënligjor dhe bazuar në regjistrin e MMPH-së ku taksat ndryshojnë për çdo komunë, kjo *Model Rregullore* nuk ka përcaktuar shifra për këto taksa. Këto mbetet të caktojnë Komunitat, në zbatimin të këtij Udhëzimi Administrativ.

Lidhur me pagesat e këtyre taksave, kjo *Model Rregullore* për shumat e larta ka paraparë pagesa në këste, por të siguruara me një garancion bankar para autoritetit noterial. Në anën tjetër, taksat komunale për ndërhyrje në infrastrukturë dhe për rrënim të objekteve pa leje kanë një trajtim të veçantë dhe mos pagesa e tyre është paraparë që të konsistojë kundërvajtje të lehtë dhe të gjositet.

10. Taksa Komunale për Shfrytëzimin e Objekteve, Hapësirës dhe të Mirave Publike

Në këtë kategori janë përcaktuar një mori kategori taksash komunale që ndërlidhen me shfrytëzimin e të mirave në territorin e Komunitës. Në *Model Rregulloren* disa nga këto taksat janë kategorizuar edhe bazuar në zonat komunale. Kjo mund të jetë e vlefshme për një numër të madh të komunave, të cilët kanë bërë ndarjen e territorit komunal në zona. Për komunitat e vogla, mund të merren parasysh vetëm një taksë e tillë.

Ky Kapitull ka paraparë taksat si në vijim:

- 1) Taksa komunale mbi vendosjen e panove reklamuese në objektet private dhe hapësirat publike, varësisht nga madhësia e panos reklamuese;
- 2) Taksa komunale mbi parkimin e automjeteve në hapësirat komunale të destinuara për këtë qëllim;
- 3) Taksa komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirat publike që synon taksimin proporcional të aktiviteteve të ndryshme që shfrytëzojnë hapësirat publike në Komunitë;
- 4) Taksa komunale për qëndrimin e veturave përjashtuara nga komunikacioni në parkingun e Komunitës;
- 5) Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare, ku bëhet diferencimi kur bëhet për nevojat e personave fizik apo juridik;
- 6) Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale ku bëhet një kategorizim të përgjithshëm për këtë qëllim. Komunitat, marrë parasysh specifikat e objekteve që kanë, mund të bëjnë një kategorizim më të hollësishëm për shfrytëzimin e këtyre objekteve.
- 7) Taka komuna për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale si pasojë e dhënie së pronës komunale në shfrytëzim. Edhe këtu trajtimi është i përgjithshëm dhe Komunitat mund të bëjnë një trajtim më specifik, bazuar në pronat që i kanë.
- 8) Taksa komunale për qëndrim në institucionet parashkollore të fëmijëve;
- 9) Taksa komunale për mbajtjen kafshëve shtëpiake; dhe
- 10) Taksa komunale për kullosa.

1. Gjohat

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje, *Model Rregullorja* ka përcaktuar veprimet që konsistojnë kundërvajtje dhe ka përcaktuar gjoha, që ndërlidhen me mos pagesën e taksave komunale në afat të përcaktuara në këtë Rregullore. Lartësia e gjobave të përcaktuara janë në kuadër të kufijve që përcakton ky Ligj dhe mendohet se janë proporcionale me veprimet. Po ashtu, mundësia e pagesës së gjobës brenda një afati të shkurtët në vlerë prej 50% të gjobës së

shqiptuar, synon eliminimin e procedurave ankimore lidhur me gjobat, të cilat janë të garantuara për palët.

2. Transparenca dhe efektiviteti

Për dallim nga shumë Rregullore Komunale, *Model Rregullorja* nuk ka paraparë që taksat e përcaktuara nga niveli qendror të jenë pjesë integrale të saj. Këto taksa janë listuar në Shtojcën Nr. 2 të këtij modeli dhe është paraparë që ky dokument të jetë i gjallë, nëpërmjet mekanizmit të përditësimit nga një vendim i Kryetarit të Kuvendit. Po ashtu, të gjitha taksat komunale janë listuar në Shtojcën Nr. 1 të *Model Rregullore* dhe kjo do të jetë ndihmesë për zyrtarët teknik që zbatojnë këto dispozita.

01 Nr. 51/2020
Rahovec: 28.02.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Në bazë të nenit 12.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 46 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për vënien në debat publik të Draft Rregullores për Taksa Komunale

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Rregullores për Taksa Komunale.
2. Të drejtë pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.
3. Për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .
4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë dhe zyra e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. 51/2020
Rahovec: 28.02.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 30 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 6 paragrafi 6, nenit 7 dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-010 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 6 të Rregullores Nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër-Komunal dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 59 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin paraprak të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Civita

1. **Miratohet** në parim vendimi për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës Civita me 01 Nr. Prot. 2698/2020 të datës 30.08.2019 për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar për binjakëzim.
2. Nisma e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim do të zhvillohet midis Komunës së Rahovecit në Republikën e Kosovës dhe Komunës Civita të Republikës së Italisë.
3. **Autorizohet** Kryetari i Komunës së Rahovecit, që të filloj konsultimet dhe përcaktimin e modaliteteve për themelimin e marrëveshjes për binjakëzim me Komunën Civita të Republikës së Italisë.
4. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve të hartohet draft marrëveshja për themelimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, përkatësisht binjakëzimit në mes dy institucioneve shtetërore dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Komunës Civita.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 46/2020
Datë: 28.02.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 30 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 6 paragrafi 6, nenit 7 dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-010 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 6 të Rregullores Nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër-Komunal dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 59 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin paraprak të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës

1. **Miratohet** në parim nisma për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës 01 Nr. Prot. 17/2019 datës 27.11.2019 për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar për binjakëzim.
2. Nisma e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim do të zhvillohet midis Komunës së Rahovecit në Republikën e Kosovës dhe Bashkisë së Vlorës të Republikës së Shqipërisë.
3. **Autorizohet** Kryetari i Komunës së Rahovecit, që të filloj konsultimet dhe përcaktimin e modaliteteve për themelimin e marrëveshjes për binjakëzim me Bashkinë e Vlorës të Republikës së Shqipërisë.
4. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve të hartohet draft marrëveshja për themelimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, përkatësisht binjakëzimit në mes dy institucioneve shtetërore dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Bashkisë së Vlorës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 45/02/2020
Datë: 28.02.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 30 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 6 paragrafi 6, nenit 7 dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-010 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 6 të Rregullores Nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër-Komunal dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 59 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin paraprak të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Frascineto

1. Miratohet në parim nisma e për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Frascineto me 01 Nr. Prot. 2699/2019 të datës 30.08.2019 për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar për binjakëzim.
2. Nisma e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim do të zhvillohet midis Komunës së Rahovecit në Republikën e Kosovës dhe Komunës Frascineto të Republikës së Italisë.
3. **Autorizohet** Kryetari i Komunës së Rahovecit, që të filloj konsultimet dhe përcaktimin e modaliteteve për themelimin e marrëveshjes për binjakëzim me Komunën Frascineto të Republikës së Italisë.
4. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve të hartohet draft marrëveshja për themelimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, përkatësisht binjakëzimit në mes dy institucioneve shtetërore dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Komunës Frascineto.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 47/2020
Datë: 28.02.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”) dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt”

1. Me këtë vendim **miratohet** Memorandumi i Mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt” me seli në Gjakovë.
2. Shuma prej **2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro)** për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve do të bëhet për periudhën 3 (tre) vjeqare dhe atë për vitet 2020, 2021 dhe 2022.
3. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve të hartohet draft marrëveshja për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimores Shtëpia e Sigurt dhe e njëjta të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi/e i autorizuar i Strehimores.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 48/2020
Datë: 28.02.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, dispozitave të neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 dhe neneve 2, 3, 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 593 të datës 16.02.2018 për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 593 i datës 16.02.2018 për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me qëllim të zëvendësimit të anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për shkak të ndrimit të Komandantit të Stacionit të Policisë në Rahovec.
2. Pika 2.2 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet si në vijim:

2.1. Fazli Morina, Komandant i Stacionit të Policisë, emërohet anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
3. Pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 593 i datës 16.02.2018 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. 50/2020
Rahovec: 28.02.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit